

1 E hënë, 26 gusht 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
10 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Përpara se të vijë dëshmitari, kam dy aspekte që dua të
15 trajtoj. Pikësëpari, do të lëshojmë dy urdhra me gojë.

16 I pari ka të bëjë me kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes
17 për mbrojtjen e privilegjit ligjor.

18 Më 17 qershor 2024, të katër Ekipet e Mbrojtjes,
19 njëherazi dorëzuan një mocion përpara këtij Trupi Gjykses, si
20 dhe përpara Gjykatës të Vetëm. Ishte një kërkesë e
21 përbashkët e Mbrojtjes për mbrojtjen e privilegjit ligjor. Ky
22 dokument mori numrin e protokolluar F02384.

23 Më 28 qershor 2024, u përgjigj Prokurori i Specializuar
24 dhe Mbrojtja nuk u kundërpërgjigj.

25 Më 16 korrik 2024, Gjykatësja e Vetme lëshoi vendimin mbi

1 kërkesën e Mbrojtjes për garantimin e mbrojtja së privilegjit
2 ligjor. Trupi Gjykues po ashtu vëren që në vendimin e 16
3 korrikut 2024, Gjykatësi i Vetëm konfirmoi se nuk ishte bërë
4 monitorim i komunikimeve të privilegjuara në asnjë formë - as
5 tek vizitat personale, as të telekomunikacioneve, as të
6 korrespondencës me shkrim dhe as të dokumentacionit - mes të
7 akuzuarve dhe Avokatëve të tyre në objektin e paraburgimit;
8 dhe, së dyti, garantojmë Mbrojtjen që nuk ka asnjë urdhër për
9 monitorimin e komunikimit të tyre në asnjë formë të të
10 akuzuarve në objektin e paraburgimit.

11 Për më tej, Trupi Gjykues vëren se dokumentin që mban
12 numrin F02417, ZPS-ja konfirmon se nuk ka përgjuar asnjë prej
13 komunikimeve që mbrojnë sipas rregullës 31(3) dhe 11(1) të
14 Rregullores. Pra, është e qartë që Mbrojtja e ka marrë nga
15 organi përkatës informacionin që duhet të merrte nga rrethanat
16 përkatëse.

17 Trupi Gjykues vëren se nuk ka asnjë bazë ligjore për të
18 ofruar një garanci të atillë dhe Mbrojtja mund të refuzojë një
19 garanci të ngjashme nëse ofrohet në një rast të ngjashëm. Edhe
20 një herë e theksojmë, se Trupi Gjykues thekson se nuk ka
21 urdhëruar asnjëherë që të përgjohet komunikimet mes të
22 akuzuarve dhe avokatëve të tyre në objektin e paraburgimit.

23 Me kaq mbyll urdhrin e parë me gojë.

24 Tani urdhri me gojë i dytë ka të bëjë me Dëshmitarin
25 03871.

1 Më 19 gusht 2024, gjatë dëshmisë së Dëshmitarit 03871,
2 një faqe që kishe numrin U003-1515-U003-1515 që ishte pjesë e
3 një game dokumentacioni me numër të përgjithshëm U003-1450
4 deri në U003-1530, u pranua si provë materiale shoqëruese dhe
5 iu dha numri P01545. Më vonë gjatë ditës, ZPS-ja shfaqti disa
6 faqe të tjera të njëjtit dokument, ia paraqiti këto
7 dëshmitarit dhe dokumenti në tërësinë e vet është pranuar si
8 provë materiale P01548.

9 Meqë materiali P01545 është pjesë e gamës së
10 dokumentacionit që mban numrin P01548, atëherë Trupi Gjykses
11 urdhëron që të ndryshohet numri P01545.

12 Së treti, do të doja të informoja palët që sot Njësia për
13 Administrimin e Gjykatës do të nxjerrë kalendarin për seancat
14 që do të kemi, duke filluar nga janari deri më 1 maj 2025.

15 Tani mund të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 4651.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më
17 lejoni ju lutem të prezantoj një nga bashkëmbrojtësit që
18 paraqitet për herë të parë këtu në ekip.

19 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
20 këshillohen]

21 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dua të prezantoj për herë
22 të parë bashkëmbrojtësen që paraqitet në ekipin tim Dato'
23 Shyamala Alagendra.

24 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
2 Dëshmitar. Asistentja e seancës do t'ju japi një tekst që
3 është betimi solemn të cilin duhet ta bëni në bazë të
4 rregullores së Gjykatës. Ju lutem shiheni dokumentin dhe
5 lexojeni me zë të lartë.

6 DËSHMITARI: Mirëmëngjes. Betimi solemn sipas Rregullores
7 141(2): I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe
8 përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them
9 të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk
10 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

11 DËSHMITARI: SKËNDER ZHITIA

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
13 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

14 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
15 mendohet të zgjasë një ditë e gjysmë. Sikurse mund ta dini,
16 fillimisht jua bën pyetjet Prokuroria dhe më pas kanë të
17 drejtën Ekipet e Mbrojtjes t'ju bëjnë pyetje, por edhe
18 Gjykatësit mund të kenë pyetje për ju.

19 Prokuroria ka parashikuar dy orë për t'ju bërë pyetjet.
20 Ekipet e Mbrojtjes kanë llogaritur rreth pesë orë. Inkurajoj
21 të gjitha palët ta shfrytëzojnë sa më mirë kohën në pyetjet e
22 tyre. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese nëse
23 përmbushen kushtet përkatëse.

24 Dëshmitar, përpiquni të përgjigjeni qartë me fjali të
25 shkurtër. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që

1 pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni në
2 mënyrë që ta sqarojmë. Gjithashtu, na thoni ku e bazoni ju
3 faktet rrethanat dhe njohurinë për të cilat do t'ju bëjnë
4 pyetje.

5 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të përmendni korrigjimet
6 që keni bërë në deklaratën tuaj, duhet ta thoni për
7 procesverbal që deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet që
8 keni bërë ju, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

9 Ju lutem flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda
10 përpara se të përgjigjeni. Flisni ngadalë, ju lutem, për hir
11 të përkthyesve.

12 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit,
13 nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
14 jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se dikush jashtë sallës së
15 gjyqit ju bën pyetje për dëshminë tuaj, ju lutem na njoftoni
16 menjëherë.

17 Nëse unë ju kërkoj të mos flisni më, ju lutem pushoni dhe
18 gjithashtu mos flisni më nëse unë ngre dorën. Kjo do të thotë
19 se unë duhet të jap një udhëzim.

20 Në çdo moment që keni nevojë për pushim na thoni dhe do
21 të bëjmë të pamundurën që ta organizojmë.

22 Tani do të fillojmë me pyetjet nga Prokurori i
23 Specializuar, që është ulur në të majtën tuaj. Dëgjojeni me
24 vëmendje ju lutem.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pyetje nga znj. D'Ascoli:

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

4 PË. Mirëmëngjes.

5 PY. Jemi takuar bashkë edhe më përpara. Unë quhem Silvia

6 D'Ascoli dhe jam një prej prokurorëve që punon pranë

7 Prokurorisë së Specializuar dhe sot pyetjet do t'jua bëj unë.

8 Kryegjykatësi ua dha udhëzimet për dëshminë tuaj sot.

9 Gjithashtu dua të them, nga seanca përgatitore që ju kuptoni

10 pak anglisht. Por, sidoqoftë, është e rëndësishme të prisni që

11 të përfundojë përkthimi në kufjet tuaja në mënyrë që ta

12 kuptoni siç duhet pyetjen time por edhe t'u japim kohën që u

13 nevojitet përkthyesve për të përfunduar përkthimin e pyetjeve

14 dhe të përgjigjeve.

15 Do të fillojmë me të dhënat tuaja personale. A mund të na

16 thoni emrin dhe mbiemrin, ju lutem?

17 PË. Quhem Skënder Zhitia.

18 PY. Datëlindja juaj, ju lutem?

19 PË. Jam i lindur më 4 prill të vitit 1964.

20 PY. Po vendlindja juaj cila është?

21 PË. Fshati Lluga, komuna e Podujevës.

22 PY. Aktualisht çfarë pune bëni?

23 PË. Jam këshilltar i lartë shkencor në Institutin e Historisë

24 në Prishtinë.

25 PY. Në Institutin e Historisë thatë?

1 PË. Po, në Institutin e Historisë në Prishtinë.

2 PY. Dëshmitar, të flasim tani për hapat proceduralë që janë
3 të nevojshme në mënyrë që të pranojnë si pjesë të provave
4 gjyqësore deklaratat që i keni dhënë ZPS-së në të shkuarën.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë do të kërkoja që të
6 shfaqej në ekran materiali që mban numrin ERN 77803-TR-ET
7 Pjesa 1 RED dhe materialin përkues në gjuhën shqipe që
8 përfundon me -AT në fund. Më nevojitet vetëm faqja e parë në
9 ekran

10 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që ju ka intervistuar Zyra e
11 Prokurorit të Specializuar, ZPS-ja, pra, kjo Prokuroria këtu?

12 PË. Po, më kujtohet.

13 PY. I shihni transkriptet që janë në ekran, transkriptet e
14 kësaj interviste?

15 PË. Po, i shoh.

16 PY. Intervista është e ndarë në tri pjesë. A patët ju mundësi
17 të rishikonit edhe një herë tekstet e kësaj interviste gjatë
18 seancës përgatitore?

19 PË. Po, pata.

20 PY. Kur i rilexuat, a bëtë disa korrigjime dhe disa sqarime
21 të intervistës?

22 PË. Po, i bëna.

23 PY. Korrigjimet dhe ato sqarimet a u hodhën në një shënim me
24 shkrim që më pas ta lexuam në fund të seancës përgatitore?

25 PË. Po, ashtu është.

1 PY. A konfirmoni që ai shënim kishte pasqyruar siç duhet
2 korrigjimet dhe sqarimet që bëtë ju?

3 PË. Po, ashtu është.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal, ERN e
5 Shënimit Përgatitor 1 është 121927 deri 121933 RED.

6 PY. Dëshmitar, përfshirë korrigjimet dhe sqarimet që u bënë
7 gjatë seancës përgatitore, deklarata juaj me shkrim, tashmë a
8 pasqyron saktësisht ato që keni thënë dhe që do të thonit
9 sërish sot në sallën e gjyqit nëse do t'ju bënin të njëjtat
10 pyetje?

11 PË. Po, ashtu është.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi kam
13 përmbushur kriteret e rregullës 154 në përputhje me vendimin
14 F02117, ZPS-ja kërkon pranimin e deklaratave në shqip dhe në
15 anglisht në bazë të rregullës 154 përfshirë dhe provat
16 shoqëruese dhe Shënimin Përgatitor 1. Do të jap ERN përkatëse.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
18 kundërshtim?

19 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
21 numër ERN 077803-TR-ET Pjesa 1 RED, bashkë me përkthimin në
22 gjuhën shqipe dhe Shënimin Përgatitor 1 që mban numrin 121927
23 deri në 12133 RED si dhe provat materiale bashkëshoqëruese
24 pranohen.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund t'ju them që dhe

1 klasifikimi është publik?

2 Gjithashtu intervista e ZPS-së është e ndarë në tri
3 pjesë, prandaj do të doja që pranohet dhe Pjesa 2 edhe 3.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të tria
5 pranohen. Mund t'ju japim numrat përkatës kur të jeni gati ose
6 mund ta bëjmë me shkrim nëse gjykoni që është më e
7 përshtatshme.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mund t'jua jap numrat
9 tani.

10 Deklarata me tri pjesët me ERN 00177803 Pjesa 1 merr
11 numrin që ju hoq provës së mëparshme, pra, që është numri
12 P01545.1, Pjesa 2 e të njëjtit ERN me përkthimin në shqip do
13 të marrë numrin P01545.2 dhe Pjesa 3 merr pjesën më numrin
14 P01545.3.

15 Shënimi Përgatitor me numër ERN 121927-121933 RED merr
16 numrin e provës 1551.

17 Ndërsa prova materiale shoqëruese e përmendur në
18 poshtëshënimin 122 të vendimit sipas rregullës 154, që mban
19 numrin e shënimit të protokolluar P2117, merr numrin si në
20 vijim: prova materiale shoqëruese 077779 deri në 077803 merr
21 numrin P1552. Faqet që u pranuan më vonë për të pranuar në
22 provën materiale ekzistuese, që është pjesë e librit të këtij
23 dëshmitari, do t'i shtohen provës shoqëruese ekzistuese P187
24 edhe janë të përmendura më në hollësi në poshtëshënimin 122.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Vazhdoni.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ZPS-ja ka
3 dërguar një përmbledhje të këtij dëshmitari sipas rregullës
4 154. Këtë e kemi dërguar më 28 qershor 2024. Do ta lexoj për
5 procesverbal.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta
7 lexoni përmbledhjen.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Skënder Zhitia është ish-anëtar
9 i UÇK-së nga zona operative e Llapit. Ai u kyç në UÇK në maj
10 1998. Roli i tij fillestar ishte të mobilizonte civilët. Edhe
11 ai dha kontribut për krijimin e njësitit Kështjella 33, K33
12 përndryshe. Atje ai ishte komandant dhe që ishte nën Brigadën e
13 UÇK-së 151, Zahir Pajaziti. Z. Zhitia vijoi të qëndronte në
14 UÇK dhe kreu detyra të ndryshme, më pas u bë pjesë e TMK-së.

15 Skënder Zhitia është një këshilltar i lartë në
16 Institucionin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë dhe është
17 autor i librit "UÇK-ja zona operative e Llapit" që është një
18 libër historie nga pikëpamja ushtarake për UÇK-në në atë zonë,
19 që është botuar në 2008.

20 Si pjesë e dëshmisë, ai shpjegon metodologjinë, burimet
21 që ka përdorur për të përgatitur këtë libër, ku përfshijnë
22 intervista, literaturë, ditarë me komandantët dhe luftëtarët e
23 UÇK-së në zonën operative të Llapit.

24 Me këtë përmbyll përmbledhjen.

25 Gjithashtu dua të sqaroj diçka me Sekretaren e seancës

1 për Pjesën 3 të intervistës. Mos u bë ndonjë gabim kur u lexua
2 numri sepse në procesverbal doli P01545.4, mos duhet të ishte
3 P01545.3?

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, ishte gabimi im.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, deklaratat tuaja tashmë janë pranuar si prova
7 gjyqësore, prandaj nuk do t'ju bëjmë më pyetje për çështje që
8 janë trajtuar në deklaratat, por kam disa pyetje shitesë për ju,
9 përfshirë dokumentet që ua kemi treguar gjatë seancës
10 përgatitore.

11 Do të doja të filloja me disa pyetje për njësitin e UÇK-
12 së që keni komanduar ju nga tetori i 1998, pra, njësi me
13 emrin Kështjella 33.

14 Ju keni dhënë dëshmi për këtë njësi në Pjesën 1 të
15 intervistës suaj për ZPS-në që ka marrë tashmë numrin P1545.1,
16 faqja 15, rreshtat 8 dhe 14 për procesverbal.

17 Ju thatë që fillimisht njësia kishte 12 a 14 anëtarë dhe
18 më pas u zgjerua dhe u nda në katër toga, u nda më pas në
19 katër toga dhe në total kishte 40 ushtarë.

20 A ju kujtohet kjo?

21 PË. Po, më kujtohet.

22 PY. Po. Tani do të doja të fokusohemi te disa pjesë të librit
23 ku përmendet njësia juaj.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë do të kërkoja të
25 shfaqej në ekran libri i dëshmitarit që ka numrin SPOE0055678

1 deri në 00056018 dhe për anglishten më nevojitet me -ET në
2 fund. Dhe për Trupin Gjykses dhe Sekretaren e seancës dua t'ju
3 njoftoj që do të përdor pjesën origjinale të librit,
4 përkatësisht me numrin origjinal dhe jo atë që është pranuar
5 me numrin P187. Dhe do t'jua tregoj pse po do ta bëj këtë pak
6 më vonë.

7 Fillimisht do të doja që të shihnim faqen 172, ju lutem,
8 të librit në të dyja faqet është me numër SPOE00055846. Kjo
9 është një prej 21 faqeve që janë pranuar sot dhe që janë
10 bashkëngjitur provës P187 si pjesë e provave materiale
11 shoqëruese në bazë të rregullës 154.

12 Ju lutem, të afrojmë pjesën e fundit të faqes 172 të
13 librit, jo të PDF-së. Pra, SPOE është materiali që përfundon
14 me 55846 me këtë numër ERN. Po, kjo është faqja që na
15 nevojitet në të dyja gjuhët.

16 PY. Dëshmitar, po lexoj paragrafin e fundit. Ju këtu thoni se
17 "Skënder Zhitia ishte komandues në Lluga" dhe keni përmendur
18 disa komandues të tjerë këtu në zona të tjera, në zona të
19 tjera pra.

20 Pra, kur thoni "komandues Skënder Zhitia në Lluga", jeni
21 ju që komandoni njësitin K33, e shihni këtu, për ju bëhet
22 fjalë?

23 PË. Po.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 224 të librit
25 SPOE00055898 në të dyja gjuhët, ju lutem. Dhe kjo është një

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 13

1 prej 21 faqeve që u pranua tani dhe që ju bashkëngjitë provës
2 ekzistuese.

3 PY. Dëshmitar, shohim në krye të faqes, ju lutem, këtu bëhet
4 një përshkrim i detyra që kishte njësia K33. E shihni këtë?

5 PË. Po.

6 PY. Në cilën periudhë kohore i ka ushtruar këto funksione
7 njësia jua, këto që përmenden këtu?

8 PË. Diku nga mesi i janarit deri dikun rreth 15 mars 20,
9 për afërsisht.

10 PY. E keni fjalën në 1999?

11 PË. Po.

12 PY. Dëshmitar, ju lutem, shihni dhe njësitet e tjera që
13 përmenden në të njëjtën faqe K28, për shembull, që kishte
14 komandant Shqip Hazirin dhe K26 me Kadri Avdiun si komandant.
15 Keni bashkëpunuar me këtë njësi kur keni qenë komandues i K33?

16 PË. Deri në muajin prill nuk kam pas ndonjë kontakt të
17 drejtpërdrejt me Kështjellën 28. Me Kështjellën 26 kam mujt me
18 pas herë pas here edhe aty përmes radiolidhjes më shumë.

19 PY. Kur thoni prill, e keni fjalën për prillin e 1999, apo
20 jo?

21 PË. Po, prillin në vitin 1999.

22 PY. I keni intervistuar ju këta komandantë, Kadri Avdiun dhe
23 Shaip Hazirin për këtë libër, kur përgatitët librin?

24 PË. Sa më kujtohet, po.

25 PY. Po, në fakt, emrat i gjejmë në një pjesë të librit tuaj,

1 tek bibliografia. Aty keni renditur luftëtarët dhe komandantët
2 e UÇK-së që keni intervistuar.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal kjo përmendet
4 në faqen 311 dhe 313 të librit që përndryshe ka ERN
5 SPOE00055985 dhe 559877.

6 PY. Dëshmitar, informacioni që është në këtë faqe të librit,
7 a është bazuar në përvojën tuaj si komandant i K33?

8 PË. Po, bazuar në përvojën time dhe detyrat të cilat i kam
9 pas gjatë kohës së luftës.

10 PY. Informacioni në këtë tekst sa u takon dy njësive të tjera
11 është bazuar në intervistat që keni pasur me komandantët e
12 këtyre dy njësive, pra, përkatësisht K28 dhe K26?

13 PË. Sigurisht. Sigurisht në bazë të intervistave.

14 PY. Më në përgjithësi, sa i takon këtyre që keni përmendur
15 për K33, lëvizjet, veprimtaritë e njësisë, disa në këtë faqe,
16 disa në faqe të tjera të librit, këtë përshkrim që keni bërë
17 ku e keni bazuar ju?

18 PË. Nëse e ke fjalën vetëm për Kështjellën 33, atëherë jam
19 bazuar në detyrat, përgjegjësitë dhe përvojën time gjatë
20 luftës. Nëse e ke fjalën për njësi tjera, atëherë bazuar në
21 intervistat ose bisedat që kam pas me bashkëluftëtarë. Nëse më
22 lejohet të sqaroj diçka në lidhje me intervistat?

23 PY. Patjetër. Patjetër. Në fakt pyetjen e kisha vetëm për
24 K33, por sqarimi është i mirëpritur. Ju keni përmendur edhe
25 disa referenca në librin tuaj për njësinë K33 dhe veprimtari

1 të ndryshme dhe operacionet në të cilat keni marrë pjesë me
2 njësinë tuaj.

3 Tani, do të përmend faqet konkrete të librit dhe do t'ju
4 pyes nëse e konfirmoni përmbajtjen që do t'ju përmend unë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 256, për
6 ndryshe ka numrin SPOE00055930 në të dyja gjuhët. Atëherë ky
7 është një dokument i cili nuk është pjesë e P187.

8 PY. Dëshmitar, kjo është një pjesë që përshkruan ngjarjet në
9 zonën operative të Llapit nga 24 marsi i vitit 1999 deri më 1
10 maj 1999. E shikoni përpara, e shikoni titullin?

11 PË. Po, e shikoj.

12 PË. Në faqet e kësaj pjesë duke filluar nga 256, ju
13 përshkruani, për shembull, në qoftë se do fillojmë me
14 prezantimin këtu në faqen 256, ju thoni që pas fillimit të
15 bombardimeve të NATO-s ka pasur disa ofensiva serbe. A ka qenë
16 kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, ofensiva të cilat kishin për qëllim dëbimin e
18 popullatës civile nga rajoni i zonës operative të Llapit. Po
19 është një operacion në planin Patkoi të Serbisë në atë kohë, i
20 cili filloi me fillimin e bombardimeve të NATO-s. Dhe ky
21 operacion filloi nga pjesa më veriore e Kosovës, respektivisht
22 zonës operative të Llapit. Kështu që u mobilizuan të gjitha
23 njësitë në atë kohë që t'i dalin në ndihmë popullatës për t'i
24 larguar nga regjionet të cilët ishin më të rrezikueshëm. Po
25 për Operacionin Paktkoi kemi çka shtojmë dhe çka themi nëse --

1 PY. Kur do që do më duhet shpjegime të mëtejshme ose hollësi
2 të mëtejshme do ju them. Megjithatë për momentin, Dëshmitar,
3 thjesht dua t'ju them që përshkrimi që dhatë ose prezantimi që
4 dhatë është i mjaftueshëm.

5 K33 ose njësite të tjera të UÇK-së kanë ndihmuar për
6 zhvendosjen e popullatës, sikurse e thatë dhe juve, në zona të
7 caktuara, si për shembull, në Dumosh, Lladrovç, Batllavë e të
8 tjerë. Domethënë, kjo jepet në faqen 256 dhe 257 të librit, A
9 është informacion i saktë ky, Dëshmitar?

10 PË. Njësitë në përgjithësi, po. Po njësitë Kështjella 33, që
11 e kam komandu unë, ka shku atje të ndihmojë popullatën me
12 urdhër të komandantit më 25 mars në fshatin Sfecel. I kemi
13 shkue në ndihmë njësitit Kështjella 32 dhe kemi hy nën
14 komandën e tij.

15 PY. Po. Përkthyesi tha që nuk e dëgjoi mirë emrin e fshatit.
16 A mund ta përsërisni dhe një herë për procesverbal, dëshmitar?

17 PË. Në fshatin Sfecel.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen 258,
20 që ndryshe është dokumenti me numër SPOE0005392.

21 PY. Dëshmitar, në fillim të prillit të vitit 1999, po ju
22 lutem hidhi një sy këtij dokumenti, njësitet e Brigadës 151
23 janë zhvendosur ose janë stacionuar në zonën ndërmjet
24 Barilevës dhe Llapashticës. Dhe në librin tuaj, në fakt, ju
25 jepni një listë të këtyre njësiteve dhe të vendeve ku kanë

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 17

1 qenë të pozicionuar ose stacionuar ato në faqet 258 dhe 259. A

2 e konfirmoni këtë informacion, Dëshmitar?

3 PË. Po, e konfirmoj.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të shkojmë në faqen 260 ose

5 ndryshe me numër SPOE00055934.

6 PY. Këtu shohim të thuhet që Brigada 152, domethënë, njësitet

7 e kësaj brigade kanë qenë të stacionuara në këtë zonë ndërmjet

8 Llapashticës dhe Murgullës. Këtë juve e përshkruani në faqet

9 260 dhe 261, është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Bazuar në referencat që unë i kam shfrytëzuar në atë

11 kohë, po, kështu është.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër, 261,

13 që është ndryshe faqja me numër SPOE00055935.

14 PY. Te kjo faqja thuhet se K33 nën komandën tuaj ka lëvizur

15 në fshatin e Halabakut në fillim të prillit, 3 ose 4 prill, të

16 paktën kështu thuhet në këtë faqe, apo jo, është e saktë kjo,

17 Dëshmitar?

18 PË. Më 3 prill kemi kalue në fshatin Halabak, tek njësia e

19 Kështjellës 26 ku është komandu ka Kadri Avdiu.

20 PY. A doni të thoni që Halabaku ka qenë nën territorin e

21 njësitit K26, këtë doni të thoni?

22 PË. Ma herët. Më herët ka qenë. Ne kemi shku aty dhe jemi

23 bashku me njësinë Kështjella 26.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Të shohim faqen

25 266, ndryshe me numër SPOE00055940.

1 PY. Dëshmitar, më 7 prill 1999, ka filluar befasishëm një
2 ofensivë serbe, pra, ofensiva serbe e kësaj data dhe pasojat e
3 mëtejshme jepen të përshkruara në këtë faqe, domethënë, në
4 faqen 256 deri në 259. A ju kujtohen ngjarjet që keni
5 përshkruar në këtë pjesë të librit tuaj, Dëshmitar?

6 PË. Në hollësi s'më kujtohen. Vetëm nëse i lexoj sepse këto
7 janë të dhëna që janë bazuar në bazë të referencave që i kam
8 shfrytëzue. Po.

9 PY. Shkurtimisht, a mund të na thoni se çfarë roli ka pasur
10 njësitë juaj në Halabak në atë periudhë të atij viti,
11 domethënë, në prill të vitit 1999?

12 PË. Po ne jemi ndesh në atë fazën kur nuk e njehnim terrenin
13 së bashku me komandantin e Kështjellës 26. Po u familjarizonim
14 me asi edhe ende nuk ishim vendos plotësisht dhe nuk kishim
15 dhe hapsinat. Por gjatë kësaj periudhe edhe kemi lëvizë ne,
16 disa pjesëtarë të njësisë, drejt fshatit Lluga për të pa sesi
17 është gjendja atje dhe në civilët a ka pas të plagosun ose të
18 vramë ose diçka tjetër.

19 Kështu që në këtë kohë nuk kemi pas ndonjë angazhim sa i
20 përket ofensivës në 7 prill.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër, 271.
22 Që është SPOE00055945.

23 PY. Në këtë faqe dhe në dy faqet e tjera, domethënë, në 272
24 dhe 273, përshkruhen ngjarjet të ofensivës 18 prillit të vitit
25 1999 që juve filloni ta përshkruani që prej faqes 270. A ju

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 19

1 kujtohet kjo ofensivë në vitin 1999 në prill të atij viti,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po, më kujtohet.

4 PY. Ju diskutoni se në njësitin tuaj, në K33, në atë kohë,

5 domethënë, deri më 18 prill 1999 kishte marrë pozicion në

6 Halabak, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po, ishim vendos në Halabak.

8 PY. Njësitit juaj a ka mare pjesë në luftimet e zhvilluara nga

9 data 18 prill e në vijim përreth fshatrave Tërnovës, Halabak,

10 Sharbanë dhe Koliq, siç diskutohet në këtë pjesë të librit

11 tuaj?

12 PË. Po, kam marrë pjesë.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani le të kalojmë në faqen

14 285, ndryshe SPOE00055959, në të dyja versionet në anglisht

15 dhe në shqip, ju lutem.

16 PY. Dëshmitar, po lexoj nga fundi i faqes ku thuhet se në

17 mbrëmjen e 8 majit 1999, ju dhe luftëtarë të tjerë keni

18 shoqëruar një kolonë ushtarësh dhe të rinjve të cilët po

19 largoheshin nga fshati Dyz. A ju kujtohet ky informacion,

20 Dëshmitar? A është e saktë kjo që sapo përmblodha unë?

21 PË. Po, më kujtohet. Është e saktë.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër,

23 286, SPOE00055960.

24 PY. Dëshmitar, në këtë faqe, në qoftë se ju kujtohet,

25 domethënë, nga 286 deri në 291, pas betejave të prillit, ju më

1 pas keni përshkruar ngjarjet e gjysmës së parë të majit në
2 zonën operative të Llapit, në vitin 1999, duke shpjeguar dhe
3 duke folur gjithashtu sesi u tërhoqën forcat nga zona
4 operative e Llapit. A ju kujtohen këto përshkrime, a ju
5 kujtohet kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po, më kujtohet.

7 PY. Njësiti jua j a vazhdoi të qëndronte në Halabak në vitin
8 1999?

9 PË. Po.

10 PY. Këtë në fakt ju e diskutoni në faqen 293. Deri në çfarë
11 kohe keni vazhduar ju të qëndroni në Halabak, Dëshmitar?

12 PË. Me data saktë nuk jam i sigurtë, po diku rreth mesit të
13 qershorit, dikun ka i 15 më së larti, jemi tërheq dhe jemi
14 kthi në fshatin Lluga. Është fjala qershor 1999. Nuk jam i
15 saktë me data. Mund të jem i gabueshëm.

16 PY. Po, në rregull. Vetëm një periudhë kohe mjafton
17 domethënë.

18 Sa i takon faqeve 291 dhe 293, këto janë faqet të cilat
19 juve ia keni kushtuar periudhës nga 15 maji deri në 19 qershor
20 1999. Njësiti jua j a i ka dhënë ushtarë Batalionit të UÇK-së
21 me numër, domethënë, që është Batalioni 5 i rojeve të UÇK-së
22 në atë periudhë, i keni dhënë ju ushtarë atyre?

23 PË. Nuk po e kuptoj pyetjen.

24 PY. Batalioni 5 i Gardës së UÇK-së.

25 PË. Ah, tani po. Po edhe prej njësisë teme ka pas pjesëtarë

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 21

1 që janë angazhu në Batalionin Gardist të zonës operative të
2 Llapit.

3 PY. Po. Në faqen 291, SPOE00055965, ju thoni konkretisht që
4 Batalioni 5 i Gardës përbëhej konkretisht nga ushtarët më të
5 njohur të Brigadës 151, është informacion i saktë ky,
6 Dëshmitar?

7 PË. Besoj që po.

8 PY. Pyetja ime është në qoftë se edhe njësitë jua j K33 ka
9 kontribuar në Batalionin 5, juve në fakt sqaruar qenë fakt ka
10 ndodhur kështu, domethënë, për këtë pjesë të informacionit
11 isha e interesuar.

12 Atëherë kur flasim këtu për qershorin e 1999, Dëshmitar,
13 a ju kanë autorizuar ndonjëherë që të krijoni një qeveri
14 civile në Lluga në këtë periudhë, domethënë, në qershor të
15 1999?

16 PË. Jo, asnjëherë.

17 PY. Po në ndonjë periudhë tjetër kohe?

18 PË. Jo. A ka nevojë me sqaru?

19 PY. Jo. Nuk është e nevojshme, mjafton për kaq për arsyet e
20 mia.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja
22 kërkon që të pranohet si provë në këtë pikë pjesët e librit
23 ose faqet e librit të cilat janë diskutuar me dëshmitarin deri
24 tani. Më konkretisht këto janë faqet 256 deri në 264, që është
25 SPOE00055930 deri në 55938. Brenda kësaj pjese vërej që faqja

1 261 është pjesë e 21 faqeve që janë pranuar si prova sot.

2 Ndërkohë pjesa tjetër janë nga faqet 265 deri në 273,
3 SPOE00055939 deri në 55947, në këtë pjesë nuk është pranuar
4 asnjë provë sot.

5 Ndërkohë që pjesa e fundit përbëhet nga faqet 285 deri
6 293, që është dokumenti SPOE00055959 deri në 55967. Vërej që
7 brenda kësaj game faqesh, faqet 286, që është SPOE00055960,
8 është e vetmja faqe që aktualisht është e përfshirë në provën
9 P187 dhe e provave shoqëruese të pranuar sot.

10 Atëherë do kërkonim që faqet të cilat unë i citova më
11 sipër të pranohen më sipër dhe të pranohen si dokumente
12 publike.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
14 kundërshtim?

15 PËRKTHYESJA: Ekipet nuk kanë kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Kjo pjesë do të shtohet në provën P96.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt, P97.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
20 procesverbal, do t'i bashkëlidhet provës 187.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull.

22 PY. Dëshmitar, a keni botuar një edicion të dytë të librit
23 tuaj, "Zona Operative e Llapit", keni botuar këtë edicion të
24 dytë kohët e fundit?

25 PË. E nderuar Prokurore, po, e kam ribotue në vitin 2023 pa

1 ndryshime. Arsyeja e ribotimit është fakti që nga kjo dhomë
2 avokatë, po edhe prokurorë, kanë shkoqit fjalë dhe fjali nga
3 tërësia e librit tim të cilat në opinion e kanë përcjellë një
4 mesazh të gabuar sikur --

5 PY. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar, pyetja e vetme e imja ishte
6 në qoftë se keni botuar një vëllim të dytë të librit tuaj,
7 domethënë, duhet të përgjigjeni me "po" ose "jo". Ju u
8 përgjigjët me po. Ju thatë që vëllimi i dytë është
9 ekzaktësisht i njëjtë me vëllimin e parë. Këtë thatë apo jo?

10 PË. Znj. Prokurore, për mua është shumë e rëndësishme me e
11 theksu këtë.

12 PY. Dëshmitar, për momentin thjesht do ju kërkoja që t'i
13 jepni përgjigje pyetjeve që po ju bëj unë.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Për të qenë i drejtë me dëshmitarin,
15 kjo nuk është ekzaktësisht kështu e pasqyruar në procesverbal.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
17 atëherë t'i marrim njëra pas tjetrës, së pari jepini përgjigje
18 që ju bëhen dhe ndërkohë në qoftë se do na duhet informacion
19 shtesë ose në qoftë se doni që të shtoni informacion juve më
20 vonë, do ju jepet mundësia për këtë gjë.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës.

23 PY. Dëshmitar, atëherë pyetja e parë që ju bëra ishte: A keni
24 botuar kohët e fundit një vëllim të dytë të librit tuaj? E
25 thatë më përpara përgjigjen, thatë që:

1 "... e kam ribotuar" --

2 PË. Po, e kam ribotuar.

3 PY. -- "në 2023 pa ndryshime nga botimi i parë".

4 A është e saktë kjo, Dëshmitar? Pra, kjo ka ndodhur në
5 2023, domethënë, ribotimi është bërë pa ndryshime. Është e
6 saktë kjo, Dëshmitar, apo jo?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Në rregull. Megjithatë pasi e kam parë vëllimin e dytë e
9 kuptoj që vëllimi i dytë është me ngjyrë, domethënë, ky është
10 i vetmi dallim ndërmjet edicionit të parë ose vëllimit të parë
11 dhe vëllimit të dytë ngjyra, kjo është e vetmja gjë ka
12 ndryshuar?

13 PË. Përgatitja ka qenë e njëjtë. Mundësia e shtypjes është
14 mvar prej institucionit i cili i ka botue, në këtë rast
15 Instituti i Historisë. Po ndryshime nuk ka.

16 PË. Faleminderit. Jua bëra pyetjen sepse do kërkoj që disa
17 prej faqeve me ngjyrë do kërkoj që të pranohen si prova. Për
18 këtë arsye jua bëra pyetjen.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që tani
20 të paraqesë në ekran faqen 31 të librit në të dyja gjuhët,
21 është dokumenti SPOE00055705. Kjo është një prej faqeve që
22 tashmë është pranuar në provë dhe mban numrin e provës P187.

23 PY. Faqen e kemi tani në ekran, besoj se mund ta lexoni. E
24 keni përpara, Dëshmitar?

25 PË. Unë e kam përpara një material, po s'po di për cilin e ke

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 25

1 fjalën këtu.

2 PY. Po, do ju bëj pyetjen tani, po thjesht dua të di në qoftë
3 se e keni materialin përpara. Jemi tek faqja 31. Në pjesën e
4 fundit të kësaj faqeje, në qoftë se mund të shikojmë listën.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do ishte mirë që të kalonim pak
6 më poshtë në versionin në shqip në mënyrë që mund ta lexoj
7 dëshmitari. Shumë mirë.

8 PY. Dëshmitar, në pjesën e fundit të kësaj faqeje jepen
9 shifrat thirrëse që i janë caktuar komandantëve të zonës
10 operative të Llapit, për shembull, është shifra thirrëse
11 Dardania 100 për Rustem Mustafën, që është komandanti i zonës
12 operative të Llapit. Pastaj kemi shifrën thirrëse Dardania 101
13 për zëvendëskomandantin Kadri Kastratin. Dhe pastaj kemi
14 shifrën thirrëse Dardania 102 për shefin e shtabit Dajën dhe
15 Lekën. A e shikoni këtë?

16 Domethënë, Leka është nofka për Nuredin Ibishin, apo jo,
17 Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Nëse do shikoni poshtëshënimin numër 9 në fund të faqes
20 tek kjo faqe, domethënë, faqja 31, burimi i informacionit tuaj
21 për këtë pjesë, domethënë, për shifrat thirrëse, burimi a
22 është dokumenti i cili jepet në poshtëshënimin 9 konkretisht?

23 PË. Po.

24 PY. Duke parë referencën A.Z5M.TMK, a mund të na e shpjegoni
25 se çfarë është kjo?

1 PË. Arkivi i Zonës së Pestë Mbrojtëse, Trupave Mbrojtëse të
2 Kosovës, Dosja Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi i
3 Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pa numër, datë
4 10 nëntor 1998.

5 PY. Pra, ju thoni që jeni konsultuar me këtë dokument të
6 Shtabit të Përgjithshëm me datë 10 nëntor 1998 që ka qenë në
7 dosjet e TMK-së, këtë thoni, Dëshmitar?

8 PË. Po. Sa më kujtohet mua, po. Dhe po.

9 PY. Lista vazhdon më tej, vazhdon tek faqja tjetër, tek faqja
10 32.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
12 kalojmë tek faqja tjetër SPOE00055706. Për procesverbal, kjo
13 është po ashtu pjesë e provës P187

14 PY. Lista vazhdon pastaj me shifrën thirrëse Dardania 105 që
15 i caktohet Muhamet Latifit, komandant i mbrojtjes civile. Dhe
16 pastaj vazhdohet me disa shifra thirrëse të tjera për persona
17 të tjerë.

18 Si ushtar i zonës operative të Llapit, Dëshmitar, a keni
19 përdorur ju ndonjë shifër thirrëse që fillonte me Dardania
20 vetë si person?

21 PË. Po. Gjatë kësaj kohe kam komunikuar me Muhamet Latifin,
22 Dardania 105 kryesisht. Për tjerë kam mujt me thirr, po s'më
23 kujtohet. Po që kam majt kontakt të vazhdueshëm ka qenë
24 Muhamet Latifi.

25 PY. Në rregull. Atëhere ju thatë që kryesisht shifra thirrëse

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 27

1 ka qenë Dardania 105, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Ju keni përmendur dokumentin e datës 10 nëntor 1998 dhe
4 në faqet pasuese të librit, kur i referoheni brigadave të
5 tjera dhe shifrave thirrëse të njësive të tjera.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për shembull, në qoftë se do të
7 kalojmë tek faqja 35, poshtëshënimi 13. Ndërkohë numri ERN i
8 faqes është SPOE00055709. Ju lutem, tregojeni faqen në mënyrë
9 të tillë që poshtëshënimi 13 të jetë i dukshëm në të dyja
10 versionet në anglisht dhe në shqip.

11 PY. Dëshmitar, ju lutem hidhini një sy poshtëshënimeve. Do i
12 kërkoj Sekretares që ta zmadhojë tekstin në mënyrë të tillë që
13 ta kesh më të qartë për ta lexuar. A bëhet fjalë për të
14 njëjtin dokument këtu, Dëshmitar? Këtu thuhet që nuk ka datë,
15 pa datë. Kam përshtypjen që në poshtëshënimin e mëparshëm,
16 pra, që pamë më herët thoshte që nuk kishte numër. E keni
17 fjalën që nuk kishte, nuk ka pasur numër në vend që të thoni
18 që nuk ka pasur datë?

19 PË. Jo, nuk ka pas sigurisht numër protokolli ose këtu po
20 mendoj. Nuk e mbaj mend tash, nuk e di.

21 PY. Është e qartë. Në fakt nuk ka pasur numër protokolli.

22 Atëherë në këtë faqe ju e keni përdorur këtë dokument për
23 t'iu drejtuar numrin e Brigadës 151, domethënë, shenjë
24 thirrëse të brigadës dhe kjo ka qenë Ulpiana, apo jo,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, Brigada 151 ka qenë e kodu me shifrën Ulpiana.

2 PY. Si ushtar i UÇK-së i njësitit K33 i zonës operative të
3 Llapit, a e ke njohur këtë kod ti gjatë luftës dhe a e ke
4 përdor vetë ti këtë shenjë thirrëse gjatë luftës, Dëshmitar?

5 PË. Po, e kam përdor. Për faktin që na kemi qenë ma afër
6 Brigadës 151 nga kemi komunikuar edhe kemi bashkëpunuar me
7 komandantin e Brigadës 151.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 37.

9 SPOE00055711.

10 PY. Këtu jepet një fotografi që në versionin ose në vëllimin
11 e dytë të librit tuaj është me ngjyra, ndërkohë që në
12 versionin e parë është bardhë e zi?

13 PË. Po.

14 PY. Ju lutem shikoni poshtëshënimin 17.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
16 kalojmë më poshtë në faqe në të dyja versionet për ta lexuar.

17 PY. Atëherë përsëri në poshtëshënimin 17 është i njëjti
18 dokument i UÇK-së që mban datën 10 nëntor 1998 që po
19 diskutonim pak më herët, kështu

20 PË. Po, e saktë.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E njëjta gjë është dhe në faqen
22 tjetër që është faqja 38. Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
23 në faqen tjetër, SPOE00055712. Dhe ky është poshtëshënimi 20.

24 PY. Bëhet fjalë prapë për të njëjtin dokument, apo jo,
25 Dëshmitar?

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 29

1 PË. Po, po.

2 PY. Ju lutem jepni përgjigje.

3 Atëherë në këto dy faqe juve përsëri keni përdorur këto
4 dokumente në mënyrë të tillë që t'i drejtoheshit shenjave
5 thirrëse të Brigadës 152 që ka qenë Kështjella dhe Brigadës
6 153, Buna, apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Po, ashtu është.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të kalojmë tani tek faqja 176 e
9 librit ose SPOE00055850.

10 Të nderuar Gjykatës, e shoh kohën, do të kërkoja që të
11 përfundonim me këtë dokument dhe pastaj do kalojmë tek
12 pushimi.

13 Atëherë shohim faqen 176 të librit në të dyja versionet
14 në shqip dhe në anglisht.

15 PY. Dëshmitar, a është ky dokumenti që sapo diskutuam,
16 domethënë, dokumenti që ju konsultuat në arkivat që referohet
17 në faqet dhe në poshtëshënimet që sapo diskutuam më herët, për
18 këtë dokument bëhet fjalë?

19 PË. Po, për këtë dokument.

20 PY. Përsëri ky dokument në vëllimin e dytë të librit është me
21 ngjyra? Ne i kemi caktuar --

22 PË. Po.

23 PY. -- caktuar një numër ERN kësaj faqeje që mban numrin ERN
24 121961.

25 PY. Në rregull.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal do të doja të
2 thoja që kemi një version tjetër të dokumentit që mban datën
3 10 nëntor 1998 që është pranuar në provë si P1417.

4 Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja kërkon të regjistrojë, të
5 pranojë si prova dokumentet në faqen 34 deri në 38 që mbajnë
6 numrin SPOE00055708 deri në SPOE00055712. Vërej se faqja 36,
7 SPOE00055710, është pjesë e 21 faqeve që i janë shtuar sot si
8 pjesë e provës P187 sipas rregullave ose parashikimeve të
9 provave shoqëruese të rregullës 154 të Rregullores.

10 ZPS-ja po ashtu kërkon që të shtohet faqja 176 e librit
11 që mban numrin SPOE00055850 që të shtohet në provën 187. Tani
12 sa për sqarim klasifikimi duhet të jetë publik.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
14 kundërshtim?

15 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
17 SPOE00055708 në përjashtim të faqes 176 -- a është e saktë
18 kjo, apo jo?

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Përveç faqes 36.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Përveç faqes 36 që është 00055701.

22 Faqja 176 që është SPOE00055850 pranohet.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe do
25 shtohen tek prova 187, P187.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit. Dhe gjithashtu
2 kërkoj që të pranohen si prova kopjet me ngjyra të faqes 36
3 dhe 37 të librit që kanë numër ERN 121950 dhe 121951 plus
4 kopja me ngjyra e këtij dokumenti që është faqja 176 që
5 aktualisht e kemi në ekran që mban numrin ERN 121961.

6 Klasifikimi për të gjitha këto dokumente mund të jetë publik.

7 Do i kërkoja Sekretares që të caktojë një numër prove të
8 lidhur me P187 dhe për faqet me ngjyra të librit në mënyrë të
9 tillë që të ketë lidhje ndemjet faqeve, për shembull, mund t'i
10 japë numrin P187.1.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
12 nuk ka kundërshtime, atëherë të bëhet zëvendësimi i versionit
13 me ngjyra të librit me versionin e mëparshëm.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe do të marrin
15 numrin e provës P187.1

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
17 bëjmë një pushim prej dhjetë minutash. Asistentja do t'ju
18 shoqërojë për të dalë nga salla, do të ktheheni përsëri në
19 sallë për dhjetë minuta.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
22 pushim për dhjetë minuta.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 10.04

24 --- Seanca rifillon në orën 10.14

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 32

1 silleni dëshmitarin në sallë.

2 Znj. Prokurore dhe sa kohë ju nevojitet?

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është e sigurt që do të më
4 duhet deri në orën 11.00 të vazhdoj me pyetjet e mia.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
7 të vazhdojmë tani me pyetjet nga Prokuroria.

8 Znj. Prokurore, vazhdoni.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

10 Ju lutem të vendosim në ekran faqen 247 të librit të
11 dëshmitarit, që përndryshe mban numrin SPOE00055921. Më
12 nevojitet vetëm shqipja. Përbri kësaj faqeje do të doja të
13 nxirrnim një faqe që është më e qartë që është nga ribotimi i
14 të njëjtit libër dhe që mban numrin ERN 121975. Ju lutem ta
15 zmadhojmë pak dokumentin që të kemi mundësi ta lexojmë.
16 PY. Dëshmitar, është i njëjti dokument në të dyja këto faqet
17 që shohim në ekran. A mund të na thoni çfarë është ky
18 dokument?

19 PË. Po. Ky është një dokument i shifrimit të njësiteve në
20 zonën operative të Llapit, i komandës dhe i dy brigadave,
21 Brigadës 151 dhe 152. 151, 152.

22 PY. Çfarë date ka dokumenti?

23 PË. Nëse po e shoh mirë, 21 prill 1999.

24 PY. Kush e ka nënshkruar?

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund të shohim pak më poshtë në

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 33

1 tekst që të shohim dhe nënshkrimin në të dyja kopjet.

2 DËSHMITARI: Për zëvendëskomandantin e paska shkru, nëse
3 është i saktë, Leka. Nënshkrimi nuk do të thotë që e njoh, po
4 "Leka" po shkruan.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

6 PY. Po, Nuredin Ibishi, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Ky dokument a pasqyron ato kodet thirrëse që përdornin në
9 atë periudhë, pra, në prill të 1999 si ushtar i UÇK-së?

10 PË. Po.

11 PY. Besoj se në rreshtin e fundit përmendet Lluga K33. E
12 sheh, arrin ta shohësh?

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund ta zmadhojmë nëse është
14 nevoja.

15 DËSHMITARI: Jo, me e zvogëlu pak nëse ka mundësi se
16 kështu po e hup mundësinë e dukjes.

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

18 PY. Në fakt, unë thjesht doja t'ju thoja nëse rreshti i
19 fundit në dokument, rreshti i fundit tek kolona e parë, thotë
20 Lluga K33, kështu?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Shoh një Skënder në mes, diku në mes. Bëhet fjalë për ju?

23 PË. Ku është Lluga, Skënda. Po, për mu është fjala.

24 PY. Ju jeni konsultuar dhe me këtë dokument në arkivën e TMK-
25 së siç e keni përmendur, apo jo?

1 PË. Po.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Prokuroria
3 kërkon që të pranohet edhe kjo faqe, është faqja e librit
4 faqja 247, me numër SPOE00055921, do të kërkonim t'i
5 bashkëngjitet provës P187 dhe të ketë klasifikimin publik.
6 Gjithashtu kërkojmë që të pranohet edhe faqja e librit me
7 ngjyra, që ka ERN 121975 dhe kjo t'i bashkëngjitet provës
8 187.1.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
10 kundërshtime?

11 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
13 SPOE00055921, bashkë me kopjen që është më e qartë me cilësi
14 më të mirë, me numër 121975 pranohet dhe i bashkëngjitet
15 provës P187.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani do të shohim një dokument
17 tjetër. Do të doja që të shfaqej në ekran dokumenti
18 SITF000242163 deri në 000242296. Edhe për këtë më nevojitet
19 vetëm shqipja, faqja e parë.

20 PY. Dëshmitar, e shihni në ekran ballinën e një ditari?

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë tek faqja tjetër.

22 PY. Këtu është një kalendar për vitin 1999.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen 5 për të
24 cilën kam dhe pyetje, SITF000242167. Faqja 5 e PDF-së.

25 PY. Dëshmitar, e keni parë ndonjëherë më përpara këtë ditar?

1 Flas përpara seancës përgatitore se atje ua treguam ne, po më
2 përpara e ke parë ndonjëherë?

3 PË. Jo, nuk e kam parë dhe nuk e di.

4 PY. Ju lutem, shihini numrat në të djathtë të ekranit, numrat
5 që janë renditur për Remin, Dajën, Lekën, Latën.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Pak më lartë dokumentin.

7 PY. Është kolona që ka emrin Dardania. E shihni? I shihni
8 numrat që sapo përmenda tek Dardania?

9 PË. Po, e shoh.

10 PY. Këto numra u korrespondojnë kodeve thirrëse, shifrave
11 thirrëse që kishte zona e Llapit që i diskutuam dhe pak më
12 herët që lidheshin me atë dokumentin e UÇK-së që mbante datën
13 10 nëntor 1998?

14 PË. Po, korrespondon.

15 PY. Po numrat tek emri Kështjella, tek kolona Dardania, i
16 njihni? Ju thonë gjë këto numra?

17 PË. Si numra nuk i njoh se s'kena komuniku gjatë luftës. S'i
18 mbaj mend. Po si emra, Profa edhe Azizi. Tjerët nuk i njoh,
19 nuk e di. Ndoshta i njoh, po si pseudonime dhe nuk i njoh.

20 PY. Profa 20 --

21 PË. Po.

22 PY. -- ky kod ju thotë gjë, kjo shifër? Kush ka qenë Profa?

23 PË. Profa ka qenë komandanti i Brigadës 152, Shaban Shala.

24 PY. Ju thatë që njihni dhe Azizin, numri 30.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë.

1 DËSHMITARI: Po, Azizin, po. Po, e njoh. E njoh mbas
2 lufte.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

4 PY. Kush ishte Azizi?

5 PË. Kemi punu së bashku në Forcën e Sigurisë së Kosovës, një
6 kohë sa ka qenë. Më shumë nuk kam ndonjë informacion për të.

7 PY. A e dini çfarë roli kishte ai gjatë luftës në UÇK apo
8 nëse kishte ndonjë rol?

9 PË. Gjatë luftës nuk e kam dit. Po gjatë përgatitjes së
10 librit e kam kuptue për detyrën çfarë e ka pas.

11 PY. A mund të na tregoni si e kishit kuptuar ju detyrat e tij
12 ose çfarë roli kishte ai?

13 PË. Po gjatë studimit e kam kuptu që ka qenë, është emnu
14 dikund ka -- s'po di saktësisht, nuk jam i sigurt tani, po
15 është në librin tim kur është emëruar zëvendëskomandant i
16 Brigadës 152.

17 PY. Është Lluga 33 tek e njëjta kolonë.

18 PË. Po besoj që është --

19 PY. Tri emra poshtë Azizit. Kjo është njësia juaj, për atë
20 bëhet fjalë?

21 PË. Po. Po, besoj që po. Lluga 33, po. Orllani, mbas lufte e
22 kam kuptu që ka qenë si njësi atje. Dhe për Batllavën, po, kam
23 pasur bashkëpunim gjatë kohës së luftës me të.

24 PY. E keni fjalën Batllava 27 që është emri i fundit në këtë
25 kolonë, apo jo?

1 PË. Po, saktë.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë më lartë tani edhe
3 shohim faqen e parë në të majtë poshtë Ulpianës.

4 PY. Këtu kemi, 20 Luta. Ju thotë gjë kjo shifër thirrëse dhe
5 ky emër?

6 PË. Po. Po, kam pas nderin me e pas komandant, komandant
7 Lutën. Dhe kam pas komunikim të mirëfilltë edhe shumë
8 profesional me të.

9 PY. Idriz Shabani, apo jo, për atë bëhet fjalë?

10 PË. Po, është fjala për Idriz Shabanin

11 PY. Komandant i Brigadës 125, apo jo?

12 PË. Jo, komandant --

13 PY. 151, më falni, 151.

14 PË. Komandant i Brigadës 151.

15 PY. Po, për atë bëhet fjalë.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 25 të PDF-së,
17 kësaj here më nevojiten të dyja gjuhët. Pra, ju lutem, nxirrni
18 dhe tekstin që përfundon me -ET. Të njëjtin numër kanë thjesht
19 përfundon me -ET. Më nevojitet faqja 25 e tekstit që
20 përndryshe ka numrin SITF0024218.

21 PY. Dëshmitar, dokumenti është në ekran. Ju e shihni.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do të doja që të fokusohemi pak
23 tek teksti origjinal.

24 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë shkrim dore?

25 PË. Jo, nuk e njoh.

1 PY. Në këtë faqe është një shënim që thotë e mërkurë, 31 mars
2 1999. E shihni dot, se kam disa pyetje në lidhje me këtë, aty
3 ku thotë e mërkurë, 31 mars 1999?

4 PË. Po, e shoh.

5 PY. Këtu përmendet populli që po largohet nga fshati Surkish,
6 Ballofc, Lladrovc dhe Sfecel në këtë periudhë më 31 mars 1999.

7 Së pari, çdo të thotë fjala "shki" që shohim këtu, çfarë
8 kuptimi ka kjo fjalë? Është në fillim pak më lartë.

9 PË. Veç pak se nuk po muj me lexu. Është një shprehje
10 pezhorative që është përdor për forcat serbe në atë kohë edhe
11 që përdoret. E ka përdor kushdo që e ka shkruar këtë.

12 PY. Njësia juaj -- se shohim dhe disa fshatra që i përmenda
13 më herët. Njësia juaj, K33, shkoi në ato zona në fund të
14 marsit 1999?

15 PË. Jo, në fshatin Surksih, e thamë më herët, ka shku me 25
16 mars me urdhër të komandantit në fshatin Surkish ku atje ka
17 operue njësiti Kështjella 32 dhe ne gjatë asaj kohe kemi
18 ndihmue, kemi ndërhy atje për evakuimin e popullatës në këtë
19 fshat dhe fshatrat që kanë qenë përreth.

20 PY. Pra, keni qenë në atë territor, në atë zonë dhe keni
21 thënë që keni ndihmuar popullatën atje që të largohet nga ato
22 fshatra, kështu?

23 PË. Po, çdo gjë që ka kërkua komandanti i Kështjellës 32.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Më poshtë, kemi në ekran në
25 anglisht, po shqipen do të doja të shkonim pak më në të

1 djathtë që ta lexojmë.

2 PY. Këtu përshkruhet, pra, është data 1 prill 1999 dhe
3 përshkruan përpjekjet që kanë bërë për ta kthyer popullatën në
4 shtëpitë e tyre. Mori pjesë K33 në këtë aktivitet, pra, që të
5 ndihmonte popullatën që të kthehej në shtëpinë e tyre aty ku
6 ishte e mundshme?

7 PË. Jo, na nuk kemi vepru në këtë fshat dhe me këtë kohë më 1
8 prill ne jemi kthyer me urdhër të komandantit në fshat prapë për
9 të përcjellë situatën, gjendjen si ka qenë. Më 1 prill jemi
10 kthyer në fshatin Lluga. Nuk kemi qenë gjatë kësaj kohe në
11 fshatin Lladofc. Dhe atje s'kemi qenë asnjëherë.

12 PY. Po, po. S'e kisha fjalën që keni qenë në fshatin Lladofc.
13 Po thamë në atë territor, në atë territor, K33 --

14 PË. Po.

15 PY. -- a e ndihmoi popullatën e zonës që të kthehej në
16 fshatrat e tyre? Mund t'i thoni dhe fshatrat nëse ju kujtohen.
17 Këto i kemi diskutuar edhe i kemi parë edhe në faqet e tjera
18 të librit tuaj, i keni përshkruar këto ngjarje.

19 PË. Po, unë e di më 31, në orët e vona, kemi qenë në atë
20 rajon. Mbas kësaj periudhe jemi kthyer në fshatin Lluga. Po,
21 ne kemi ndihmu, sigurisht gjatë periudhës sa kemi qëndru atje
22 nga 25 marsi kemi ndihmue popullatën së bashku me njësi tjera
23 që të evakuohen, që të strehohen në vende ku kanë qenë ma të
24 sigurta.

25 PY. Po, në fakt, në faqen tjetër 26, përmendet fshati Llugë

1 dhe lidhet me K33 në këtë kontekst.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër që
3 është SITF00242188 në të dyja gjuhët. E zmadhojmë pak shqipen
4 në mënyrë që t'i hedhë një sy edhe dëshmitari.

5 PY. Dëshmitar, ngjarjet që përmenden në këtë faqe janë me
6 interes për mua dhe do të doja të pyesja nëse lidhen me ato që
7 diskutuam më herët kur po flisnim për pozicionin dhe
8 veprimtarinë që kishte njësia juaj në Llugë dhe fshatrat
9 përreth pas bombardimeve të NATO-s, pra, më konkretisht në
10 këto ditë të prillit 1999.

11 PË. Nëse ju kuptova drejt, unë po e përsëris që nga 25 marsi
12 pas fillimit të bombardimeve, njësia Kështjella 33 ka marrë
13 pjesë në disa operacione për shpëtimin ose për tërheqjen e
14 popullatës gjatë ofensivës që kishte ndërmarrë ushtri, policia
15 dhe paramilitarët serbë në këtë rajon. Ne në fshatin Surkish
16 kemi qëndrue deri në natën e 31 marsit. Pastaj në mëngjesin e
17 hershëm të 1 prillit jemi kthyer në fshatin Lluga, ku kemi
18 qëndrue deri më 2 prill të vitit 1999, kur jemi sulmue nga
19 policia dhe ushtria serbe dhe në mbrëmje të 2 prillit jemi
20 tërhequr për të kaluar në Halabak tek njësiti Kështjella 26 në
21 mëngjesin e 3 prillit.

22 PY. Është e qartë. Kjo është referenca që bëhet -- ka një
23 referencë për K26 në Halabak në faqen 36 të ditarit dhe që unë
24 doja t'jua tregoja në fakt.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shohim faqen SITF00242198.

1 Është një shënim që mban datën e shtunë, 17 prill 1999.

2 PY. Dhe pjesa për të cilën do të doja t'ju bëja pyetje është
3 pikërisht kjo që sapo thatë në fakt. Ju thatë që K26 ishte e
4 stacionuar në Halabak. Referencat për ju është në të majtë të
5 ekranit pra.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë në të
7 majtë.

8 PY. Ka një rresht me ngjyrë të kuqe këtu, Dëshmitar, që është
9 e nënvizuar. Mbi këtë pjesën që është vijëzuar me të kuqe
10 përmendet diçka dhe unë do t'u lexoja këtë:

11 "U konsultova me Azizin. Ai më tha që duhet të merrja
12 ushtarët dhe të shkoja në Sharban tek K26."

13 Dhe më pas "disa nga fshatarët më thanë që K26 në fakt
14 kishte bazë në Halabak".

15 Këtë e diskutuam dhe më herët kur po lexonim disa faqe të
16 tjera të librit tuaj.

17 PË. Me të thënë të drejtën nuk po e kuptoj pyetjen. Apo doni
18 me u dit saktë që atje ka qenë baza e K26 apo çka se s'po e
19 kuptoj?

20 PË. Jo, jo. Pyetja ime është kjo: Kjo që diskutohet në këtë
21 faqe a është pikërisht ajo që keni treguar dhe ju në librin
22 tuaj për të njëjtat ngjarje në të njëjtën periudhë, a
23 përputhet me përshkrimin që keni bërë dhe ju?

24 PË. Po, pjesërisht. Po.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faqja 37, ju lutem, e PDF-së në

1 të dyja gjuhët. SITF00342199.

2 PY. Data këtu është 18 prill 1999, ka një paragraf këtu që
3 përmend K33 në këtë tekst. Do t'ua lexoj një pjesë. Ju lutem
4 ndiqeni dhe ju nga teksti që keni në të majtë ose nga
5 përkthimi me gojë.

6 "Popullata filloi të largohej nga Tërnavë dhe shkoi në
7 drejtim të Koliqit dhe që prej andej drejt Dyzit. Situata nuk
8 ishte e mirë, prandaj kishte shkuar K27."

9 Pak më poshtë:

10 "Azizi, K26 dhe unë shkuam në krye të një kodre të madhe,
11 në majë të një kodre të madhe në Halabak dhe e ndoqëm prej
12 atje situatën. Popullata po largohej shumë shpejt edhe armiku
13 bëri disa sulme të egra."

14 Më poshtë --

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt në shqip duhet të
16 zhvendosni pak faqen, po.

17 PY. "Azizi mori disa ushtarët e K36 dhe i pozicionoi në një
18 pyll mbi Halabak."

19 Dëshmitar, pra, ju kujtohen ato ngjarjet e 18 prillit
20 1999?

21 PË. Po. Po, më kujtohen.

22 PY. Dhe a janë të ngjashme me ato që përshkruhen këtu, a
23 përputhet --

24 PË. Po, pra.

25 PY. -- me atë që ju kujtohet dhe juve?

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 43

1 PË. Po tash shtrirja e njërive dhe si e paska bërë Azizi unë
2 nuk mund ta --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 duhet të prisni ju lutem sa të përfundojë pyetja. Duhet të
5 prisni të përfundojë pyetja përpara se të jepni përgjigjen.

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

7 PY. Pra, ju thatë që ju kujtohen ngjarjet e asaj dite të 18
8 prillit të 1999. Pra, sa i përket këtyre përshkrimeve sa i
9 takon kësaj date a pasqyrojnë këto përshkrime ato çfarë kanë
10 ndodhur ajo çfarë ju kujtohet juve se të ketë ndodhur më datë
11 18 prill?

12 PË. Po përsëris, pjesërisht, po. Po unë nuk muj i di të
13 gjitha sesi i ka rreshtu njësitë Azizi në atë kohë. Por, po.

14 PY. Sigurisht. Ju e keni përmendur dhe më herët Azizin. A ju
15 kujtohet si e ka pas emrin e plotë Azizi, që thatë që e keni
16 mësuar pas luftës?

17 PË. Për momentin s'më kujtohet. Mbiemnin Hyseni e di që e ka
18 po -- po, Aziz Hyseni.

19 PY. Në rregull.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e di që
21 kjo është pjesë, domethënë, këto faqe që sapo pamë janë pjesë
22 e dokumenteve që janë pranuar nga ZPS-ja në parashtrimin F2178
23 dhe përderisa është përdorur kjo pjesë e dokumentit me
24 dëshmitarin, do kërkoja që të shënohet për identifikim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 44

1 caktojeni për identifikim.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sa për sqarim, të
3 nderuar Gjykatës, a duhet të caktoj me numër të përkohshëm a
4 prove vetëm faqet e përdorura apo të gjithë dokumentin nga
5 00242163 deri në 00242296?

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] I gjithë materiali, sepse ky
7 është materiali në fakt i tëri i cili është kërkuar që të
8 pranohet nga Trupi Gjykses pa trajtim përpara Trupit Gjykses.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kërkojmë
10 që vetëm faqet që u përmendën të mund të marrin numër të
11 provës provizore. Dhe nga ana tjetër kemi mungesë themelësie
12 përpara sa i takon pranimit të dokumentit sepse dëshmitari nuk
13 e ka parë asnjëherë më përpara këto dokument dhe nuk e njeh
14 shkrimin e dorës.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk
16 kërkoja caktim të provës materiale për momentin, po thjesht
17 një numër provizor prove.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Atëherë t'i caktohet një numër provizor ose një numër
20 identifikimi.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 dokumenti SITF00242163 deri në 00242296 do t'i caktohet numri
23 P01555.

24 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa i takon
25 pranueshmërisë së këtij dokumenti, a kërkon që t'i japim

1 shpjegime ose parashtrime sepse nuk duhet të pranohen si
2 prova?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A dëshironi që të bëjmë
5 parashtrime me shkrim në përgjigje të mocionit të bërë nga
6 Prokuroria për pranimin e dokumentit si provë?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
8 dëshironi që të përgjigjeni sa i takon mocionit, po, mund ta
9 bëni me shkrim përgjigjen tuaj.

10 Mund të vazhdoni, znj. Prokurore.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
12 paraqesë në ekran librin e dëshmitarit nga SPOE00055678 deri
13 në SPOE00056018 në të dyja gjuhët. Ju lutem paraqisni faqen 39
14 që ka numrin SPOE00055713. Ju lutem kalojmë pak më poshtë në
15 të dyja versionet në anglisht dhe në shqip për ta pas pak më
16 të qartë tekstin.

17 PY. Dëshmitar, ju lutem hidhini një sy kësaj pjese. Për t'u
18 kujtuar për përmbajtjen e tij, është një pjesë që diskuton
19 seksionin e mbrojtjes civile. Ju keni thënë në intervistën me
20 ZPS-në, që është prova 1545.1, ju keni thënë që në fillim të
21 kyçjes tuaj në UÇK, duke filluar nga marsi i 1998, ju i keni
22 raportuar Muhamet Latifit që ka qenë komandant i mbrojtjes
23 civile. A është informacion i saktë ky, Dëshmitar, dhe keni
24 thënë gjithashtu që keni ndihmuar për mobilizimin dhe
25 organizimin e personave që donin të kyçeshit në UÇK, është e

1 saktë kjo?

2 PË. Po, është e saktë. Nga 20 maji i vitit 1998 kur jam kyç
3 në UÇK, kam kontribue dhe kam bashkëpunue me Muhamet Latifin
4 në mobilizimin dhe shtrimin e UÇK-së në zonën operative të
5 Llapit.

6 PY. Në rregull. Në paragrafin e parë të faqes 39, ju thoni që
7 Muhamet Latifi nga mbrojtja civile, Salih Mustafa nga njësit
8 BIA dhe Skënder Murati nga sektori i shëndetësisë kanë qenë
9 pjesë e strukturës organizative të zonës së Llapit të UÇK-së,
10 a është e saktë kjo?

11 PË. Po, është e saktë.

12 PY. A i keni intervistuar këta tre komandantë për qëllime të
13 librit tuaj, Dëshmitar?

14 PË. Po, i kam intervistuar, kam biseduar me ta.

15 PY. Po, sepse, në fakt, këta janë emrat që janë renditur në
16 listën e personave që ju keni intervistuar në listën e
17 personave në faqen 231 dhe 32. A keni përdorur intervistat që
18 keni bërë me Salih Mustafën dhe me persona të tjerë për sa i
19 takon përshkrimin që keni dhënë në librin tuaj në këtë pjesë,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, i kam përdorur. Po i kam përdorur, por nëse më lejohet
22 dhe ma herët e kërkova fjalën, du me sqaruar në lidhje me
23 intervistat diçka.

24 PY. Po, po. Shpjegoni, ju lutem.

25 PË. Sa i përket intervistave unë e kam thënë edhe në

1 parathënie të librit tim se ka qenë një sfidë jashtëzakonisht
2 e madhe gjatë përgatitjes së librës. Intervistat janë përdor
3 vetëm në momentet kur nuk kam pas një burim të parë. Dhe këto
4 intervista apo biseda që i kam zhvillu me ta nuk kam përdor
5 një formular standard ose një pyetësor standard. Intervistat
6 nuk kanë qenë të saktësime me datën. Nuk kanë qenë të
7 nënshkruara nga unë dhe nga bashkëbiseduesi im apo nga ai që
8 jam intervistuar. Këtë e kam theksuar edhe në parathënien time
9 të librit në atë kohë në vitin 2008 kur është botuar,
10 respektivisht në vitin 2006, 2007. Kështu që --
11 PY. Po, ashtu vërtetë. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres,
12 Dëshmitar. Po nuk kemi shumë kohë. Ju në fakt keni dhënë
13 hollësi sa i takon intervistës, përfshirë këtu edhe mënyrën
14 sesi janë bërë intervistat, e të tjerë. Pra, kjo është e
15 përmbledhur në pjesën e intervistës tuaj me ZPS-në dhe kjo
16 pjesë e intervistës tuaj, si gjithë intervista që i keni dhënë
17 ZPS-së, janë pranuar si prova materiale së bashku me shënimin
18 përgatitore. Domethënë, ajo çfarë po shpjegoni aktualisht
19 është pjesë e dëshmisë tuaj dhe është pranuar si provë.
20 Megjithatë, dua t'ju falënderoj dhe një herë që e theksuat
21 këtë gjë.

22 Do të vazhdojmë me pyetjet, Dëshmitar. Ju thatë që i keni
23 përdorur këto intervista. Thatë që keni dhënë sqarime
24 përkatëse. Sa i takon mbrojtjes civile a e keni mbështetur
25 informacionin lidhur me mbrojtjen civile që përmendet në

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 48

1 librin tuaj, po ashtu mbështetur në përvojën tuaj si ushtar i
2 UÇK-së që ke punuar në atë sektor në atë kohë?

3 PË. Po. Po, sigurisht. Unë gjatë përgatitjes së librit atje
4 ku kam pas përvojën time gjatë luftës sigurisht që e kam
5 shfrytëzue. Në të kundërtën, unë ju kam referue gjithherë
6 burimeve, referencave të cilat në atë kohë unë kam mujt me ju
7 qas.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër, faqja
10 40, SPOE00055714.

11 PY. Do ju kërkoja që të shikonit poshtëshënimin 23,
12 Dëshmitar. Ky është një shembull i mënyrës se si ju keni
13 cituar përmbajtjen e intervistës që keni patur me Salih
14 Mustafën. Në këtë faqe përshkruhet njësitit BIA. Në paragrafin
15 e parë të kësaj faqeje ju thoni se shenja thirrëse e njëstit
16 BIA në sistemin e komunikimeve ka qenë Skifteri dhe pastaj
17 vazhdon më tej dhe thoni që burimi i këtij informacioni,
18 domethënë, në poshtëshënimin 23, është Salih Mustafa,
19 intervista që keni pasur me të në 2007. A e konfirmoni këtë,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, e konfirmoj.

22 PY. Në rregull. Tani vazhdojmë qëndrojmë në këtë faqe. Kam
23 një pyetje lidhur me fotografinë në këtë faqe.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në qoftë se do të vazhdojmë do
25 i kërkoja Sekretares të shkonim më sipër në faqe, në të dyja

1 versionet në anglisht dhe në shqip.

2 PY. Këtu e shikoni këtë shpjegimin pas fotografisë,
3 domethënë, poshtë fotos. E lexoni, Dëshmitar. Me ç'kuptoj unë
4 emrat dhe, në qoftë se e kam gabim më thoni, domethënë, emrat
5 me gurmë të madhe në anglisht të paktën, domethënë, mbiemrat
6 janë dhënë me të madhe por jo në shqip. Janë Cali, Bafta,
7 Cufa, Dardani. Domethënë, këto janë nofkat e personave që janë
8 në këtë fotografi, aspo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, nofka e Salih Mustafës ishte Cali, nofka e Bahri
11 Gashit ishte Bafta e kështu me radhë, kështu i takon,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, kështu i kam njoft mbas lufte. Do të thotë gjatë
14 punimit, gjatë studimit, unë e kam kuptu sesi i kanë pas
15 nofkat. Ndërsa gjatë kohës së luftës nuk kam pas fatin me i
16 taku dhe me i njoft. Mbas lufte, po.

17 PY. E kuptoj. Nuk ke punuar në njësitin BIA është e qartë
18 kjo. Faleminderit.

19 Këto faqe, pra, besoj që në vëllimin e dytë janë me
20 ngjyra, domethënë edhe fotoja duhet të jetë me ngjyra në
21 vëllimin e dytë.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk është se do kërkoj që të
23 paraqitet dokumenti për referencë, megjithatë këto janë kopje
24 me ngjyra të 121952 deri në 121953.

25 Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohen në prova faqet

1 e mbetura, që është pjesë e prezantimit të librit që janë nga
2 faqja 39 deri në 43 ose ndryshe me numrin SPOE00055713 deri në
3 717, që të shtohen te prova P187 si dokumente publike si dhe
4 kopjet me ngjyra të faqeve 39 dhe 40, të cilat janë të
5 shënuara me numër ERN 121952 deri në 121953, të shtohen tek
6 prova P187.1, përsëri me klasifikimin publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

10 PËRKTHYESJA: Ekipet e tjera të Mbrojtjes, nuk kemi
11 kundërshtime.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
13 ka kundërshtime, pranohet në prova dokumenti përkatës.
14 Gjithashtu edhe i 121952 deri në 121953 bëhet me shifrën
15 përkatëse, pra, bëhet zëvendësimi me dokumenteve me ngjyra.

16 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të vazhdoj më tej? Ju
17 kërkoj ndjesë.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do bëjmë shtimet
19 përkatëse të faqeve që u përmendën nga Prokuroria.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni tani.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani vazhdojmë me faqen 187 ose
23 SPOE00055852 të librit. Do i kërkoja Sekretares që të mbajë
24 versionin në shqip dhe të paraqesë tek pjesa e anglishtes
25 dokumentin me referencën 121962. Në vend të versionit në

1 anglisht, domethënë, të dy dokumentet duhet të jenë në shqip.
2 PY. Dëshmitar, shikojmë në të dyja vëllimet e librit --
3 atëherë së pari, ky është një vendim i UÇK-së që mban datën 19
4 nëntor 1998 dhe shohim këtu nënzonat operative të UÇK-së që
5 bëhen zona operative. Është një dokument i cili është i
6 nënshkruar dhe i vulosur. A e keni përdorur këtë dokument në
7 librin tuaj përveçse e keni përfshirë në këtë faqe?

8 PË. Po, e kam përdor.

9 PY. Për shembull, do kërkoj që të paraqitet në ekran një prej
10 referencave të përdorura në librin tuaj që jepet në faqen 66
11 të librit.

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Atëherë mund të heqim
13 dokumentin me ERN 121962 dhe do i kërkoja Sekretares të
14 paraqesë faqen 66 në të dyja versionet, në të dyja gjuhët që
15 është SPOE00055740. Ndërkohë që bën Sekretaria këtë gjë, për
16 procesverbal dua të sqaroj që një version tjetër i 19 nëntorit
17 1998, pra, vendimi që mban këtë datë është i pranuar si provë
18 më numrin P01016.

19 Të kalojmë në fund të faqes në mënyrë të tillë që
20 dëshmitari mund të shikojë poshtëshënimin.

21 PY. Dëshmitar, shihni ju lutem poshtëshënimin numër 80 në
22 fund të faqes, pra, shohim që është referenca e këtij
23 dokumenti të vendimi që pamë më përpara që mbante datën 19
24 nëntor 1998. Ju e konfirmuat që referenca në këtë faqe është
25 në kontekstin e riorganizimit të nënzonave të UÇK-së në zona

1 që diskutohen në këto faqe, domethënë, në faqen 63 deri në 66,
2 kështu, Dëshmitar?

3 PË. Po, është e saktë. A më lejon të shtoj diçka?

4 PY. Nëse lidhet me pyetjen, po, patjetër shtoheni. Në të
5 kundër sikurse e thashë e kam kohën e kufizuar dhe qëllimi im
6 është që të konfirmoja këtë dokument apo jo. Domethënë,
7 sqarimi që doni të bëni lidhet me këtë dokument, apo jo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Me dokumentet të cilat i kam përdor dhe i kam marrë në
10 arkivin e Zonës 5.

11 PY. Po, patjetër.

12 PË. Të gjitha dokumentet që cilat unë i ka përdor, i kam marr
13 në arkivin e Zonës 5 të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Kanë
14 qenë dokumente të pasistemume. Këtë e kam theksu edhe në
15 parathënie. Çka don me thënë me këtë? Lidhur me autenticitetin
16 e tyre, me përmbajtjen e tyre, me nënshkrimet e tyre, me
17 autorësinë e tyre, nuk mbaj në kuptimin e studimit
18 përgjegjësi, për faktin se këto dokumente mund të jenë në
19 duart e shumë personaliteteve dhe mund të përdoren dhe
20 keqpërdoren në momente të caktume.

21 PY. Dëshmitar, nuk ju kërkova që të bënit komente lidhur me
22 autenticitetin e dokumenteve, siç e thatë vetë. Ju falënderoj
23 për sqarimin, por duhet të mbani parasysh qëllimin e pyetjeve
24 që ju bëj unë, domethënë, do ishte mirë që t'i përgjigjeni
25 pyetjeve që ju bëj në mënyrë të tillë që të mund të vazhdojmë

1 pa vonesë.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja
3 kërkon që të pranohet në prova kjo pjesë që është nga faqet 63
4 deri në 66, që është SPOE00055637 deri në 55740, si dhe faqen
5 178, SPOE00055852 dhe kërkojmë që të shtohen në provën P187,
6 si dhe versionin me ngjyra i faqes 178, me numër ERN 121962 që
7 kërkojmë që t'i shtohet provës P187.1. Dhe klasifikimi të jetë
8 publik për të gjitha këto seksione.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
10 kundërshtime?

11 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo.

12 PËRKTHYESJA: [Përkthim] Ekipet e tjera nuk kanë
13 kundërshtime.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
15 ka kundërshtime, dokumentet e cituara pranohen si prova.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do i caktojmë faqet
17 sipas provave të dhëna.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam edhe
19 një dokument tjetër, po përderisa ka shkuar ora 11.00 besoj që
20 do bëjmë pushimin tani.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
22 bëjmë gjysmë ore pushim tani. Mund të largoheni nga salla i
23 shoqëruar nga Asistentja.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 --- Pauza fillon në orën 11.01

2 --- Seanca rifillon në orën 11.30

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
4 dëshmitarin në sallë.

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam
6 edhe 15 minuta pyetje të mbetura.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
10 Prokuroria ka edhe disa pyetje të mbetura për ju.

11 [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

13 A mund t'i kthehemi librit të dëshmitarit dhe të shfaqim
14 në ekran në të dyja gjuhët faqet 145 dhe 146 me numër
15 SPOE00055819 deri në 820. Këto faqe janë pjesë e provës P187.
16 PY. Dëshmitar, në faqet që do të dalin në ekran, për t'ju
17 dhënë kontekstin, janë faqet që lidhen me vizitën e Shtabit të
18 Përgjithshëm më 18 deri 20 gusht të 1998-s.

19 Shohim faqen 145 konkretisht paragrafin që është
20 menjëherë poshtë fotografisë në të dyja gjuhët.

21 Në këtë pjesë ju thoni se si nga data 18 deri më 20 gusht
22 të 1998-s, zonën e Llapit e vizituan përfaqësuesit e Shtabit
23 të Përgjithshëm të UÇK-së dhe keni radhitur personat që ishin
24 në delegacion. Thoni:

25 "Delegacioni ishte në përbërje Hashim Thaçi, Rexhep

1 Selimi, Jakup Krasniqi dhe Bislim Zyrapi.”

2 Ky është paragrafi menjëherë poshtë fotografisë.

3 Unë shoh tek poshtëshënimi 288, me sa kuptoj ju e keni
4 bazuar informacionin për këtë vizitë në atë që ju kanë thënë
5 komandantët e zonës së Llapit. E keni përmendur në
6 poshtëshënimin 288, z. Mustafa, Kastrati, Nuredin Ibishi dhe
7 Idriz Shabani. Pra, në atë çka ju kanë thënë ata në intervistë
8 për qëllim të këtij libri, kështu?

9 PË. Po, kështu, kështu është e saktë.

10 PY. Më pas në intervistën për ZPS-në ju dhatë më shumë
11 hollësi për intervistat dhe pse kishit përzgjedhur personat të
12 caktuar për këto intervista.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për procesverbal, kjo është
14 pjesë e provës materiale gjyqësore P1545.2, faqet 17 dhe 18.

15 PY. Mbetemi te faqja 145. Paragrafi i fundit i kësaj faqeje,
16 thotë:

17 “Vizita ishte e karakterit zyrtar, delegacion në orët e
18 vona në mes 17-18 gushtit u prit nga Komandant Remi...”

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
20 lutem.

21 PY. Pra, Komandant Remi, pastaj vazhdon:

22 “...shoqëruar nga Latif Gashi, Kadri Kastrati, Fatmir
23 Humolli, Hyzri Talla, Nuredin Ibishi dhe Sabri Kiçmari.”

24 Ju lutem, shikojeni pak përmbajtjen e kësaj faqeje që
25 t'ju rifreskohet kujtesa lidhur me atë që keni shkruar për

1 këtë vizitë.

2 Ju keni thënë kështu që gjatë kësaj vizite u bë
3 zyrtarizmi i strukturave të komanduesve të zonës operative të
4 Llapit. U emëruan komandantët. Ka disa pika, pra, në këtë faqe
5 që unë i përmenda shkurtimisht. Keni përmendur disa nga temat
6 që janë diskutuar si organizimi, zgjerimi i UÇK-së, furnizimi
7 me armë e kështu me radhë.

8 Në të njëjtën faqe thoni nga fundi që:

9 "...delegacioni ka marrë pjesë në një inspektim në
10 Kaçanoll, dhe keni përmendur dhe njohuritë taktike-
11 strategjike."

12 Ju kujtohen këto pjesë të librit?

13 PË. Po, më kujtohen.

14 PY. Ju, vetë gjatë vizitës keni qenë i pranishëm?

15 PË. Jo, unë nuk kam qenë i pranishëm gjatë vizitës bazuar në
16 referencat që unë i kam përdorur; vizita ka ndodhur dhe
17 vlerësoj që është e rëndësishme me e potencue që në zonën
18 operative të Llapit, për këtë e kam quajtur edhe "u bë
19 zyrtarizimi" për faktin se më 18 korrik, Komandanti Rrustem
20 Mustafa veç i kishte emëruar këto struktura, këto
21 personalitete në pozita me përgjegjësi. Do të thotë më 18
22 korrik këta personalitete ishin të emëruar. Kështu që gjatë
23 vizitës vetëm u zyrtarizuan. Komandant Remi e njoftoi
24 delegacionin e Shtabit të Përgjithshëm me vendimet të cilat i
25 kishte marrë paraprakisht.

1 Kështu që, kjo vizitë pavarësisht që unë e kam quajtur si
2 zyrtarizim edhe zyrtare të gjitha ato emërime që i kishte bërë
3 më herët Komandanti Rrustem Mustafa këto i miratuan ose u
4 miratuan nga ky delegacion. Dhe sigurisht e kam potencue edhe
5 vendimet që janë marrë. Unë referencë i kam pas intervistat që
6 i kam bërë me komandantët, por edhe literaturë tjetër që e kam
7 shfrytëzuar në atë kohë që ka qenë si referencë.

8 PY. Po, e kuptoj që referencat në këto faqe janë mbështetur
9 në intervistat. Pra, përshkrimin e keni mbështetur në
10 intervistat që i keni bërë me komandantët e zonës, Remi,
11 Kastrati, Ibishi, sikurse vetë e keni cituar në poshtëshënimin
12 288 dhe bazuar në këtë që sapo na thatë. Pra, ju vetë nuk keni
13 qenë i pranishëm, por burimi i kësaj që keni shkruar është
14 bazuar në intervistat që keni bërë me komandantët e kësaj
15 zone, apo jo?

16 PË. Po, e saktë. Unë nuk kam qenë pjesë e këtyre takimeve,
17 por shënimet i kam mbështetur në të dhënat që kam marrë nga
18 intervistat me drejtuesit e zonës operative të Llapit.

19 PY. Tani do doja t'ju tregoja përshkrimin që kemi ne për këtë
20 vizitë që është "Pika e kthimit" -- "Kthesa e madhe" - më
21 falni - e z. Jakup Krasniqi. Do doja të shfaqnim dokumentin
22 ERN U015-8743 deri në U015-9047 dhe përkthimi në anglishte që
23 ka të njëjtën ERN, por që përfundon me ET Revised 1 në fund.
24 Ky është libri. Kemi folur gjatë seancës përgatitore për këtë
25 libër.

1 Do doja që në ekran të shfaqej faqja 116 që është me ERN
2 U015-8815, 8859 në të dyja gjuhët. Më nevojitet fundi i faqes
3 edhe tek shqipja.

4 PY. Dëshmitar, ju mund ta shihni vetë në ekran, në fund të
5 kësaj faqe, të faqes 116 përmendet nënzona e Shalës dhe e
6 Llapit. Këtu thuhet ishte fillimi i gushtit 1998 kur Shtabi i
7 Përgjithshëm i UÇK-së kishte caktuar një delegacion për të
8 vizituar Shalën dhe Llapin. E shihni?

9 PË. Po, e shoh.

10 PY. Më pas bëhet një përshkrim, përmenden anëtarët e
11 delegacionit. Këtu thuhet:

12 "Në delegacion ka qenë Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi,
13 Rexhep Selimi dhe Bislim Zyrapi."

14 Pra, është i njëjti delegacion -- a është i njëjti
15 delegacion ky që pamë dhe në faqen tuaj të librit?

16 PË. Po.

17 PY. Do të vazhdoj të lexoj nga fundi i faqes, por duhet të
18 kalojmë në faqen tjetër përpara se ta bëj këtë. Do të lexoj
19 rreshtin e fundit.

20 "Shkuarja jonë kishte për qëllim që të njiheshim me
21 përgatitjet që po bëheshin..."

22 Kalojmë në faqen tjetër, ju lutem:

23 "... të njiheshim me përgatitjet e Ushtrisë Çlirimtare të
24 Kosovës, t'i bënim emërimet e kuadrit komandues dhe të
25 njoftonim rrjedhat e luftës në pjesët e tjera të terrenit."

1 A përputhet kjo, Dëshmitar, dhe me informatat që keni
2 marrë ju nga komandantët e UÇK-së që keni përmendur dhe keni
3 referuar në librin tuaj?

4 PË. Po, përputhet, por unë siç i kam thënë, edhe unë kam
5 lexuar librin në fjalë dhe në atë kohë sigurisht për mua ka
6 qenë një ndër referencat kryesore në të përgjithshmen e kam
7 fjalën, por përputhen nga ajo që po e themi tash.

8 PY. Që ta sqarojmë, ju thatë, ju në librin tuaj nuk keni
9 cituar librin e z. Krasniqi si burim, si pjesë të
10 bibliografisë për këtë vizitë të datës 18-20 gusht. Pra, nuk e
11 kemi parë që t'i jeni referuar këtij libri?

12 PË. Në këtë rast nuk iu kam referuar; i kam referuar në atë
13 kohë intervistave që kam pas me stafin komandues.

14 PY. Që ta sqaroj, burimi i përshkrimit në librin tuaj, për
15 këtë vizitë, për këtë vizitë konkrete të Shtabit të
16 Përgjithshëm më 18 dhe 20 gusht 1998 është bazuar në
17 intervistat që keni bërë me komandantët e zonës së Llapit.
18 Pra, nuk jeni mbështetur në librin e z. Krasniqi, e kuptova
19 drejt?

20 PË. Në këtë rast i jam referuar intervistave.

21 PY. Kur thoni "në këtë rast" e keni fjalën për këtë pjesë të
22 librit tuaj? Pra, vetëm për këtë pjesë të librit tuaj jeni
23 mbështetur në intervistat; pra, nuk jeni mbështetur në librin
24 e z. Krasniqi? Dua të jemi 100 për qind e qartë, prandaj po ju
25 pyes.

1 PË. As nuk jam mbështet në librin e Jakup Krasniqit, por në
2 pjesë të tjera sigurisht iu kam referuar sepse për neve ka
3 qenë burim kryesor.

4 PY. Po, po. E kemi parë që është pjesë e bibliografisë që
5 librit dhe e keni përdorur në pjesë të tjera. Por unë e kisha
6 vetëm për këtë vizitë konkretisht. Tani e kemi të qartë. Po
7 vazhdoj.

8 Ishim në faqe 117, thatë që, po, përputhet kjo me
9 informacionin që keni marrë dhe ju prej komandantëve të UÇK-
10 së.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen 118 me ERN
12 U015-8861. Sërish në të dyja gjuhët. Po lexoj në nga gjysma e
13 poshtë e faqes, gjysma e dytë e faqes.

14 PY. Ose mund ta ndiqni vetë ose ta ndiqni përmes përkthimit
15 me gojë. Është në mes të faqes:

16 "Në të njëjtën mbrëmje rreth orës 24:00 do të shkojmë në
17 selinë e Shtabit të Zonës Operative të Llapit, ku do të na
18 pret komandanti i zonës operative të Llapit Rustem Mustafa,
19 Remi, me bashkëpunëtorët e tij politikë dhe ushtarakë. Aty
20 ishin: Latif Gashi, 'Lata'; Hyzri Talla; Komandant 'Daja';
21 Kadri Kastrati; e Leka; Fatmir Humolli e Sabri Kiçmari."

22 Po kjo përputhet me informacionin që keni përshkruar dhe
23 ju në librin tuaj bazuar në intervistat që keni kryer me
24 komandantët e zonave të Llapit?

25 PË. Po, përputhet.

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faqja tjetër 119, ERN U015-
2 8862.

3 PY. Po lexoj disa pjesë të kësaj faqeje:

4 "Të nesërmen vizitua trasetë e Nënzonës Operative të
5 Llapit dhe inspektua ushtrimet taktike."

6 "Atëherë llapianët nuk kishin hyrë në luftë. Gjatë këtij
7 udhëtimit pune emëruam komandantët e zonave, zëvendësit e tyre,
8 dhe komandantët e brigadave, dy për Llap e dy për Shalë."

9 A përputhet edhe kjo me informacionin që ju dhanë
10 komandantët e zonës së Llapit gjatë këtyre intervistave dhe që
11 i keni përshkruar më pas në librin tuaj në faqen 145 dhe 146?
12 PË. Po, përputhet.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që
14 të pranohet kjo pjesë konkrete e librit për Shalën dhe për
15 Llapin. Të katërta faqet që përmenda. Gama e këtyre faqeve ka
16 numërtimin U015-8859, U015-8863 në të dyja gjuhët dhe do
17 kërkoja që këto faqe t'i bashkëngjiten provës P189 dhe
18 klasifikimin ta kenë publik.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtime? Nuk ka kundërshtime, në rregull.

21 Dokumenti me numër U015, më falni edhe një herë,
22 dokumenti me numër U015-8743, më falni, i harrova numrat,
23 duhet të m'i lexoni edhe një herë znj. Prokurore.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Prokurorja e ka numrin [Sipas
25 përkthimit] të fikur.

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 62

1 U015-8859 deri në U015-8863, t'i bashkëngjiten provës
2 P189.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohen.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kam nevojë për një
5 sqarim, sepse faqja që shohim në faqe ka numrin 8862 dhe
6 avokatja përmendi faqen 8862, por tani tha 8863. Ju lutem, ma
7 konfirmoni.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E kisha fjalën deri te faqja
9 120 që është fundi i këtij seksioni dhe kalon pak në faqen
10 8863. Është paragrafi i mbetur.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është
12 thënë në procesverbal.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Do t'i
14 bashkëngjiten provës P189.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, z. Naim Kadriu, e keni njohur gjatë luftës?

17 PË. Jo, nuk e kam njohur.

18 PY. Po emrin ia kishit dëgjuar kur ishit ushtar i UÇK-së në
19 '98, '99?

20 PË. Jo, nuk ia kam dëgjuar.

21 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kam edhe dy pyetje të fundit.

22 Do doja që në ekran të shfaqej faqja 310 e librit me

23 SPOE0005984 [Sipas përkthimit].

24 PY. Dëshmitar, në shqip e shohim faqen. Nga kjo faqe, në këtë
25 faqe keni dhënë një listë të gjithë intervistave që keni bërë

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. D'Ascoli

Faqe 63

1 me komandantët dhe luftëtarët e UÇK-së në zonën e Llapit ku
2 keni marrë disa prej fakteve që i keni dhënë më pas në librin
3 tuaj.

4 Ju e keni shpjeguar pse i keni përdorur këto intervista
5 edhe çfarë nënkuptojnë datat e ndryshme; kjo është shpjeguar
6 në Pjesën 2 të intervistës suaj, për referencë nuk po e lexoj
7 më atë pjesë, nuk është nevoja.

8 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Por do doja të thoja faktin që
9 disa prej intervistave që diskutuam, që diskutuam sot, pra,
10 përmenden në këto faqe dhe meqë është pranuar vetëm faqja 310
11 në provën P178 do doja që për të pasur të plotë këtë kontekst
12 të shtonim dhe faqen 311 deri në 313 që ka numrin SPOE00055985
13 - 00055987 edhe do kërkoja që t'i bashkëngjitej provës 187 dhe
14 të ketë klasifikimin publik.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë
18 kundërshtime.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
20 kundërshtime. Dokument 055985 deri në 0055987 pranohet dhe i
21 shtohet provës P0187.

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe dy materiale të tjera që do
23 kërkoja të pranoheshin. Bëhet fjalë për faqen me ngjyra të
24 faqes 180 të librit me numër SPOE00055845 që është pjesë e
25 faqeve të pranuar. Pra, pjesë e provës 187 si dhe kopja me

1 ngjyra ka marrë numrin ERN121963. Do lutesha që edhe kjo faqe
2 t'i bashkëngjitet provës 187.1 me klasifikimin publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
4 kundërshtime?

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë
6 kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
8 SPOE0055845 dhe dokumenti me ngjyra që ka numrin 121963
9 pranohet dhe i bashkëngjitet provës P0187.

10 Një çast.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju konfirmoj se këto
12 faqe do t'i bashkëngjiten provës përkatëse.

13 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do doja që te prova P187 të
14 shtonin edhe pasqyrën e lëndës së librit. Është për kollajllëk
15 të gjitha provave që pranuan sot. Pasqyra e lëndës si dhe
16 shkurtesat mund të gjenden në faqen 7 deri 12 të librit me
17 numër SPOE00055681 deri në SPOE00055686. Do lutesha që dhe
18 këto t'i bashkëngjiten provës P187 dhe të jenë publike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
20 kundërshtime?

21 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë
22 kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Materiali 00055681 -- 00055686 pranohet dhe i bashkëngjitet
25 provës P187.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E konfirmoj.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, unë kaq pyetje kisha për ju. Ju faleminderit.

4 Të nderuar Gjykatës, këtu përfundoj pyetjet e mia.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Menegon,

6 a keni pyetje?

7 Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon:

8 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

9 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë do t'ju bëj disa pyetje në emër
10 të z. Hashim Thaçi.

11 Dëshmitar, ju keni qenë profesor historie nga viti 1992
12 deri në vitin 1998, kështu?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Në maj të '98-s u kyçët në UÇK në zonën e Llapit, saktë?

15 PË. Po.

16 PY. Ju nuk kishit ndonjë formim ushtarak, apo jo, përveçse
17 shërbimit ushtarak të detyrueshëm që keni bërë përpara se të
18 kyçeshit në UÇK?

19 PË. Kështu është.

20 PY. Faleminderit. Kur u kyçët fillimisht në UÇK ishit
21 përgjegjës për mobilizimin dhe organizimin e civilëve që
22 deshën të kyçeshin në UÇK, saktë?

23 PË. Mund të them ashtu.

24 PY. Po ju nuk keni qenë vetë pjesë e Shtabit të UÇK-së, por
25 keni punuar nga shtëpia juaj, të paktën deri në vjeshtën e

1 '98-s, saktë?

2 PË. Anëtari i Shtabit të UÇK-së nuk kam qenë dhe sipas
3 rrethanave kemi vepruar.

4 PY. Pra, ju kryesisht keni qëndruar në shtëpinë tuaj në Jugë
5 apo jo, në Llugë, në Llugë?

6 PË. Në Lluga, po, një kohë.

7 PY. Pra, ju nuk jeni takuar me komandantin e zonës të paktën
8 për gjashtë muajt e parë që keni qenë në shërbim, pra, nuk
9 jeni takuar me të deri nga nëntori i '98-s, saktë?

10 PË. Përafërsisht, po.

11 PY. Dhe më pas në tetor të '98-s ju ndihmuat për krijimin e
12 njësisë K33 në Llugë, kështu?

13 PË. Po, ashtu është.

14 PY. Dhe keni qëndruar në Llugë deri në prill të '99-s,
15 ndonëse shtabi i Llapit u zhvendos në Llapashticë, kështu?

16 PË. Ekskluzivisht në Lluga kemi ndejt deri më 25 maj, në
17 mars, më falni, deri në 25 mars. Nga 25 marsi deri më 1, me 31
18 mars kemi qenë në fshatin Surkish. Jemi kthye dy ditë, 1 dhe 2
19 prill, pastaj kem kaluar në fshatin Halabakë në mëngjesin e 3
20 prillit të vitit 1999.

21 PY. Faleminderit. Dhe në fakt në prill të '99-s njësia juaj u
22 bashkua me një njësi tjetër. Pra, K33 dhe K26 u bashkuam në
23 Halabakë, kështu?

24 PË. Nuk u shkri, por filluam bashkëpunimin me njësinë K26 dhe
25 po, ashtu është.

1 PY. Faleminderit dhe ju u bëtë zëvendëskomandant i këtij
2 njësiti të ri?

3 PË. Po, ramë dakord, nuk e -- Kështjella 33 nuk u shua,
4 vazhdoi me të njëjtin emër, por ramë dakord që unë të jem
5 zëvendëskomandant i komandantit të Kadri Avdiut.

6 PY. Ky bashkëpunimin u bazua, pra, e dhanë miratimin të
7 gjithë luftëtarët në një mbledhje që u mbajt mes këtyre dy
8 njësive më 31 prill [Sipas përkthimit], kështu?

9 PË. Me 31 prill, jo. Po ashtu ka qenë, kanë --

10 PY. Jo e kisha fjalën në fakt për 21 prillin, siç e keni
11 përmendur edhe në faqen 261 të librit tuaj.

12 PË. Po në librin tim në fusnotë ku po e lexoni atje ose në
13 referencë edhe aty është një lëshim, një gabim teknik. Ky
14 takim është mbajtur më 14 prill dhe më 14 prill është marrë ky
15 vendim.

16 PY. Në rregull. Ajo çfarë kemi këtu është që thuhet që:

17 "Anëtarët e njësimit të cilët vendosën sa i takon
18 organizimit dhe emërimit të komandantëve", që i takon që keni
19 qenë ju dhe z. Kadri Avdiu.

20 Pra, thuhet këtu që vendimi sa i takon emërimeve ka qenë
21 vendim i ushtarëve të dy njësiveve, a ka qenë kështu,
22 Dëshmitar?

23 PË. Po, po.

24 PY. Faleminderit. Ndërkohë që keni qenë të kyçur në UÇK në
25 periudhën midis majit të '98-s dhe qershorit të '99-s ju nuk

1 jeni takuar me asnjë nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të
2 UÇK-së, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Gjatë luftës nuk kam pas fatin të takoj asnjë nga
4 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm.

5 PY. Faleminderit. Tani dëshiroj të flasim lidhur me
6 metodologjinë e përdorur për shkrimin e librit tuaj. I keni
7 thënë ZPS-së që me librin tuaj juve nuk pretendoni që të thoni
8 fjalët përfundimtare lidhur me atë çfarë ka ndodhur në zonën
9 operative të Llapit, a është e saktë kjo?

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem, mund të na thoni
11 referencat për këtë?

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po. Është prova P1545 [Sipas
13 përkthimit] në faqen 14, rreshta nga 1 deri në 4.

14 PY. T'jua përsëris edhe një herë pyetjen, Dëshmitar?

15 PË. E kam të qartë. Po unë e kam thënë në parathënie edhe në
16 hyrje edhe në përfundim të studimit tim, përkundër vullnetit,
17 dëshirës, përkundër gatishmërisë kam qenë i vetëdijshtëm që nuk
18 kam mujt dhe nuk kam me mujt me e dhënë mendim përfundimtar
19 edhe më të mirën sa i takon organizimit të luftës së Ushtrisë
20 Çlirimtare të Kosovës në zonën operative të Llapit.

21 Po kisha pas dëshirë me m'i qit në ekran në monitor faqet
22 e librit prej ku ju bazoheni në pyetjet që i bëni. Nëse ka
23 mundësi.

24 PY. Atëherë, në rregull. Sa i takon pyetjes së radhës po i
25 referohem intervistës që i keni dhënë ZPS-së që i keni thënë

1 edhe në intervistën e ZPS-së që ju nuk pretendoni që të thoni
2 fjalët e fundit sa i takon zonës operative të Llapit.
3 Megjithatë, të kalojmë te pyetja tjetër.

4 Lidhur me librin tuaj, ndërkohë që ju keni konsultuar
5 dokumente dhe keni pasur dhe biseda të ndryshme me anëtarë të
6 UÇK-së, ky libër përfaqëson thjesht opinionin tuaj dhe
7 interpretimin tuaj të ngjarjeve në Llap, a është kështu,
8 Dëshmitar?

9 PË. Unë e kam thënë edhe në këto tri pjesë në parathënie,
10 hyrje ose në përfundim se unë nuk kam bërë asnjë koment të
11 ngjarjeve të cilat unë i kam radhit brenda librit tim, për
12 faktin që kam dhënë hapësirë dhe mundësi studiuesit e rinj të
13 studiojnë në mënyrë më të thoktë të çështjes rreth organizimit
14 dhe luftës që është zhvilluar në zonën operative të Llapit.

15 PY. Faleminderit. Pjesët në librin tuaj që juve raportoni sa
16 i takon njësiteve të drejtpërdrejta, për shembull, të cilat
17 lidhen me njësitin K33, këto mbështetur në përvojën tuaj
18 personale, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Me disa.

20 PY. Kur keni shkruar njësitin [Sipas përkthimit] ju keni qenë
21 në dijeni të faktit që askush tjetër nuk kishte shkruar një
22 libër më përpara për zonën operative të Llapit, kështu
23 Dëshmitar?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Pra, varej nga ju ose e kishit ju në dorë, në njëfarë

1 mënyre, që të shkruanit narrativën e zonës, kështu?

2 PË. Dua të shtoj se sa kam pas - ka pas edhe disa intervista
3 që i kanë shkruar disa, por jo në këtë nivel çfarë unë kam
4 pretenduar të shkruaj. Dhe, po, sigurisht, jam ndierë krenar
5 që më është dhënë rasti, besimi dhe mundësia me shkru për
6 luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën operative të
7 Llapit.

8 PY. Faleminderit. A do ishte e drejtë të thuhej që kishte
9 kuptim për ju që ju po përpiqeshit që të glorifikonit
10 përpjekjet e luftës së UÇK-së në zonën operative të Llapit kur
11 keni shkruar librin?

12 PË. Po, sigurisht qëllimi im ka qenë thjesht që unë të jap më
13 të mirën prej vetes time, anën profesionale, por edhe
14 njerëzore që ta paraqes në mënyrë sa më të mirë luftën e
15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në zonën e Llapit.

16 PY. Në librin tuaj ju thoni që jeni mbështetur në një
17 metodologji shkencore për ta shkruar këtë libër. Për
18 procesverbal kjo thuhet në faqen 305. Dua t'ju bëj disa pyetje
19 lidhur me këtë temë. A e keni të nevojshme që të shikoni
20 pjesën përkatëse në libër, apo mund të vazhdojmë me pyetjet?

21 PË. Unë për këtë sigurisht kam fol ose në parathënie ose në
22 hyrje, kështu që sigurisht e kam potencue që cili ka qenë
23 qëllimi im.

24 PY. Faleminderit. Po, e vërtetë është. Në këtë pjesë e keni
25 thënë. Thjesht dua të sqaroj atë çfarë keni dashur të thoni.

1 Keni dashur të thoni që jeni mbështetur te vetja juaj, dhe
2 jeni mbështetur gjithashtu tek intervistat, interpretimet e
3 intervistave të mëhershme të botuara të ish-ushtarëve të UÇK-
4 së edhe takimeve tuaja me ish-ushtarë të zonës operative të
5 Llapit, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Është e saktë.

7 PY. Ndonjëherë ju keni intervistuar disa luftëtarë në të
8 njëjtën intervistë, është kështu?

9 PË. Po, e saktë.

10 PY. Por nuk është se keni bërë regjistrim me audio ose video
11 të intervistave të tilla, apo jo?

12 PË. E kam thënë edhe në parathënie këtë problematikë e cila
13 m'u ka shfaq gjatë përgatitjes së librit tim. Edhe u mundova
14 edhe më herët me e sqaru. Nëse ka nevojë po e përsëris edhe
15 një herë.

16 PY. Faleminderit. Pra, gjatë intervistave ju keni mbajtur
17 shënime disa herë, por nuk është se keni mbajtur gjatë gjithë
18 kohës intervista, kështu, shënime gjatë intervistave, kështu?

19 PË. Po e përsëris: Unë nuk kam pas një pyetësor standard
20 pyetje-përgjigje. Se si të themi intervistë, si të them
21 bashkëbisedim e ka kuptimin e njëjtë në gjuhën shqipe. Kështu
22 që unë kam mbajtur shënime që unë kam menduar që janë të
23 rëndësishme. Nuk i kam evidentuar me data me nënshkrime unë
24 edhe personi ose eprori që kam bisedue me ta.

25 PY. Ju nuk keni mbajtur shënime të intervistave ose bisedave

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 72

1 të tilla edhe pas botimit të librit, a është kështu,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po, kështu është. Nuk më kanë - s'kam pas ndonjë interes
4 mbas kaq vitesh për me i ruajt ose për me i mbajt.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqitet në
6 ekran faqja 26 e librit që mban numrin SPOE00055678-000556018
7 [Sipas përkthimit] që është faqja 23 e versionit në PDF. Do ju
8 kërkoja që të shikoni poshtëshënimin numër 3, ju lutem.

9 PY. Këtu ju thoni që:

10 "Deklaratat, intervistat dhe memualet e luftëtarëve të
11 ZOLL-it në lidhje me ngjarjet dhe rrethanat janë
12 kontradiktore, jo të qëllimta, por për arsye se janë harruar,
13 domethënë, këto kujtime, nuk prezantojnë gjithmonë të dhënat
14 të saktë për të kaluarën."

15 A e konfirmoni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po, e konfirmoj edhe mund të shtoj edhe diçka tjetër nëse
17 më lejohet.

18 PY. Po, vazhdoni.

19 PË. Intervistat me bashkëluftëtarë që unë i kam ba shpeshherë
20 gjatë punës sime kanë qenë sfidë në kuptimin e renditjes së
21 ngjarjeve të cilat kanë ndodh në zonën operative të Llapit.
22 Për këtë arsye unë kam qenë shumë i kujdesshëm, por edhe e kam
23 thënë edhe në parathënie, por edhe sigurisht edhe në
24 përfundim. Për këtë arsye unë nuk i kam dhënë vetit të drejtë
25 as të bëj analizë as komente rreth ngjarjeve që janë

1 zhvilluar. Por e përsëris edhe një herë, për faktin që
2 shpresojmë të ardhmen studiues të rinj ta kenë si bazë librin
3 tim që ta studiojnë më në thellësi këtë çështje.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. MENEGON: [Përktim] Znj. Sekretare, do ju kërkoja që
6 të vazhdonit në fillim të faqes, të na tregoni fillimin e
7 faqes.

8 PY. Aty ju thoni që:

9 "Sa i takon kohës dhe vërtetësisë së përmbajtjes", ju
10 thoni, "që kjo ka paraqitur vështirësi të konsiderueshme sa i
11 takon, le të themi, referencës ndaj intervistave ose bisedave
12 që keni pasur me personat në kuadër të shkrimit të librit", që
13 i keni shkruar këtu në fillim të faqes.

14 A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po, sigurisht. Unë e kam thënë edhe atëherë në vitin
16 2006-2007.

17 PY. Faleminderit.

18 Në fakt disa njerëz janë ankuar, thoni ju, lidhur me
19 mënyrën si i keni portretizuar bisedat me ta pas publikimit të
20 librit. A është e vërtetë kjo?

21 PË. Po kisha me qenë njeriu më i lumtur në botë nëse kisha me
22 bë një botim ose një studim dhe mos me pas vërejtje dhe
23 ankesa. Sigurisht këto 20 vjet, sa janë bë 16 vjet që është
24 botuar libri, ka pas sigurisht edhe kërkesa ose vërejtje të
25 ndryshme, po sigurisht që ka pas.

1 PY. Faleminderit. Ndërmjet burimeve të ndryshme të burimit
2 [Sipas përkthimit] tuaj, ju gjithashtu i referoheni materialit
3 arkivistik të pabotuar.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju kërkoja që
5 të paraqisni në ekran faqen 39 në versionin PDF. Ju kërkoj
6 ndjesë. Është faqja 309 të versionit PDF.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund t'ju ndihmoj.
8 Numri ERN është SPOE00055983.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Këtu ju keni bërë një listë të materialit arkivistik.
11 Megjithatë, siç i keni thënë ZPS-së, arkivat nuk është se kanë
12 qenë të dobishme për kërkimet tuaja kur i keni konstatuar ose
13 kur keni përdor këto dokumente, a është e vërtetë kjo?

14 PË. Po, është e vërtetë, për kohën kur po flasim; po flasim
15 2004, 2005, 2006, 2007.

16 PY. Pra, ju e keni shtuar arkivin në listën e burimeve
17 kryesisht për transparencë, për të thënë që ju i keni parë
18 këto burime, por nuk është se keni gjet ndonjë gjë prej tyre,
19 është kështu, Dëshmitar?

20 PË. Për cilin arkiv e ke fjalën?

21 PY. Për shembull, arkivat e Kosovës në Prishtinë ose arkivat
22 e tjera që keni këtu.

23 PË. Po.

24 PY. Në librin tuaj ju keni renditur disa vendime të cilat
25 pretendohen që të kenë buruar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-

1 së. Sot më herët kemi parë, për shembull, vendimin e 10-të dhe
2 19-të nëntorit 1998. A është e saktë që shumë nëse jo të
3 gjithë vendimet që ju i keni përfshirë në librin tuaj janë
4 marrë nga artikujt e KosovaPress-it?

5 PË. Jo, unë i kam marrë nga arkivi i zonës së 5-të të Trupave
6 Mbrojtëse të Kosovës.

7 PY. Ju jo domosdoshmërisht e keni diskutuar përmbajtjen e
8 këtyre dokumenteve me anëtarët e UÇK-së që ju keni
9 intervistuar gjatë përgatitjes së librit, apo jo, Dëshmitar?

10 PË. Ka pas raste ndoshta. Nuk kam mendu, s'po më kujtohet
11 diçka e tillë. Po, ka pas raste.

12 PY. Faleminderit. Tani do të flasim lidhur me krijimin e
13 zonës së Llapit.

14 Në faqen 111, 112 të librit --

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
16 paraqesë këto faqe në ekran dhe që përkojnë me faqen 108 të
17 PDF-së. Është faqja 108 e PDF-së. Edhe versionin në anglisht,
18 ju lutem. Në fund.

19 PY. Ju thoni që është bërë një takim jozyrtar në mbrëmjen e 7
20 shtatorit në vitin 1997 gjatë së cilës ju thoni që është
21 krijuar struktura e zonës operative të Llapit.

22 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund të vazhdojmë te faqja
23 tjetër, ju lutem?

24 PY. Ju lutem, Dëshmitar, a mund të na sqaroni që së pari ky
25 informacion a është mbështetur në intervistën që keni pasur me

1 persona të cilët përmenden në poshtëshënim, a ka qenë kështu?

2 PË. Po.

3 PY. A është e drejtë të thuhet që këta persona Remi, Latif
4 Gashi janë takuar në mënyrë klandestine dhe vendosën që të
5 emëronin njëri-tjetrin në pozicione komanduese, kështu ka
6 qenë?

7 PË. Jo, s'po e kuptoj pyetjen.

8 PY. A është e drejtë të thuhet se Rustem Mustafa, Latif
9 Gashi dhe Ilir Konushevci në shtator të '97-s vendosën që të
10 takoheshin me njëri-tjetrin dhe të caktonin njëri-tjetrin në
11 pozicione komanduese pa asnjë urdhër nga sipër, ka qenë
12 kështu?

13 PË. Po nëse po e kuptoj pyetjen, këta ka qenë bashkëluftëtarë
14 edhe më herët, edhe nuk kanë qenë vetëm këta që po i përmendni
15 pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por pas rënies së
16 Zahir Pajazitit këta kanë marrë më 31 janar në vitin 1997,
17 marrën mbi supet e tyre përgjegjësinë për riorganizimin e
18 nënzonës operative të Llapit në atë kohë. Dhe sigurisht ata
19 kanë mbajtur disa takime të cilët janë të evidentuar në librin
20 tim; në mesin e këtyre është edhe ky takim që ju po e
21 përmendni ose i 2 shtatorit, se ju e ngatërruat datën, të
22 vitit 1997, ku kanë ndarë përgjegjësitë së bashku
23 bashkëluftëtarët mes veti.

24 Po pajtohem se nuk kanë pasur ndonjë urdhër nga më lart
25 nëse është pyetja kështu. Nuk kanë pasur nga Shtabi Qendror në

1 atë kohë si është quajtur ose shtabi operativ. Po, ka qenë një
2 vetorganizim për të filluar shtrirjen ose organizimin e UÇK-së
3 në zonën operative të Llapit.

4 PY. Faleminderit. E kuptuat mirë pyetjen time.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani të shohim faqen 207 të
6 librit që është faqja 204 e versionit në PDF.

7 PY. Dëshmitar, në librin tuaj ju gjithashtu diskutoni për
8 financimin e zonës së Llapit dhe tek kjo faqe ju përshkruani
9 se si qytetarët ofruan ndihmë për zonën e Llapit, jo vetëm me
10 ushqim, me rroba, me akomodim për ushtarët, por gjithashtu
11 edhe kanë ndihmuar për sigurimin e armëve, a është e vërtetë
12 kjo?

13 PË. Po, është e vërtetë, por nëse më lejohet me shtue diçka.

14 PY. Po, patjetër.

15 PË. Komandanti i zonës operative të Llapit Rustem Mustafa,
16 bazuar në studimet e mia, është komandanti i vetëm i një zone
17 i cili ka qëndruar gjithëherë në Kosovë dhe është marrë
18 aktivisht me politikë. Kjo e ka bërë të mundshëm që ai të ketë
19 kontakte me personalitete më të njohura të asaj kohe në
20 territorin e Llapit dhe [E pakuptueshme] respektivisht
21 Prishtinës dhe të Podujevës, gjë që ka reflektue në
22 masivizimin dhe përkrahjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
23 Kjo ka bërë që edhe të gjitha shtresat, të gjithë popullata e
24 kësaj ane të përkrahë fuqishëm Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës
25 në zonën operative të Llapit. Dhe sigurisht edhe në aspektin

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 78

1 financiar dhe ka qenë ky një vetorganizim i zonës operative të
2 Llapit.

3 PY. Faleminderit. Ju përmendni në poshtëshënimin 401 --

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
5 kalonim në fund të faqes.

6 PY. -- që përmes iniciativave vullnetare shumë fshatra të
7 ZOLL-it kishin organizuar aksione për grumbullimin e mjeteve,
8 parave e të tjera, kundër okupatorit, kështu?

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 210 që është
10 faqja 207 e versionit në PDF. Në faqen, në fund të faqes dua
11 që të shikoni poshtëshënimin 402.

12 PY. Edhe këtu ju thoni që kjo ka ardhur si rezultat i
13 donacioneve të konsiderueshme nga qytetarët ku janë dhënë, për
14 shembull, si donacione armë, municion, uniforma e të tjerë, a
15 e konfirmoni këtë, Dëshmitar; është e saktë kjo?

16 PË. Po, e konfirmoj, dhe nëse më lejohet kisha shtue diçka në
17 këtë drejtim.

18 PY. Po.

19 PË. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk është krijuar, nuk është
20 themeluar si rezultat i institucioneve të Kosovës. Është
21 rezultat i lëvizjeve edhe i organizimeve të cilat çlirimin e
22 Kosovës e shihnin përmes luftës; u krijua nga patriotët,
23 liridashësit më të njohur të kombit shqiptar në ato vite. Dhe
24 kjo ka bërë që edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës vetë të bëjë
25 zgjidhjen e furnizimeve, organizimeve në aspektin edhe

1 infrastrukturator ose të banimit. UÇK-ja nuk është organizuar
2 nëpër kazermë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës u organizua, u
3 stërvit dhe u përgatit për luftë nëpër shtëpitë-kazerma të
4 cilat i dhuronte populli shqiptar në atë kohë.

5 Shumë shtëpi të popullatës civile në atë kohë u kthyen në
6 kazerma, u kthyen në qendra stërvitore.

7 PY. E kuptoj.

8 PË. Falemneras.

9 PY. E kemi kohën të kufizuar. Atëherë vazhdojmë më tej.

10 Përfshirë ose mbështetur në këto fragmente në deklaratën tuaj
11 ju keni thënë që zona e Llapit ose zona operative e Llapit ka
12 operuar në mënyrë të pavarur nga zonat e tjera edhe në kohën
13 kur ka pasur një Shtab të Përgjithshëm të UÇK-së, a është e
14 vërtetë kjo, Dëshmitar?

15 PË. A mundeni me na i vendos në monitor këtë fjali ku e
16 lexoni?

17 PY. Jo, është një pyetje që po jua bëj unë juve. Unë po ju
18 pyes tani: Sapo thatë dy faqe ku ju diskutoni fakte që zona
19 operative e Llapit ka marrë donacione, dhurata, para, uniforma
20 e të tjerë nga qytetarët dhe pastaj nga ana tjetër ju thoni që
21 zona operative e Llapit ka qenë e vetorganizuar.

22 Kështu që unë thjesht dua që të konfirmoj në qoftë se
23 eventualisht ju pajtoheni që zona operative e Llapit në atë
24 kohë ka funksionuar në mënyrë të pavarur nga zona të tjera ose
25 nga Shtabi i Përgjithshëm.

1 PË. Unë mund të them në atë kohë zona operative e Llapit ka
2 qenë një ndër zonat mirë e organizuar dhe me iniciativa të
3 ndryshme të cilat kanë ndihmuar që ajo të organizohet në nivel
4 sa më të mirë. Ndërsa sa i përket çështjet tjetër vet e
5 organizume, kjo është çështje që unë nuk mund ta komentoj dhe
6 ta them, por besoj që iniciativat kanë qenë të nisura nga
7 komandanti i zonës operative të Llapit, Rustem Mustafa, pa
8 marrë ndonjë urdhër më lart ose ndonjë iniciativë më lart.
9 Është fjala në raste të veçanta.

10 PY. Faleminderit. Në rregull, tani do të flasim për disa
11 vizita të Shtabit të Përgjithshëm në zonë që ju i keni
12 përmendur në librin tuaj, në veçanti në gusht dhe në tetor të
13 '98-s. A mund të na konfirmoni që ju personalisht nuk keni
14 qenë i pranishëm në këto takime, Dëshmitar?

15 PË. Po, e konfirmoj. Nuk kam pas fatin; shumë kisha pas fatin
16 me thënë se jam konë, por s'kam qenë.

17 PY. Znj. Prokurore ju tregoi sot më herët, sot paradite, disa
18 fragmente të këtyre vizitave. Dhe ju keni thënë që jeni
19 mbështetur kryesisht në intervistat që ju kanë dhënë nga
20 bashkëluftëtarët në 2007 për të shkruar këto pjesë ose për të
21 përshkruar këto vizita. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

22 PË. E vërtetë është.

23 PY. Sa i takon vizitës së parë të z. Hashim Thaçi në zonën
24 operative të Llapit me 18 deri 20 gusht 1998, mbështetur në
25 atë çfarë thoni ju dhe atë çfarë të kanë thënë ty, pavarësisht

1 faktit që zona e Llapit ka qenë goxha e organizuar dhe
2 funksionale që prej të paktën fundit të '97-s, vetëm në gusht
3 të '98-s zona e Llapit u vizitua nga Shtabi i Përgjithshëm i
4 UÇK-së, me sa dini ju, kështu?

5 PË. Po, kështu është.

6 PY. Pra, ju thoni që struktura e Llapit është bërë zyrtare
7 nga struktura e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, po ju
8 pajtoheni që nuk është Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së
9 struktura që ka bërë emërimin e Remit si komandant të zonës së
10 Llapit, kështu Dëshmitar?

11 PË. Këto shprehjet dhe termat "zyrtarizim" të cilat i kam
12 përdorur unë në dy rastet edhe mund të interpretohen ndryshe
13 ose në mënyra të ndryshme. Unë dua të them që në zonën
14 operative të Llapit personat në pozita të ndryshme komanduese
15 janë emëruar nga komandant Remi më 18 korrik të vitit 1998.
16 Dhe mund t'i referoheni të dhënave në librin tim.

17 PY. Ashtu është. Faleminderit.

18 PË. Për saktësinë dhe korrektësinë nuk mbaj përgjegjësi unë.
19 Për saktësinë e të dhënave nuk thashë nuk mbaj përgjegjësi,
20 por kështu është referuar. Dhe 18 korriku është data kur janë
21 emëruar në pozita të gjithë ata persona që unë i kam
22 evidentuar.

23 PY. E kuptoj.

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Përpara se të vijoj më tej do të
25 kërkoja që të paraqisja si prova faqet që i tregova

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 82

1 dëshmitarit, faqet 207, 210 që kishin lidhje me kontributet
2 vullnetare të qytetarëve në zonën e Llapit.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po numrin ERN
5 a mund të na e jepni?

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Kam faqen e librit, ka numër
7 SPOE00055678 deri në SPOE00045018 [Sipas përkthimit] faqja 207,
8 210.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Thjesht për konfirmim
11 desha t'ju thoja që faqja 207 e librit ERN-në e ka
12 SPOE00055881, ndërsa faqja 210 e ka ERN-në SPOE0005884 [Sipas
13 përkthimit].

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Po, kështu është.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i bashkëngjiten
16 provës ekzistuese 187.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
18 përdorni numrat ERN për materialet që nuk janë pranuar si
19 prova.

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, tani do doja të flisnim pak për konferencën e
22 Rambujesë të cilën e keni përmendur në librin tuaj.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për këtë do të kërkoja që të
24 shfaqej në ekran faqja 70 e librit me numër SPOE000556478 deri
25 në SPOE00045018, faqja 67 e PDF-së.

1 PY. Dëshmitar, ju keni qenë i përrshirë në diskutimin apo
2 organizimin e delegacionit të Rambujesë?

3 PË. Jo, nuk kam qenë.

4 PY. A keni marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë mbledhje me
5 komandantin e zonës së Llapit ku është diskutuar se cili nga
6 UÇK-ja duhet të shkonte në Rambuje dhe se çfarë qëndrimi duhet
7 të mbante UÇK-ja?

8 PË. Nuk kam marrë pjesë në asnjë takim të tillë.

9 PY. A e keni diskutuar konferencën e Rambujesë me ndonjë nga
10 luftëtarët që intervistuat për librin tuaj?

11 PË. S'më kujtohet, s'më kujtohet.

12 PY. Faleminderit.

13 Në këtë faqe thoni se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së,
14 përmes Hashim Thaçit bëri të ditur pjesëmarrjen e tyre në
15 Rambuje me gjithë kundërshtimet dhe në kllapa keni vendosur
16 Demaçi dhe Shtabi i Përgjithshëm.

17 PË. Nëse ka mundësi me ma qit me e vendos në monitor faqen e
18 librit ku unë kam thënë kështu?

19 DËSHMITARI: Nëse nuk e gjeni unë po e...

20 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Është faqja 67, për Sekretaren
21 është faqja 67 e PDF-së. 67, ju lutem.

22 DËSHMITARI: Po, e shoh tani.

23 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

24 PY. Faleminderit. Ku, cili ka qenë burimi i informacionit
25 tuaj për këtë deklaratë apo për këtë përfundim?

1 PË. Tani nuk po më kujtohet saktësisht se kam shfrytëzuar
2 disa materiale të botuara mbas lufte. Por ajo që dihet
3 agjencioni KosovaPress, nëse nuk gabohem, por ajo që është e
4 rëndësishme është që pas takimit të 30 janarit në mes të në
5 Shkup që është zhvilluar ndërmes ministrit të jashtëm Robin
6 Cook, Petritsch dhe Hill dhe përfaqësuesve të tri grupimeve
7 politike në Kosovë Adem Demaçi, Ibrahim Rugova dhe Rexhep
8 Qosja, derisa Ibrahim Rugova dhe Rexhep Qosja kishin pranuar
9 që të jenë pjesë e delegacionit ose takimeve për paqen në
10 Rambuje. Sipas të dhënave unë që kam hulumtuar në atë kohë më
11 3 shkurt në emër të Shtabit të Përgjithshëm, z. Hashim Thaçi e
12 konfirmon që edhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare
13 të Kosovës do të jetë pjesë e bisedimeve në Rambuje. Përkundër
14 atyre mospajtimeve që kanë qenë në atë kohë në mes të Demaçit
15 si përfaqësues politik i UÇK-së.

16 Dhe siç e dimë pastaj delegacioni i Kosovës ka udhëtuar
17 në Rambuje në përbërjen që në atë kohë kam bërë përpjekje që
18 të jemi shkurt, por i saktë rreth delegacionit dhe detyrave
19 dhe përgjegjësiive që kanë pasur.

20 PY. [Mikrofoni çaktivizuar]. Ju kërkohet ndjesë.

21 Në libër keni folur për disa mospërputhje, disa konflikte
22 sa i takon Rambujesë, mospëlqime më saktë. A pajtoheni ju që
23 në atë kohë UÇK-ja nuk ishte e njoftuar kur shkoi në Rambuje,
24 nuk e dinin se çfarë pozicioni do të kishin, pra, në Rambuje,
25 nuk e kishin të qartë këtë gjë?

1 PË. Nuk, nuk e kuptoj plotësisht pyetjen.

2 PY. Po, ju kërkojmë ndjesë. Në ekran ju keni thënë që Shtabi
3 i Përgjithshëm i UÇK-së, pavarësisht, përkundër kontradiktave
4 Demaçi/Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së më 3 shkurt përmes
5 Hashim Thaçit bëri të njohur pjesëmarrjen në Rambuje.

6 Pra, UÇK-ja nuk ka qenë e unifikuar, pra, sa i takon
7 qëndrimin që do të mbahej në Rambuje.

8 PË. Unë e thashë këtë paraprakisht. E thashë paraprakisht,
9 përkundër mospajtimeve rreth pjesëmarrjes në Rambuje me 3
10 shkurt z. Hashim Thaçi deklarohet ose e bën me dije opinionin
11 që do të jetë UÇK-ja pjesë e bisedimeve në Rambuje. Të paktën
12 sipas atyre të dhënave që unë i kam pas në atë kohë. Ndoshta
13 mund të jem gabim në data se nuk po e shoh që paskam përdor
14 referenca dhe mund të jem i gabuar. Po, dakord, dakord, do të
15 thotë shihet një mospajtim sa i përket pjesëmarrjes dhe
16 mospjesëmarrjes në Rambuje.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do doja të shihnim faqen 75
19 në ekran që është faqja 72 e PDF-së.

20 PY. Këtu keni thënë që delegacioni i Kosovës shprehu
21 pakënaqësinë për çështjet ushtarake, pra, [E pakuptueshme]
22 rreth çështjeve ushtarake të ardhmes së UÇK-së dhe asaj
23 politike, mbajtjes së referendumit për pavarësi të Kosovës pas
24 tri vitesh.

25 Edhe keni tek poshtëshënimi që keni përdorur si burim

1 librin e z. Petritsch dhe Pihler. Pra, ky ishte një përfundim
2 në librin e tyre, apo jo?

3 PË. Po sigurisht se tash s'po më kujtohet, por përderisa e
4 kam vu si referencë edhe sigurisht që ka pas mospajtime. Ose
5 mos pakënaqësisë, si të themi.

6 PY. A keni ndonjë informacion të mëtutjeshëm për këtë
7 pakënaqësi? Nga buronin këto pakënaqësi? Çfarë pakënaqësish
8 kishte konkretisht?

9 PË. Nuk mund të spekuloj në lidhje me këtë për arsye se
10 përderisa nuk e kam shënu, tash mbas 20 vjetësh mund të kem
11 një mendim tjetër ose mendim ndryshe ose kam informacion
12 shtesë, sepse kam lexu më vonë edhe studime të ndryshme të
13 tjera. Kështu që nuk dua të lëshohem për kohën kur e kam
14 shënuar unë ose kur kam shkruar unë për këtë çështje.

15 PY. Faleminderit. Meqë keni qenë në zonën e Llapit, e dinit
16 ju që asokohe komandanti i zonës së Llapit kishte shprehur
17 pakënaqësitë e tij me delegacionin e UÇK-së dhe me atë çka po
18 ndodhte në Rambuje? Keni dëgjuar diçka lidhur me këtë?

19 PË. E kam shënu diku në libër? A po i referohesh librit apo
20 po më pyet për informacionet e mia personale?

21 PY. Jo, po ju pyes për ndonjë informacion që mund të keni ju
22 vetë.

23 PË. Gjatë kohë së luftës nuk kam pas. Mbas lufte, po, jam --

24 PY. Faleminderit.

25 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do doja të shihnim faqen 77

1 të librit, që është faqja 74 e PDF-së.

2 PY. Këtu thoni që përfaqësuesit e UÇK-së kanë përdorur
3 pushimin, periudhën ndërmjet bisedimeve për kontakte dhe për
4 të njoftuar komandantët e zonave të UÇK-së. Shoh që keni
5 gjetur informacione online.

6 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Ju lutem, të shohim
7 poshtëshënimin 101.

8 PY. Pra, nuk keni pasur ndonjë informacion personal për këtë
9 takim, apo jo?

10 PË. Jo, nuk kam pasur.

11 PY. Faleminderit.

12 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në faqen tjetër, ju lutem, ta
13 shohim në ekran. Faqja 78, po, kjo.

14 PY. Te poshtëshënimi 103 keni thënë se z. Sylejman Selimi u
15 emërua komandant i UÇK-së dhe zëvendësoi Azem Sylën gjatë
16 kohës që po vazhdonin bisedimet e Rambujesë, kështu?

17 PË. Po, kështu atëherë e kam evidentuar. Mund të jem i gabuar
18 në datat për arsye se nuk kam pas një diçka që me e krahasue.
19 Këtë të dhënë e kam pas, vetëm e dimë që në atë kohë është
20 bërë emërimi i gjeneral Sylejman Selimit, komandanti i UÇK-së,
21 në kohën sa po mbahej takimi në Rambuje.

22 PY. Cili është burimi për këtë informacion, se këtu nuk keni
23 dhënë ndonjë referencë konkrete; ku e keni bazuar ju këtë për
24 ndryshimin e komandantit?

25 PË. Jo, këtë e kam dhënë si informacion për lexuesin. Por unë

1 si studiues në atë kohë mund të them që kam marrë informacion
2 edhe gjatë luftës në takimin me bashkëluftëtarë. Po përderisa
3 nuk e kam bërë një intervistë të veçantë për këtë çështje nuk e
4 kam evidentuar si referencë por si informacion për lexuesin.
5 Kështu që edhe në gjatë luftës i kemi biseduar çështjet të
6 cilat kanë rrjedhë nga takime të ndryshme të niveleve të
7 ndryshme brenda zonës operative të Llapit.

8 Kështu që s'kam pas ndonjë informacion ma të -- dhe s'kam
9 dashtë të intervistoj strukturat komanduese për këtë çështje.
10 S'më është dukur, përderisa tema është e librit është zona
11 operative e Llapit sa i përket Shtabit të Përgjithshëm dhe
12 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës jemi munduar të eidentoj
13 momentet dhe ngjarjet më të rëndësishme. Nuk kam hyrë në
14 detaje. Kështu që kjo m'u ka dukur e rëndësishme, këtë e kam
15 evidentuar.

16 PY. E kuptoj.

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani shohim faqen 76 të librit,
18 që ka numrin 73 të PDF-ja.

19 PY. Flasim për Qeverinë e Përkohshme tani.

20 Këtu keni folur për një vendim të 23 gushtit në bazë të
21 të cilit do të formohej Qeveria e Përkohshme e Kosovës.
22 Kërkojmë ndjesë, 23 shkurt, jo 23 gusht. Shoh që ka një gabim.
23 Ky vendim për formimin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës që
24 do të kishte përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
25 LDK-së, LPD-së është marrë më 23 shkurt?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Menegon,
2 bëtë tre pyetje në një. Zbërthejeni, ju lutem, se kemi shumë
3 vështirësi t'ju ndjekim.

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

5 PY. Ka një gabim në datë tek anglishtja. Pra, a është marrë
6 një vendim më 23 shkurt për të formuar Qeverinë e Përkohshme?

7 PË. Po, më 23 shkurt është marrë vendimi. Do të thotë mes tri
8 grupimeve politike dhe ushtarake në Rambuje në ditën e
9 përfundimit të bisedimeve për themelimin e Qeverisë së
10 Përkohshme ku janë në libër them edhe aty të evidentume këto
11 vendime. Në bazë të këtij vendimi në vazhdim edhe caktohet
12 kryeministri i Qeverisë së Përkohshme i cili bën përpjekje në
13 vazhdimësi për ta formuar Qeverinë e Përkohshme. Bën thirrje
14 që këtij vendimi t'i qëndrojnë mbas të gjithë nënshkruesit e
15 saj, në kuadër të kësaj që edhe LDK-ja ose Ibrahim Rugova t'i
16 qëndrojnë pas për konstituimin apo themelimin e qeverisë së
17 përkohshme.

18 Dhe në vazhdim përpjekjet e tina, kontaktet, takimet e
19 tij brenda dhe jashtë vendit deri sipas të dhënave unë që kam
20 hulumtuar edhe këtu nuk i kam. Kryeministri i eQverisë së
21 Përkohshme deri më 6 qershor ka zhvilluar disa takime të
22 fundit unë që jam marrë si studim e ka pas më 6 qershor, nëse
23 s'gabaj, në Belgjikë. Po ka pas disa takime. Nuk i kam të
24 evidentume se nuk ka qenë për mua në atë kohë me rëndësi në
25 libër, por më kujtohet që ka zhvilluar disa takime jashtë

1 vendit. Vizita në Shqipëri, në Shtetet e Bashkuara të
2 Amerikës, në Bruksel, në Londër.

3 Pak me u kujtue, më u kërkue ndoshta dhe mund t'i
4 pontencoj cilat vende ka qenë.
5 PY. Faleminderit.

6 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se ka një gabim në
7 transkript, ju lutem, në faqen 8, në rreshtin 8. Besoj se
8 dëshmitari tha 23 shkurt dhe jo 23 prill siç është pasqyruar
9 këtu.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmia e tij
11 ishte prill.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të ketë qenë ndonjë
13 problem përkthimi, sepse dëshmitari tha "shkurt".

14 DËSHMITARI: Shkurt, shkurt, po, 23 shkurt.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]
16 PY. Faleminderit, faleminderit.

17 Keni përmendur një takim të Qeverisë së Përkohshme të
18 Kosovës. Po partia e Ibrahim Rugovës mori pjesë në të?
19 PË. Unë e thashë edhe më herët bazuar në literaturën në atë
20 kohë që e kam lexuar, kryeministri i Qeverisë së Përkohshme në
21 atë kohë po bënte thirrje nga nivele të ndryshme që palët
22 nënshkruese ta respektojnë vendimin e 23 shkurtit. Dhe sipas,
23 kjo nënkupton që po i bënte thirrje në atë kohë edhe Ibrahim
24 Rugovës që të jetë pjesë e komponimit të Qeverisë së
25 Përkohshme.

1 Kjo nënkupton që nuk ka qenë.

2 PY. Faleminderit.

3 PË. Nuk e ka respektuar vendimin e 23 shkurtit të vitit 1999.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shohim faqen 227 [Sipas
6 përkthimit] të librit tuaj që në PDF është faqja 254.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

8 DËSHMITARI: A ka mundësi në monitor kur vendosim pjesë të
9 librit tim mos me i zmadhu, me i lënë pak më të vogla se nuk
10 po e shoh në tërësi faqen dhe po më krijon huti gjatë leximit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë të
12 pamundurën.

13 DËSHMITARI: Faleminderit. Ja kështu sikur tash që është,
14 mjafton.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim]

16 PY. Këtu keni folur për një vendim të Qeverisë së Përkohshme
17 dhe urdhrin të Shtabit të Përgjithshëm për mobilizim të
18 përgjithshëm, por nuk e citoni vetë vendimin, kështu? Vetë
19 urdhrin këtu nuk e citoni.

20 PË. Jo e kam cituar. Është në referencë. Referenca 471, 471
21 është referenca.

22 PY. Ky poshtëshënim është një vendim i komandantëve të zonës
23 apo jo, për emërimin e komandantëve në nivel kompanie dhe
24 batalioni, a nuk është kështu?

25 PË. Jo, është vendimi për mobilizim atje, data 1 prill 1998,

1 1999. Më 1 prill është kjo.

2 PY. Ju nuk keni mbajtur ndonjë kopje?

3 PË. Nuk kem.

4 PY. Dhe nuk është as në librin tuaj.

5 PË. Jo, nuk -- besoj që është në atë kohë.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do doja të shihnim faqen

8 290 të librit, që në PDF i takon faqja 287.

9 PY. Këtu përmendi emërimin -- më falni, flisni për një urdhër
10 të UÇK-së për themelimin e batalionit të 5-të të gardistit të
11 UÇK-së për ndërhyrje të shpejtë. Ju vetë, me sytë tuaj, keni
12 parë ndonjëherë këtë urdhër?

13 PË. Unë e kam referencë këtu, referenca 527.

14 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mund të shkojmë pak më poshtë që
15 ta shohim poshtëshënimin.

16 PY. Por këtij, këtë urdhër nuk e keni bashkëngjitur në libër,
17 apo jo?

18 PY. Jo, nuk e kem bashkëngjitur.

19 PY. A është e drejtë që batalioni gardist të paktën në zonën
20 e Llapit, ka qenë thjesht një bashkim ushtarësh nga njësi të
21 tjera ekzistuese? Për shembull, disa nga anëtarët e K33 u
22 kyçën në këtë batalionin e 5-të gardist në zonën e Llapit,
23 kështu?

24 PË. Po, tani, tani nuk mund ta shpjegoj si ka qenë urdhri në
25 atë kohë, por e di që në atë kohë është kërkuar luftëtarët më

1 të përgatitur fizikisht, psiqikisht edhe të gatshëm që të jenë
2 pjesë e batalionit të gardist. Dhe po edhe nga Kështjella 33
3 ka pas pjesëtarë që iu kanë bashkëngjitur ose është komponue
4 batalioni i 5-të gardist është përbërë prej ushtarëve kemi
5 mendu na më të mirë të mundshëm në zonën operative të Llapit.
6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Tani do doja të shihnim faqen
8 301 në libër, që është faqja 298 në PDF.

9 PY. Këtu përmendni faktin, pra, keni përmendur disa nga
10 zhvillimet në pas qershorit të '99-s, në Besianë dhe keni
11 folur edhe për emërimet nga zëvendëskomandanti i zonës së
12 Llapit. E shihni këtë pjesë? Në Besianë.

13 PË. Veç pak të lutem.

14 PY. Në krye të faqes.

15 PË. Po, po e shoh.

16 PY. Pas qershorit të '99-s Kosova supozohej se kishte një
17 qeveri të përkohshme, apo jo?

18 PË. Po, supozoj po e kishte.

19 PY. Atëherë, pse u emërua prefekti i Besianës nga komandanti
20 i zonës dhe nuk u emërua nga qeveria?

21 PË. Nuk kam përgjigje për këtë se nuk jam marrë -- e kam
22 thënë edhe më herët edhe po e përsëris, unë nuk kam bërë komente
23 edhe nuk kam hy në detaje rreth vendimeve ose rreth proceseve
24 të cilat janë kryer. Për mua ka qenë e rëndësishme me i
25 evidentue momentet, ngjarjet që kanë qenë të rëndësishme për

1 vendin tonë edhe me i hap mundësisë të ardhmes që të studiohen
2 këto çështje më detajisht. Nuk di. S'kam përgjigje në këtë
3 drejtim.

4 PY. Faleminderit. E marr parasysh. Tani të flasim për
5 organizimin e zonës së Llapit siç e keni përshkruar në libër.

6 Dëshmitar, ju vetë nuk keni qenë i pranishëm gjatë
7 takimit dhe takimeve që ka mbajtur zona e Llapit ku diskutohej
8 drejtimi dhe organizimi i UÇK-së gjatë luftës, apo jo?

9 PË. Jo, nuk kemi qenë.

10 PY. Pra, çdo gjë që e keni thënë në libër lidhur me
11 strukturën komanduese të zonës së Llapit mbështetet kryesisht
12 në atë që ju kanë thënë pas luftës komandantët e zonës së
13 Llapit dhe luftëtarët e zonës së Llapit, kështu?

14 PË. Po, e saktë.

15 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Shohim faqen 31 të librit, 33 të
16 librit, dhe në PDF është faqja 30.

17 PY. Këtu thoni që:

18 "Komandant Remi arriti që të krijonte -- komandant Remi
19 përmes komandimit dhe kontrollit kishte arritur të krijojë një
20 strukturë të disiplinuar ushtarake, strukturë e cila i kishte
21 të qarta detyrat dhe përgjegjësitë e luftëtarit."

22 Këtë vlerë e kultivoi përmes mësimit dhe edukimit
23 luftarak.

24 I keni dhënë ZPS-së dhe kurrikulën që kanë pasur për
25 formim në zonën e Llapit.

1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do doja që të shfaqej në ekran
2 kjo kurrikul që i keni dhënë ZPS-së. Më falni, më duket se jua
3 dhashë gabim referencën. Është 1552; është një përshkrim i
4 trajnimeve që janë bërë në zonën e Llapit. Shkojmë pak më
5 poshtë. Fillon në faqen 797. Faleminderit.

6 PY. Ju lutemi, hidhini një sy këtij dokumenti. Data është 30
7 shtator 1999, që është pas demobilizimit të UÇK-së, saktë?
8 PË. Unë nuk po di ku po e lexon, por ky dokument është
9 faksimile në librin tim. Ky dokument është si faksimile në
10 librin tim, faqen nuk e mbaj mend. Edhe nuk është, këtu është
11 më 23.01.1999, 23 janar, nuk është shtator 1999. Nëse është
12 shtator e keni gabim, ndërsa ky dokument është faksimile si
13 fotografi në librin tim.

14 PY. Faleminderit. Besoj që ka një dallim përkthimi në
15 anglisht.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Menegon
17 është koha për të bërë pushimin.

18 Dëshmitar, tani do të bëjmë pushimin e drekës. Do
19 rikthehemi në sallën e gjyqit në orën 14.30. Tani mund të
20 largoheni nga salla bashkë me Asistenten. Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikthehemi në
23 orën 14.30

24 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

25 --- Seanca rifillon në orën 14.31

Dëshmitari: Skënder Zhitia (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Menegon

Faqe 96

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 znj. Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

3 Edhe sa kohë ju duhet, znj. Menegon?

4 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Besoj që jo më shumë se sa 10
5 minuta. Përpara se sa të vijë dëshmitari, dua të kërkoj që të
6 pranohen si provë një faqe që e ka parë dëshmitari, që është
7 faqja 70 e librit, që përfundon me 744. Ka të bëjë me
8 Rambujenë, dhe pakënaqësitë e shprehura nga pjesëmarrësit.

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, i nderuar
10 Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
12 [Përkthim] A keni ndonjë përshkrim tjetër përveçse faqen 70?

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00055678-
14 SPOE00045018.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Në faqen që përfundon me 744,
17 pra me ERN-në që përfundon me shifrat 744.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i shtohet provës
19 P187.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
21 [Përkthim] Dëshmitar, do të vazhdojmë tani me pyetjet e ekipit
22 të Mbrojtjes së z. Thaçi.

23 Znj. Menegon mund të vazhdoni më tej.

24 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Dëshmitar, në librin tuaj sikurse u përmend dhe më herët,

1 ju keni përmendur që janë zhvilluar disa stërvitje në zonën
2 operative të Llapit. Pyetja ime është kjo: ju personalisht,
3 nuk është se jeni trajnuar ose nuk është se jeni stërvitur
4 vetë, nuk ju është dhënë ndonjë stërvitje në zonën e Llapit,
5 apo jo?

6 PË. Jo.

7 PY. Pra informacioni në librin tuaj, sa i takon stërvitjes në
8 zonën e Llapit është informacion që juve jua kanë dhënë
9 luftëtarët ose ushtarët e UÇK-së të cilët ju i keni
10 intervistuar, a është e saktë kjo?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
14 paraqesë në ekran faqen 178 të librit që është pjesë e provës
15 P187. Faleminderit.

16 PË. Z. Dëshmitar, ky është një vendim i Shtabit të
17 Përgjithshëm të UÇK-së i datës 18 nëntor 1998 që ka të bëjë me
18 organizimin e nënzoneve operative të UÇK-së, a është kështu?

19 PY. Po.

20 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund të paraqisni në ekran
21 provën P1016. Do ishte mirë të kishim të dy versionet në shqip
22 në ekran. Në këtë dokument do shikojmë një vendim të ngjashëm.
23 Faleminderit.

24 PY. Z. Dëshmitar, gjatë seancës përgatitore ju dërgohet, ju
25 tregohet, ju është treguar, në fakt, një version thujtë

1 identik i këtij vendimi, përveç faktit që në fillim fare është
2 numri i protokollimit që është 442-5/108 [Sipas përkthimit] në
3 vend të numrit të protokolluar të dokumentit që është ngjitur
4 442-2-/091. A është kështu?

5 PË. Po, kështu është.

6 PY. A është e vërtetë që versionin e dytë të vendimit ju nuk
7 e keni parë përpara se sa t'jua tregonte këtë dokument
8 Prokuroria?

9 PË. Jo, nuk e kam pa.

10 PY. Nga seanca përgatitore e kuptoj që ju nuk keni qenë në
11 gjendje që të shpjegoni arsyen se pse dokumentet kanë pasur
12 numra të ndryshme protokolli. A është e saktë kjo?

13 PË. Po, e saktë është. Nuk kam mujt me, edhe me e kuptu, edhe
14 me e shpjegu pse ka ndodh kështu. Bazuar në përvojën time që
15 kam pas 20 vjeçare, në institucionet e sigurisë, dhe kur kam
16 lëshuar ndonjë dokument asokohe, është lëshu ai dokument,
17 numri i protokollimit vazhdimisht ka qenë i njëjti. Për këtë
18 s'kam mujt me e kuptu nga përvoja ime pas lufte, e kam fjalën.

19 PY. Faleminderit. A mund të ketë qenë arsyeja, Dëshmitar, që
20 ky dokument, ose dokumenti i dytë nuk ka qenë autentik ose nuk
21 ka qenë lëshuar në kohën që pretendohet që të jetë lëshuar?
22 Mund të ketë qenë kjo arsyeja?

23 PË. Nuk kam koment në këtë drejtim.

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj, kërkon spekulim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet

1 kundërshtimi. Nuk është e nevojshme t'i jepni përgjigje,

2 Dëshmitar.

3 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam më pyetje
4 të tjera.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan?

6 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Tully?

9 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

11 z. Tully.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më
13 jepni vetëm pak çaste në mënyrë që të organizohem.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Znj. Alagendra, mund të thoni se sa kohë ju duhet për të
16 bërë pyetjet për dëshmitarin?

17 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, i nderuar
18 Gjykatës, mund ta përsërisni dhe një herë?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndoshta 45 minuta, një orë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Pyetje të palës tjetër nga znj. S. Alagendra:

23 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

25 PË. Mirëdita.

1 PY. Unë quhem Shyamala Alagendra, dhe jam pjesë e ekipit
2 Mbrojtës të z. Krasniqi. Kam disa pyetje për ty, Dëshmitar. Ju
3 kërkoj paraprakisht [Sipas përkthimit] që ndoshta disa prej
4 pyetjeve mbase ju janë bërë edhe nga anëtarë të tjerë të
5 ekipeve këtu në sallë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'ju
7 them që në qoftë se pyetja është bërë, nuk duhet ta përsërisni
8 më pyetjen?

9 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Do të mundohem të bëj më të
10 mirën time.

11 PY. Tani, shkojmë përsëri në fillim të dëshmisë. I keni thënë
12 Prokurorisë gjatë intervistës dhe keni dhënë dëshmi po ashtu
13 para Trupit Gjykes se në kohën kur jeni kyçur në UÇK, në maj
14 të 1998, keni qëndruar kryesisht në shtëpi. Keni qenë
15 stacionuar në shtëpi dhe keni shpenzuar shumë kohë me familjen
16 tuaj asokohe. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po, është e saktë. Por nëse ka nevojë due me e elaborue.
18 Jo veç unë, por pjesa ma e madhe e luftëtarëve gjatë asaj
19 periudhe kemi qëndru ose në shtëpitë tona ose jashtë. S'do të
20 thotë që kemi qëndru në njësi, për shkak të rrethanave që kanë
21 qenë. Kjo kur them shtëpi, duhet me nënkuptu që UÇK-ja është
22 organizuar nëpër shtëpijat tona. Dhe shtëpitë u bënë në atë
23 kohë kazerma, u bënë vend bazimi, vend qëndrimi të gjithë
24 neve.

25 PY. Faleminderit. Po ashtu, Dëshmitar, i keni thënë

1 Prokurorisë se roli kryesor i juaji ishte në fakt që të
2 shkonit dhe të flisnit me civilët, dhe se juve ju ishte besuar
3 kjo detyrë për shkak të autoritetit edhe për shkak të
4 reputacionit që kishit ndërmjet kosovarëve si profesor edhe si
5 rezultat i asaj çfarë ju përshkruani si reputacion i mirë i
6 familjes tuaj. A është e saktë kjo?

7 PË. Po, është e saktë.

8 PY. Kur keni folur për njësitin tuaj, Dëshmitar, pra për
9 njësitin K33, ju atë e keni përshkruar si një njësit vëzhgues.
10 A kam të drejtë, është e saktë kjo?

11 PË. Po, keni të drejtë. Për njësi periudhë të caktuar po.

12 PY. Po ashtu keni theksuar gjatë intervistës me Prokurorinë
13 se njësi juaj nuk ka qenë i përfshirë në luftën frontale,
14 domethënë, që nuk është se ka qenë i përfshirë në ndonjë
15 veprimtari ushtarake. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Deri në mars. Drejtpërdrejt deri më 25 mars nuk ka marrë
17 pjesë. Mbas 25 marsit deri në përfundim të luftës, kemi marrë
18 pjesë në të gjitha luftimet, betejat që janë zhvillu
19 pavarësisht ku. Po si njësi vëzhguese e kemi dhanë kontributin
20 në të gjitha betejat që është zhvillu nga 24 dhjetori.

21 PY. Faleminderit. I keni thënë Prokurorisë që shumë prej
22 ushtarëve tuaj në njësitin, në njësitin ku bënit pjesë ju, nuk
23 ishin as të armatosur. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po, në faza të caktuar, po. Na ishim njësi vëzhguese që
25 po vepronim në kushte dhe rrethana jashtëzakonisht të randa.

1 Dhe kishim një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe sepse
2 ishim në një fshat ku lufta nuk ishte ende e pranishme dhe
3 detyrat që ishin shumë specifike dhe ne duhej, u përgatitëm në
4 disa drejtime që ne në rend të parë të ruajmë popullatën dhe
5 t'i kryejmë detyrat që neve na ngarkoheshin.

6 PY. Faleminderit. Keni dëshmuar po ashtu gjatë intervistës me
7 ZPS-në që ju as nuk u bëtë publik, domethënë, nuk është se
8 dolët publikisht që ishit pjesëtarë të UÇK-së. Për ta sqaruar,
9 me këtë keni dash të thoni që keni operuar në mënyrë
10 klandestine apo jo?

11 PË. Fshati ku na kemi themelimi është në një shtrirje
12 gjeografike jashtëzakonisht specifike. Nëse ka nevojë me e
13 shtue, me e elaboru më shumë, e elaboroj. Në të kundërtën,
14 është fakt që një kohë të gjatë kemi veprue si njësi e
15 kufizime dhe e padukshme për popullatën dhe thjesht forcat
16 serbe. Sepse kemi dash me kry detyrat që na janë ngarkue.

17 PY. Faleminderit. Kur juve keni shkuar në atë çfarë juve e
18 përshkruani si zonë të sigurt në Halabak, ju thoni gjithashtu
19 që jo të gjithë anëtarët e njësitit tuaj kanë qenë bashkë me
20 juve, domethënë vetëm një numër i vogël i anëtarëve të
21 njësitit tuaj janë zhvendosur bashkë me juve, a është e saktë
22 jo?

23 PË. Po, është e saktë, për shkak të mungesës së armatimit dhe
24 fatkeqësisht u desh që një pjesë e bashkëluftëtarëve të mi,
25 përkundër vullnetit, dëshirës, me u largu, por nuk u largun

1 nga Kosova, por ata ishin prapë në mbështetje tonë, por nuk
2 ishin pjesë këta në, ishin pjesë drejtpërdrejt në luftime dhe
3 operacione. Po ka raste kur na kanë bashkëngjitur ma vonë për
4 shkak që siguronim armatim.

5 PY. Faleminderit. Dëshmitar, ju nuk jeni takuar asnjëherë
6 fizikisht me komandantin e zonës, Rustem Mustafën, që nga
7 koha kur jeni kyçur në UÇK deri në nëntor 1998, këtë keni
8 thënë, apo jo, në intervistën tuaj?

9 PË. Përafërsisht, po e kam thanë, po.

10 PY. Po ashtu i keni thënë Prokurorit gjatë intervistës, që
11 mund ta keni takuar atë në një rast pas kësaj kohe, por nuk
12 jeni i sigurt as për këtë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Që jam taku është e sigurt, pas asaj kohe edhe disa herë
14 të tjerë, por saktësisht nuk e kam dit kohën kur, se s'më ka
15 bo përshtypje në atë kohë për me mbajtur mend kur jemi taku me
16 komandantin.

17 PY. Dhe po flasim vetëm për një rast, apo jo, që jeni takuar
18 me të? Apo për më shumë?

19 PË. Fjala ka qenë kur e kam taku së pari herë, se jo sa herë
20 jemi taku.

21 PY. Për të qenë i qartë, Dëshmitar, gjatë intervistës me ZPS-
22 në keni thënë që mund ta keni takuar atë në një rast, por që
23 nuk ju kujtohet tamam ai rast. Është kështu?

24 PË. Po as sot nuk e mbaj mend me saktë kur jemi takue së pari
25 herë me të.

1 PY. Në rregull. Dëshmitar, nga intervistat tuaja, duket se
2 kontakti i vetëm që keni pasur gjatë asaj kohe me Kadri
3 Kastratin që ka qenë zëvendëskomandanti i zonës, ka qenë në
4 janar të 1999 ku ju thoni që e keni takuar shkurtimisht në
5 mënyrë të tillë që të mblidhnit këto radiomarrëset lidhëse, a
6 është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. As atëherë s'besoj që kam thanë dikund kah dhjetor,
8 fillimi i janarit, nuk jam, s'kam qenë i saktë. As nuk kam
9 mujt me precizu kur jemi takue. Jo për me i mbledhë, por për
10 me u pajis, është kanë fjala, me radiolidhje, ose me mjet
11 komunikimi. Dhe mbas kësaj kohe kam mund me e taku edhe hera
12 të tjera. Ajo ka qenë hera e parë.

13 PY. Kur jeni takuar me të, ju nuk është se keni diskutuar për
14 çështje të tjera, apo jo, sepse këtë keni thënë në intervistën
15 me ZPS-në, është kështu?

16 PË. Po, kështu është.

17 PY. Gjithashtu, në këtë rast kur jeni takuar me të, lidhur me
18 radiot lidhëse, ju rastësisht jeni takuar gjithashtu edhe me
19 Nuredin Ibishin që rastisi që të ishte aty. A është e saktë
20 ky, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Dëshmitar, gjatë luftës i keni thënë Prokurorisë që ju
23 nuk jeni takuar asnjëherë me Latif Gashin, është e saktë kjo?

24 PË. Kam thanë nuk jam taku personalisht, por vetëm me të, por
25 gjatë luftës kam mujt me e taku në numër ma të madh ose gjatë

1 luftimeve ose gjatë operacioneve, por personalisht vetëm me
2 atë nuk jam taku asnjherë, kështu i kam thanë. Nuk jam taku
3 personalisht me të. S'kam pas takim me të. Kjo ka qenë që kam
4 thanë.

5 PY. Gjithashtu, gjatë intervistës keni shpjeguar se Idriz
6 Shabani ishte komandanti juaj i përgjithshëm. Megjithatë,
7 personi me të cilin ju keni pas më shumë komunikim ka qenë
8 Muhamet Latifi. A është e saktë kjo?

9 PË. E saktë. Varet në kohë, çfarë kohësh, por e saktë. Me të
10 dy kam pas komunikim të vazhdueshëm.

11 PY. Në fakt, kur ju është dhënë mundësia që të sqaronit
12 intervistat tuaja të mëparshme, keni sqaruar për Prokurorinë
13 që ju nuk i keni raportuar Muhamet Latifit formalisht ose
14 zyrtarisht, por ajo çfarë keni bërë juve është thjesht që e
15 keni informuar atë ose e keni përditësuar atë lidhur me numrin
16 e personave që ishin kyçur në UÇK apo për çështje të tjera, a
17 është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Është fjala për çështje të tjera, se varësisht prej
19 detyrës çfarë e kemi pas. Kam thanë që nuk kemi pas rast me
20 raportue me shkrim. Nuk kam raportue me shkrim, po, e saktë.

21 PY. Në fakt, ju thoni që sa i takon raportimit, ju e kishit
22 fjalën për njoftimin dhe për vënien në dijeni të Muhamet
23 Latifit lidhur me mobilizimin dhe rekrutimin. Këtë i keni
24 thënë Prokurorit, apo jo?

25 PË. Po, raport të përgjithshëm në këtë drejtim nuk i kemi

1 dhënë Muhamet Latifit. Po, e saktë.

2 PY. Pra, i keni thënë Trupit Gjykues që ju nuk keni pasur
3 kontakt asnjëherë me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Për të
4 qenë të qartë, Dëshmitar, ju nuk keni pasur asnjëherë kontakt
5 me Jakup Krasniqin gjatë luftës, apo jo?

6 PË. Po, e saktë, nuk kam pas asnjëherë kontakt me të.

7 PY. Tani, dëshiroj të flasim pak lidhur me librin tuaj dhe
8 lidhur me metodologjinë mbi të cilën është mbështetur libri
9 juaj. Në qoftë se do t'i kthehemi faqes 309 të librit tuaj, që
10 e ka diskutuar një prej kolegëve të mi, ju aty keni dhënë një
11 listë të burimeve ku jeni mbështetur kur keni shkruar këtë
12 libër. Nëse ju kujtohet, kjo faqe ju është treguar më herët
13 sot.

14 Personi ose zëri i parë në listë është Arkivi i Kosovës
15 së Prishtinës. A ju kujtohet kjo listë, Dëshmitar?

16 PË. Po, më kujtohet.

17 PY. Në fakt, ajo për të cilën keni qenë shumë i qartë gjatë
18 intervistës me Prokurorinë, ishte që në fakt nuk është se ka
19 pasur një sistem të duhur arkivi në Prishtinë. A është kështu,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë është.

22 PY. Në fakt, materiali që ka qenë aty në çfarëdolloj forme që
23 mund t'i drejtoheni asaj forme, ju keni thënë që realisht nuk
24 ka pasur relevancë dhe nuk është se ka pas ndonjë rëndësi ai
25 lloj materiali se nuk është se ku ke pas të mbështetesh ti për

1 sa i takon çfarë, asaj çfarë të ofronin arkivat. A është e
2 saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po, e saktë. Në kohën kur unë e kam vizitu arkivën, nuk
4 kam gjet diçka, por për faktet që unë e kam vizitue, kam
5 evidentu, kam mujt gazeta, revista, diçka, por unë edhe nuk e
6 kam citu pastaj gjatë si referencë në librin tim arkivën e
7 Kosovës. E kam regjistru që e kam konsultu, por s'kam pas
8 ndonjë material diçka që më ka shërby në atë kohë.

9 PY. I keni thënë Prokurorisë gjatë intervistës me të se,
10 pavarësisht se nuk kishte asgjë relevante në arkiv, dhe
11 pavarësisht se nuk kishte se kishte ndonjë dobi kjo arkivë,
12 juve e keni listuar atë si burim thjesht për të, për ta
13 renditur atë si burim. A është e saktë kjo? Këtë keni thënë në
14 intervistë, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po, për afërsisht, po kështu kam thanë. Sepse nuk ka pas
16 një diçka, por megjithatë nuk di që në atë kohë s'ka pas diçka
17 në arkivën e Kosovës, si është thirr atëherë.

18 PY. Çfarë doni të thoni me këtë, doni të thoni që ju
19 dëshironit të kishit një libër që dukej se ishte i mbështetur
20 më shumë në kërkime dhe më shumë autoritativ për lexuesit,
21 edhe në qoftë se juve nuk është se keni gjet ndonjë burim të
22 besueshëm ose që mund t'ju vinte në ndihmë, juve këtë keni
23 dashur që të bëni përmes përfshirjes së kësaj liste në librin
24 tuaj, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Sigurisht, për neve me interes ka qenë kjo, që na të kemi

1 burime dhe të dhana ma të shumta, ma të plota, por në atë kohë
2 fatkeqësisht unë nuk kam gjet diçka në arkivën e Kosovës. Të
3 paktën unë nuk kam mujt me rastis me pas.

4 PY. Gjithashtu, më herët sot, kur u pyetët nga kolegët e mi,
5 juve konfirmuat po ashtu që, sa i takon edhe arkivave të zonës
6 5, edhe në këtë rast ju nuk jeni të sigurt sa i takon
7 autenticitetit të dokumenteve të arkivave të kësaj zone. Ju
8 kujtohet ta keni thënë më herët këtë sot?

9 PË. Po, e kam thanë, po e përsëris. E kam shkru edhe në
10 parathënie të librit tim që dokumentat që unë i kam shfrytëzu
11 në arkivën e zonës 5 kanë qenë të pasistemuara. Këtë e kam
12 thënë këtu e 20 vjet, pavarësisht kush ka me lexu edhe kush ka
13 me u referu në librin tim. Kam dashtë me tregu që këto
14 dokumente nuk kanë qenë të verfiku prej një komisioni, në ka
15 ndonjë përgjegjësi të listimit të tyre të përzgjedhjeve sipas
16 nevojës ose karakterit të tyre, kështu që thjesht këto
17 dokumente kanë qenë të pasistemuara në arkivën e zonës 5.

18 Edhe sot, edhe gjithë, unë nuk kam, nuk jam autoritet
19 edhe nuk kam përgjegjësi të saktësoj mbi vërtetësinë edhe
20 saktësinë e tyre. Unë i kam shfrytëzue, i kam përdor, kjo
21 është e gjitha.

22 PY. Është e qartë, faleminderit. Tani dëshiroj t'ju bëj disa
23 pyetje lidhur me referimin ose referencën që keni bërë për
24 librin që ka shkruar Jakup Krasniqi. Jakup Krasniqi nuk është
25 se ka qenë një ndër personat që ju keni intervistuar për

1 librin tuaj, Dëshmitar, apo jo?

2 PË. Jo, nuk e kam intervistuar, por sigurisht për neve gjithë
3 studiuesit, personaliteti i Jakup Krasniqit është një
4 personalitet me integritet i besueshëm, një personalitet që ne
5 kemi respekt të vazhdueshëm, për të gjitha fazat e kontributit
6 të tij, kështu që nuk kam pas. Edhe fakti tjetër pse unë nuk i
7 kam intervistue këto personalitete është, po e përsëris, tema
8 bosht e librit tim, studimit tim, ka qenë zona operative e
9 Llapit. Kështu kur flasim për Shtabin e Përgjithshëm të
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe UÇK-në në përgjithësi, unë
11 kam dhanë disa nga informacionet ose të dhënat që unë i kam
12 posedue ose kam arrit të takoj që lexuesi nga trevat që unë e
13 kam pas temën bosht, me lexue dhe në këtë aspekt veç disa të
14 dhëna.

15 Dhe është fakt që unë e kam lexue me kënaqësi librin e z.
16 Krasniqi dhe e kam përdor edhe si referenca ku unë kam vlerësu
17 që mund ta përdor ose është në interes të lexuesit.

18 PY. Pra, juve nuk keni folur asnjëherë me të lidhur me librin
19 tuaj, dhe ai asnjëherë nuk ka folur me ju lidhur me librin e
20 tij, kështu, Dëshmitar?

21 PË. Po, e saktë, nuk kemi pas raste dhe s'kemi biseduar.

22 PY. Për shembull ju nuk e dini se cila është baza e disa prej
23 gjërave që ka thënë ai në librin e vet, kam të drejtë unë në
24 këtë?

25 PË. Unë nuk e di, por përderisa ka qenë një libër i botuem, i

1 publikum, unë i kam dhanë vedit të drejtë për me iu referu.

2 PY. Po ashtu ju nuk e dini se cilat pjesë, për shembull, të

3 librit të z. Krasniqi, librave të z. Krasniqi, janë

4 ekzagjerime, ose zmadhime, nuk e dini. Kam të drejtë në këtë?

5 PË. Jo, nuk e di.

6 PY. Dëshmitar, ju keni sqaruar se në fakt këto intervista siç

7 e ka përshkruar edhe Prokuroria në këtë proces, pra këto

8 intervista që keni pasur me pjesëtarë të UÇK-së, ato nuk kanë

9 qenë intervista në kuptimin klasik të fjalës, a është kështu?

10 PË. Po, kështu është. Unë e kam sqarue edhe gjatë dhënies së

11 intervistës më herët, por dhe sot e përmend një rast, kështu

12 që nëse ka nevojë prapë e shpjegoj, e elaboroj, këtë çështje.

13 PY. Dëshmitar, ju keni thënë në fakt që këto kanë qenë biseda

14 të zakonshme, bashkëbisedime më tepër, kështu?

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të

16 më jepni, mund t'i kërkonit znj. Alagendra që të japë një

17 referencë për këtë?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

19 jepni referencën.

20 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po

21 shikoj këtu intervistën, transkriptin e intervistës së tij. Të

22 nderuar Gjykatës, për interes të kohës do ishte më mirë

23 ndoshta që t'jua bëj pyetjen.

24 PY. Dëshmitar, a do i përshkruanit këto bisedat që keni pasur

25 me pjesëtarë të UÇK-së si biseda rastësore, bashkëbisedime më

1 tepër?

2 PË. Bashkëbisedime po, rastësore, ne rastësisht nuk jena
3 takue. Po e kam thanë, po e përsëris, nuk kam pas një pyetësor
4 standard me pyetje-përgjigje. Gjatë bashkëbisedimit, se në
5 gjuhën shqipe është fjala "intervistë" i bjen bashkëbisedim
6 mes dy personave, ose disa personave. Unë në këtë rast kam
7 shfrytëzue njohuritë e mia që i kam pas bazuar në literaturat
8 që kam shfrytëzue deri në atë kohë. Të dhënat që unë i kam
9 posedue bazohen në deklaratat në televizione, gazeta,
10 intervista të ndryshme dhe bashkëbisedimin e kam zhvillu
11 kryesisht për të plotësuar informacionin tim. Unë nuk kam pas
12 incizim të bisedave. Nuk kam mbajtur ndonjë lloj procesi që unë
13 edhe bashkëbiseduesi ta nënshkruajmë kur e kemi zhvillu këtë
14 bisedë ose intervistë, si do ta quajmë, që me mbajtur
15 përgjegjësi të dyfishtë, unë çka po them, edhe ai çka ka
16 thanë. Por këtu kanë qenë, kështu kanë qenë, këto
17 bashkëbisedime të miat, edhe për këtë e kam thanë disa herë në
18 librin tim. Në mesin e atyre u tha edhe sot, në një rast kur e
19 kam sqarue në një nga fusnotat e mia.

20 PY. I keni thënë Prokurorisë, por e përmendët edhe ditën e
21 sotme, se ndonjëherë takoheshit me një grup personash së
22 bashku, mund të kishte pesë a gjashtë syresh të pranishëm
23 gjatë bisedave, këtyre bisedave, kështu?

24 PË. Ka pas raste. Ka raste, por në ato raste nuk i kam marrë
25 si biseda përfundimtare, për faktin që thjesht e kam thanë

1 atje gjithherë mbas nji kohe, mbas dhjetë vjete, shtatë vjete,
2 edhe sot, harresa është njerëzore, edhe gjërat mund të
3 shpjegohen prej këndvështrimeve të ndryshme dhe të gabueshme.
4 Si të tilla unë edhe i kam marrë edhe besoj që e kam thanë, po
5 e tham prapë, unë nuk kam mujt me e dhanë ma të mirën teme në
6 aspektin shkencor sepse këto biseda edhe bashkëbisedime kanë
7 mujt me kanë jo qëllimisht, por për shkak të harresës, edhe të
8 gabueshme.

9 PY. Në fakt, ju i keni thënë Prokurorisë se nga këto biseda
10 që keni pasur me grupe personash, ju nxirrni opinionin tuaj
11 mbështetur në këto biseda, dhe më pas këtë opinion e
12 përfshini në libër, saktë?

13 PË. Po, e kam thanë, por e kam thanë edhe në parathënie, kur
14 i kam përdor këto. Vetëm në rastin kur s'kam pas kurrfarë
15 rrugëzgjidhje tjetër, edhe për rastet të cilat thjesht nuk e
16 kam prish shtrimin dhe renditjen e ngjarjeve dhe momentet
17 kryesore të UÇK-së në zonën e Llapit.

18 PY. Sot na thatë se nuk keni ruajtur asnjë prej shënimeve që
19 keni mbajtur gjatë këtyre bisedave. Por dhe gjatë intervistës
20 me Prokurorinë, ju keni thënë që ndonjëherë gjatë këtyre
21 bisedave as nuk merrni shënime, kështu?

22 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem, na jepni referencën.
23 Unë i kujtoj disa prej gjërave, por do vlerësoj më shumë sikur
24 të na jepej edhe referenca.

25 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, është pjesë e

1 intervistës që është Pjesa 2, faqja 18, rreshtat 17 deri në
2 19.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Pra, ju e dini sigurisht që z. Rustem Mustafa dha dëshmi
6 publike këtu, në muajin korrik. E dini këtë?

7 PË. Po, e di.

8 PY. E përcollët dëshminë e tij, qoftë në kohë reale apo më
9 pas në shtyp në media?

10 PË. Nuk kam pas mundësi në atë kohë, për shkak të rrethanave
11 familjare çfarë i kam pas, por pjesë të intervistës kam mujt
12 me i përcjell.

13 PY. Në fakt, z. Mustafa konfirmoi se bashkëbisedimet me ju në
14 vetvete nuk kanë qenë një intervistë, në kuptimin e parë të
15 fjalës, por ka qenë thjesht një bashkëbisedim. Ky ka qenë, ky
16 është një karakterizim i drejtë i bashkëbisedimit tuaj, apo
17 jo?

18 PË. Po.

19 PY. Kur dha dëshmi, ai tha që ka bërë një bashkëbisedim me
20 ju, kështu ka qenë? Një bashkëbisedim ka pasur me ju?

21 PË. S'më kujtohet, për faktin se kanë kalu shumë vjet edhe me
22 të jam taku, kam bisedu edhe për çështje të tjera, kam bisedu
23 edhe për këtë. Unë -- po, e rëndësishme është që kam
24 bashkëbisedu me të.

25 PY. Z. Mustafa dha dëshmi në këtë sallë gjyqi dhe tha që

1 lufta e UÇK-së më shumë ka qenë propagandë sesa operacionale.

2 Pajtoheni ju me këtë deklaratë?

3 PË. S'kam koment. S'më është dhanë mendim për deklarata të
4 persona që kanë përgjegjësi dhe s'jam autoritet unë me dhanë
5 mendim tash se si është deklarue Rrustem Mustafa. Unë e
6 vlerësoj dhe e respektoj për komandant që e kam pas gjatë
7 luftës, por për opinione dhe mendime të tijna unë s'jam ai
8 autoritet që duhet me dhanë mendim.

9 PY. Po a pajtoheni ju me këtë deklaratë që lufta e UÇK-së më
10 shumë ka qenë një propagandë se sa aktuale, operacionale?

11 PË. S'kam koment.

12 PY. Z. Mustafa po ashtu tha në këtë sallë gjyqi se forcat
13 serbe mund të hynin në çdo pjesë të zonës së tij nëse
14 dëshironin, dhe UÇK-ja nuk mund t'i parandalonte dot, nuk i
15 bllokonte dot. A pajtoheni ju me këtë?

16 PË. Për këtë, unë them që po. Nëse marrim parasysh forcat në
17 terren, numrin e tyre edhe mundësitë në pajisje, në logjistikë
18 e të tjera, është e nënkuptueshme, të paktën. Edhe pse s'kisha
19 dash me u përgjigj në pyetje rreth mendimeve të tjerëve.

20 PY. Faleminderit. Atëherë do të doja të shihnim një faqe të
21 librit tuaj.

22 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Është faqja 55, në PDF. Do
23 i lutesha ta vendosnit në ekran.

24 PY. Dëshmitar, në paragrafin e fundit, ku thotë:

25 "UÇK-ja...".

1 Pra ku thotë:

2 "... në kuadër të rrugëtimit."

3 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, është
4 faqja 55 e librit.

5 PY. Është paragrafi i fundit fare. E shihni përpara në ekran?

6 PË. Po, faqja 55, e shoh.

7 PY. Këtu ku thoni:

8 "Aksionet mirë të koordinuara të UÇK-së në këtë kohë në
9 gjithë Kosovën, e sidomos në Drenicë, Llap, Dukagjin e të
10 tjerë, bëjnë që shumë nga këto zona të ishin të papenetrueshme
11 nga policia serbe."

12 E shihni këtë? Po, a pajtoheni me mua që nuk e keni
13 vendosur burimin për këtë deklaratë?

14 PË. Cili viti është ky, e nderuar Avokate?

15 PY. Është një faqe në librin tuaj, është në librin tuaj kjo.
16 Dhe për këtë që keni thënë këtu, nuk keni vendosur referencën
17 ku e keni bazuar këtë.

18 PË. Unë e shoh fjalinë gjysmë, nuk e shoh deri në fund. Veç
19 deri te "Dukagjini e të tjerë", e shoh. Kjo i takon vitit 19 -
20 -

21 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbase duhet të shkojmë në
22 faqen tjetër që të shfaqet e plotë? Më intereson kjo pjesa ku
23 thotë "të jenë vende të pashkelura për policia serbe...".

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Teksti fillon në faqen
25 pararendëse, por do të ishte mirë që Avokatja t'i jepte dhe

1 kontekstin dëshmitarit, që ta kuptojë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt
3 jepini mundësinë ta shohë të plotë tekstin.

4 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë --

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni një
6 çast, ju lutem. Dëshmitari duhet të shohë fjalinë deri në
7 fund.

8 Dëshmitar, e shihni tani të gjithë fjalinë?

9 DËSHMITARI: Po, prej fillimit e shoh, por është e vitit
10 1997, nuk është, edhe nuk po e kuptoj cili është qëllimi i
11 pyetjes së Avokates.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 problem me kompjuterin, sepse ne të gjithë e shohim të plotë
14 këtë fjali?

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohen]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
18 kalojmë tek faqja tjetër në shqipen, se shqipja me sa duket
19 duhet të kalojmë në faqen tjetër që ta shihni të plotë.

20 Po tani, Dëshmitar, e lexoni të plotë?

21 DËSHMITARI: Po, po, e lexoj tani të plotë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund
23 t'ia bëni pyetjen.

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, unë do të doja të më thonit ku e keni bazuar

1 këtë që keni thënë, pra cili ka qenë burimi juaj?

2 PË. Po, tani mbas një kohe kaq të gjatë se ku, po sigurisht

3 në informacionet që janë dhanë nëpër mjetet e informimit

4 publik, ose nëpër komunikatat, nuk muj me e saktësue saktë,

5 por kjo i takon vitit 1997, dhe nuk është e vitit 1998. Por

6 nuk, përderisa nuk e kam vendos, nuk mund ta, ashtu,

7 hamendësoj edhe të dhanë një përgjigje të gabueshme. Ky është

8 mendimi im personal që e kam formësue bazuar në informacionet,

9 njohuritë që i kam pas paraparakisht.

10 PY. Dëshmitar, sot ju dhatë dëshmi për një takim që është

11 mbajtur mes datës 18 deri në 20 gusht. Bëhet fjalë për këtë

12 rastin kur u bë një vizitë nga ana e Shtabit të Përgjithshëm.

13 Ju na shpjeguat që ka qenë thjesht një zyrtarizim i emërimeve.

14 A ju kujtohet ta keni thënë këtë sot?

15 PË. Po, më kujtohet.

16 PY. Dhe sqaruat pastaj që emërimet ishin kryer që më herët,

17 kështu?

18 PË. Po, nëse ka nevojë me e elaborue në lidhje me këtë.

19 PY. Nuk është e nevojshme, faleminderit. Pyetja ime është

20 kjo, këto shpjegime që dhatë ju që këto emërimet ishin kryer

21 edhe thjesht u bë një zyrtarizim i tyre, ky është një

22 informacion që nuk gjendet në librin tuaj, apo jo?

23 PË. Po fjala zyrtarizim, u bënë zyrtare ato që ishin emëru më

24 herët nga komandanti i zonës operative të Llapit.

25 PY. A mund t'i përgjigjeni pyetjes time. Pyetja ime është

1 kjo: Shpjegimet që dhatë ju sot se këto emërime ishin bërë më
2 përpara, dhe gjatë kësaj vizite u bë thjesht zyrtarizimi i
3 tyre, këtë që shpjeguat sot, pra këtë informacion ju nuk e
4 keni përfshirë në librin tuaj, apo jo?

5 PË. Po nëse lexohet libri mendo shkoqitet fjalë e fjali e
6 paragraf, nënkuptohet. Kjo është e nënkuptueshme, se në librin
7 tim ma herët shihet me 18 korrik takimi që është mbajt në
8 zonën operative të Llapit, dhe që janë bo emërimet. Nëse e
9 shihni nëse i referoheni, atëherë nënkuptohet. A nëse e
10 shkëpusim, atëherë i bie që nuk e kam theksue në libër, por
11 nëse lexohet libri kujdesshëm, atëherë nënkuptohet që unë e
12 kam thanë në librin tim që komandant Rrustem Mustafa, bazuar
13 edhe kjo nëse lexohet në mënyrë kronologjike, nënkuptohet që
14 bashkëpunëtorët e vet, bashkëluftëtarët me të cilët kishte
15 fillue ma herët në rrugëtimin drejt organizimit të UÇK-së në
16 Llap, edhe që veç thuajse i kishte vendos, merrnin për pozita
17 të ndryshme.

18 Më 18 korrik e keni në librin tim, i ka bo zyrtare, i ka
19 bo emënimet e tyre. Prapë në të dy rastet unë i quj, i ka
20 zyrtarizu, sepse ma herët në Llap ishin emëru prej tijna, i
21 boni zyrtare më 18 korrik, dhe delegacioni i Shtabit të
22 Përgjithshëm ia prezentoi, e keni prapë, edhe Shtabi i
23 Përgjithshëm, delegacioni, vetëm i boni zyrtare të paktën
24 kështu nuk muj me thanë ma shumë se s'kam të drejtë të them si
25 shkencëtar dhe si autor i librit.

1 PY. Dëshmitar, ju treguan një fragment sot të librit të z.
2 Jakup Krasniqi. Ua tregoi znj. Prokurore sot, dhe në libër ai
3 thoshte se gjatë kësaj vizite u emëruan komandantët prej
4 Shtabit të Përgjithshëm.

5 A pajtoheni me mua, Dëshmitar, që kjo s'është e vërtetë,
6 atëherë? Bazuar në atë që shpjeguat ju, kjo nuk është e saktë.

7 PË. Unë muj me thanë që ato që i kam shkruar edhe që më thanë
8 mue. Mendimet nëse nuk kam dhanë ndonjë koment edhe një
9 analizë të vendimeve të ndryshme, atëherë nuk kisha me dhanë
10 edhe sot. Por është e nënkuptueshme se Shtabi i Përgjithshëm
11 nuk emëroi njerëz që i boni përzgjedhjen ai, që ai i
12 seleksionoi. Ai boni kriteret e veta për personat që duhen të
13 emërohen në zonë.

14 PY. Dëshmitar, ju kërkoj shumë ndjesë që ju ndërpres --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Alagendra, vazhdoni, ju lutem, e keni trajtuar tre herë tashmë
17 këtë.

18 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Më lejoni ta përsëris
19 pyetjen.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. E keni
21 bërë pyetjen, e ka dhënë përgjigje, përgjigjen e ka pasur
22 shumë të qartë. Thjesht që ju s'po pajtoheni me përgjigjen e
23 tij dhe po argumentoni me të.

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë po e pyes për librin e
25 z. Jakup, jo për librin e tij. Mund ta formuloj dhe një herë

1 pyetjen, se mbase s'më ka kuptuar pyetjen.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani e
3 kuptuam ne ku e kishit ju pyetjen. Atëherë, ju lutem, bëjeni
4 pyetjen tamam. Ai e ka dhënë përgjigjen, i ka dhënë sqarimet,
5 me aq sa mundej. Për mua kaq do të mjaftonte.

6 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, ju kërkoj ndjesë, do ta përsëris dhe një herë
8 këtë takim. Unë po ju pyes për atë fragmentin që ju treguan
9 sot, por që ishte i librit të z. Jakup Krasniqi, jo në librin
10 tuaj. Dhe unë ju thashë kështu, që në librin e z. Jakup
11 Krasniqi ai, z. Krasniqi pra, thotë në librin e tij se në këtë
12 vizitë u emëruan komandantët, por kjo ama nuk është e saktë,
13 sepse këta komandantë ishin emëruar më herët. Të paktën sipas
14 dëshmisë suaj. A pajtoheni me mua? Pra, që ajo që ka thënë z.
15 Jakup Krasniqi në librin e tij, i takon të jetë e pasaktë.

16 PË. Unë po e them mendimin tim, dhe nuk kam, nuk i dha vetit
17 të drejtë të komentoj diçka tjetër. Në kohën kur delegacioni i
18 Shtabit të Përgjithshëm e ka vizitue zonën operative të
19 Llapit, personalitete të caktume ishin veç të emënum nga
20 komandanti i zonës operative të llapit. Ky delegacion vetëm i
21 bëri zyrtare. Kështu e kam qujt edhe zyrtarizimi i anëtarëve
22 të shtabit të zonës operative të Llapit. Nuk kam tjetër
23 përgjigje. Nuk muj e vlerësoj unë z. Krasniqi për thënie dhe
24 fjalë që ka përdor në fjali të tijna dhe në paragrafë. Se nuk
25 e di çka ka dash me thanë, unë po them temën, është zyrtarizue

1 vendimi i Rustem Mustafës.

2 PY. A e dini ju që ka pasur disa anëtarë të UÇK-së të cilët
3 pas luftës kanë shkruar libra për UÇK-në?

4 PË. Unë disa prej tyre sa më kujtohet, i keni tek burimet dhe
5 literatura, i kam shfrytëzu edhe si literaturë ose si burim.

6 PY. A pajtoheni me mua që pas luftës, shumë prej këtyre
7 pjesëtarëve të UÇK-së që shkruan libra, më shumë këto libra e
8 zbukuronin UÇK-në, e ekzagjeronin rolin e UÇK-së, pajtoheni me
9 mua?

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj, pyetja është e
11 paqartë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoj.

13 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

14 PY. Do ta riformuloj pyetjen. Disa prej këtyre librave që i
15 kanë shkruar ish-pjesëtarë të UÇK-së pas luftës, përmbanin
16 ekzagjerime sa i takon kapacitetit që kishte në të vërtetë
17 UÇK-ja dhe organizimit të saj të asaj kohe. A pajtoheni me
18 mua?

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Është e njëjta pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, është e
21 njëjta pyetje.

22 A keni ndonjë libër konkret që doni ta përmendni?

23 Atëherë, kështu veproni.

24 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, a e keni lexuar librin e Nuhi Bytyqit, është

1 një libër me titull "Libri i luftës", nga Nuhi Bytyqi. Keni

2 dëgjuar për këtë libër?

3 PË. Jo, nuk e kam lexue.

4 PY. A e dini që dhe ai ka dhënë dëshmi në këtë sallë gjyqi?

5 PË. Po, kam dëgjue.

6 PY. Gjatë dëshmisë së tij, ai i tha Trupit Gjykues se libri i

7 tij ishte më shumë një libër ku ai përpigëj t'i ngrinte sa më

8 shumë vlerat e luftës dhe të UÇK-së, që e ka ekzagjeruar, pra.

9 Vetë ai kështu e ka bërë për, e ka përshkruar librin e tij.

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] A ka ndonjë pyetje këtu? Sepse

11 është e paqartë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni pyetje?

13 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, do t'ia bëja pyetjen.

14 PY. Pra, a e dini këtë, Dëshmitar, se si e ka përshkruar ai

15 vetë librin e tij?

16 PË. Jo, s'e di.

17 PY. Është edhe një libër tjetër, nga Hajrush Kurteshi [Sipas

18 përkthimit] që e kishte titullin "Lufta në zonën e Nerodimës"

19 -- "Lufta e UÇK-së në zonën e Nerodimës", nga Hajrush Kurteshi

20 -- Hajrush Kurti.

21 PË. Po. Po, kam dëgju.

22 PY. A e dini ju që dhe ai ka dhënë këtu dëshmi?

23 PË. E di që ka dhanë, s'e kam përcjellë.

24 PY. Në dëshminë e tij ai vetë e pranoi se e kishte zbukuruar

25 dhe i kishte ekzagjeruar informacionet në librin e tij, edhe

1 po ashtu pranoi se ai në libër kishte përfshirë edhe supozime
2 të tijat. A e dini ju këtë?

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Kundërshtoj, ku është
4 themelësia, sepse dëshmitari ka thënë që nuk e ka përcjellë
5 dëshminë e tij.

6 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Në qoftë se nuk e ka
7 ndjekur dëshminë, dëshmitari mund të thotë që nuk ka dijeni.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
9 e keni ndjekur dëshminë e tij, jeni në dijeni?

10 DËSHMITARI: Jo, nuk e kam përcjell. Për shkak të
11 çështjeve të mia persona, familjare, s'kam mujt me e përcjell.

12 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

13 PY. Ndonëse s'e keni përcjellë, më pas a dëgjuat diçka që ai
14 ka dhënë dëshmi dhe se në fakt librat e shkruar për UÇK-në pas
15 luftës ishin një vazhdimësi e propagandës që kishte nisur që
16 gjatë luftës. A e keni dëgjuar gjë dëshminë e tij?

17 PË. Po e thashë, që s'e kam dëgju.

18 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me aspektet që keni
19 trajtuar me Prokurorinë lidhur me botimet tuaja të tjera. I
20 thatë Prokurorisë kur jeni intervistuar, se kishit përfunduar
21 një projekt lidhur me gjenocidin serb në Kosovë. A ju kujtohet
22 t'ia keni thënë këtë?

23 PË. Ai projekt është në vazhdimësi. Kemi thanë ku një punim e
24 kam punue, është botue. Dhe gjenocidi është një projekt ma i
25 gjanë dhe jemi tu punue në këtë drejtim. Unë jam t'u u marrë

1 personalisht edhe seriozisht në këtë çështje rreth gjenocidit
2 që kanë ushtruar forcat ushtarake dhe policore gjatë luftës në
3 Kosovë.

4 PY. Nuk po hyj në hollësi të punës tuaj të rëndësishme, por
5 unë doja të sqaroja këtë, se nuk ju ka pyetur Prokuroria gjatë
6 intervistës për përfundimet apo hollësitë e këtij punimi, apo
7 jo?

8 PË. Jo.

9 PY. Dhe kur keni renditur botimet tuaja, për Prokurorinë
10 gjatë intervistës, ju u thatë se keni përfunduar një hulumtim
11 tjetër për politikën serbe nga viti 1984 [Sipas përkthimit]
12 deri në vitin 1999 -- 1834 [Sipas përkthimit] më falni, deri
13 në vitin 1999. A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjatë
14 intervistës?

15 PË. Po, e kam thanë, edhe është e botime. I kam përfshirë të
16 gjitha planet, programet, elaboratet serbe nga viti 1844,
17 Nacertanija, një dokument, në të cilin planifikohet dëbimi i
18 shqiptarëve nga trojet shqiptare, e deri tek plani Patkoi në
19 vitin 1999. Janë të përfshirë të gjitha projektet, politikën
20 serbe në këtë punim. Është i botuem në një nga revistat
21 ndërkombëtare, s'më kujtohet tani, është në gjuhën angleze.

22 Dhe janë të përfshirë të gjitha dëbimet nga territoret në
23 atë kohë të banuar me shqiptarë, shifrat sa shqiptarë janë vra,
24 sa ka pas dëme materiale nëpër kohë, përfshirë edhe dhjetë
25 vjetëshin e fundit të shekullit 20, pas ardhjes respektivisht,

1 pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, të gjitha planet dhe
2 programet serbe deri në planin Patkoi. Këtë mundeni me e gjet,
3 me e lexu, është i botum dhe i kam të gjitha të dhanat,
4 statistikave, se çfarë gjenocidi ka ushtruar Serbia ndaj
5 popullit shqiptar në Kosovë.

6 Prandaj, znj. Avokate, Ushtria Çlirimtare e Kosovës,
7 organizatë politike dhe ushtarake është projekti më i
8 suksesshëm i kombit shqiptar në shekullin 20. Ushtria
9 Çlirimtare e Kosovës jo vetëm që ka organizuar luftë të drejtë
10 e të nevojshme, por ka organizuar dhe ka udhëhequr luftë të
11 domosdoshme për ekzistimin e popullit shqiptar në trevat e
12 veta. Dhe me luftën e vet të drejtë, ka arritur me bo aleatë
13 edhe forcën kryesore siç ka qenë NATO-ja, organizata politike
14 dhe ushtarake siç ka qenë NATO-ja. Ushtria Çlirimtare e
15 Kosovës me këtë luftë e ka bo epokën e vet. Populli shqiptar
16 mburret me Ushtrinë Çlirimtare dhe me ata djem që e kanë
17 themelur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Drejtuesit e Ushtrisë
18 Çlirimtare të Kosovës janë një emblemë që do të rrezatojë
19 gjithmonë edhe në historiografinë shqiptare. Andaj për mua si
20 studiues, ka qenë nder jashtëzakonisht i madh që m'u ka besuar
21 --

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
23 Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: -- zona e Llapit. Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 [Përkthim] Ju lutem që t'u përgjigjeni vetëm pyetjeve që ju
2 drejtohen.

3 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Ajo që doja të dija prej jush është kjo, gjatë
5 intervistës Prokuroria ju kërkoi ndonjë kopje të këtij punimi?

6 PË. Jo, nuk ma kërkoi.

7 PY. Nuk ju pyeti as për përmbajtjen apo përfundimet që kishit
8 në këtë punim?

9 PË. Jo, nuk më pyeti. Edhe nëse mund të shtoj --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, një
11 çast. Qëndrimi juaj është që Prokuroria kishte për detyrim ta
12 pyeste, këtë po përpigjeni të thoni?

13 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 Prokuroria ka detyrimin të hetojë të gjitha informacionet
15 fajësuese dhe shfajësuese në mënyrë të barabartë. Dhe kur ka
16 informacione që janë relevante për kontekstin tonë, unë s'dua
17 ta shtjelloj shumë se dëshmitari jonë është këtu, unë mendoj
18 që në këtë rast Prokuroria e ka pasur për detyrim.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e ka pas
20 kurrfarë detyrimi këtë gjë. Ju lutem, vazhdoni më tej.

21 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, gjatë intervistës suaj i thatë Prokurorisë,
23 dhe do t'jua lexoj një pjesë të intervistës suaj, është Pjesa
24 2, faqja 15 e intervistës suaj. Ju thatë:

25 "Momenti më i fuqishëm emocional në jetën time gjatë

1 luftës është momenti kur tërhoqëm personat e plagosur nga një
2 zonë drejt një zone tjetër. Edhe sot e kësaj dite dëgjoj zërat
3 e të plagosurve, kur i morëm nga një zonë që ishte pjesë e
4 zonës operative të Llapit dhe i çuam në një pjesë tjetër.”

5 Tani, nuk do t'ju jap më shumë hollësi, por a mund ta
6 konfirmoni që Prokuroria nuk ju kërkoi ta shtjelloni, ta
7 elaboroni më tej këtë gjë? Madje, Prokuroria nuk ju bëri asnjë
8 pyetje në lidhje me këtë, por kaloi menjëherë në një temë
9 tjetër, që është pak e çuditshme, apo jo? Ishte për trajtimin,
10 kështu?

11 PË. Pyetje të tjera nuk kam pas, por unë e kam përmend sepse
12 për mue ka qenë një ndër operacionet që një pjesë të tij e kam
13 udhëheq edhe vetë, me disa luftëtarë të njësive të tjera, për
14 shpëtimin dhe bartjen e të plagosurve. Po është fakt që edhe
15 sot kur i kujtoj ato momente, se kanë qenë rreth 70 luftëtarë
16 të plagosur, jashtëzakonisht rand, dhe jam krenar që të gjithë
17 kemi arrit me i shpëtue që mos të bien në dorë të forcave
18 serbe.

19 Për mue ky ka qenë një prej operacioneve të detyrës që
20 kam pas nder me kanë pjesë e atij operacioni edhe që e kam
21 udhëheq së bashku me disa nga personalitetet për, siç ka qenë
22 Fatmir Humolli edhe Ejup Maqedonci. Për mue edhe sot edhe kur
23 ma kujton s'bane mirë hiç që ma kujtove tash, sepse janë
24 emocionet, janë ndjenjat, të cilat thjesht na bojnë me u ndi
25 keq. Po jo vetëm kjo, ka dhe plot raste të tjera siç është

1 masakra që ka ndodh në --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 edhe një herë po shkon përtej pyetjes së bërë. Ju lutem, duhet
4 të respektojmë kohën që është parashikuar sepse do ketë pyetje
5 të tjera më të rëndësishme që do të bëhen. Kështu që, nuk mund
6 ta mbushni kohën me deklaratat tuaja, duhet t'u jepni
7 përgjigje pyetjeve që bëhen, në rregull?

8 Në fakt, znj. Alagendra, nuk kishte asgjë relevante
9 lidhur me pyetjen tuaj.

10 ZNJ. S. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kisha pyetje të tjera,
11 faleminderit shumë.

12 PY. Faleminderit, Dëshmitar, për durimin dhe për përgjigjet e
13 dhëna.

14 PË. Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
16 Ka pyetje plotësuese?

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

18 Pyetje vijuese nga znj. D'Ascoli.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

20 PY. Së pari, Dëshmitar, të qëndrojmë lidhur me atë se çfarë
21 ju pyeti Avokatja lidhur me projektin e gjenocidit. Dua të
22 sqaroj për procesverbalin përgjigjen e dhënë prej jush.

23 Përgjigja u dha në faqen 9 të Pjesës së dytë të intervistës me
24 ZPS-në që është pranuar tanimë si provë materiale që mban
25 numrin e provës P1545.2.

1 Gjatë diskutimit lidhur me këtë projekt, në rreshtat nga
2 11 deri në 17 ju thoni si më poshtë.

3 "Ky është një projekt i filluar nga Instituti", pra e
4 keni fjalën këtu për projektin që kishte të bënte me
5 gjenocidin serb. "Megjithatë ne nuk kemi filluar efektivisht
6 të punojmë dhe nuk na është caktuar një detyrë e tillë ndërsa
7 ne flasim..."

8 A ju kujtohet t'ia keni dhënë këtë përgjigje ZPS-së?
9 Domethënë kjo pjesa që lexova është nga intervista juaj. Ju
10 kujtohet që kjo është përgjigja që i keni dhënë Prokurorisë
11 kur ju kanë pyetur?

12 PË. Po, por nëse është fjala për vitin 2020.

13 PY. Po, po.

14 PË. Po.

15 PY. Thjesht ta përsërit për procesverbalin, vetëm kaq, nuk
16 dua gjë tjetër.

17 Tani do kaloj te disa pyetje të tjera të cilat jua bënë,
18 për shembull, Mbrojtja e z. Thaçi për metodologjinë edhe disa
19 pyetje që u bë edhe nga Mbrojtja e z. Krasniqi.

20 Juve ju bënë pyetje, për shembull, në qoftë se libri juaj
21 përfaqëson mendimin tuaj dhe interpretimin tuaj të ngjarjeve
22 që kanë ndodhur në zonën e Llapit. Kjo jepet në transkriptin e
23 përkohshëm në faqen 59, dhe në qoftë se ju jeni përpjekur të
24 glorifikoni ose të zmadhoni përpjekjet e luftës së UÇK-së në
25 zonën e Llapit. Për shembull, kjo jepet në transkript në faqen

1 60 dhe ka disa referenca të tjera të mëvonshme.

2 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Do kërkoj nga Sekretaria që të
3 paraqesë në ekran faqen 305 të librit tuaj që mban ndryshe
4 numrin SPOE00055974 [Sipas përkthimit] që jua paraqiti
5 Mbrojtja e z. Thaçi. Përsëri, kjo është një faqe nga
6 përfundimet e librit tuaj që jua treguam dhe më herët.
7 PY. Do të kalojmë nga mesi i faqes ku ju përshkruani
8 objektivin tuaj ose qëllimet e shkrimit të këtij libri. Do ta
9 lexoj:

10 "Qëllimi i këtij dokumenti ose punimi është që të
11 hetohet, të analizohet dhe të studiohet lindja, zgjerimi,
12 shtrirja, organizimi dhe strategjia e luftës së UÇK-së që të
13 hidhet dritë mbi këto ngjarje në mënyrën më objektive të
14 mundshme në këtë pjesë të historisë së UÇK-së në zonën e
15 Llapit."

16 A i qëndroni këtij përshkrimi dhe sot, Dëshmitar?

17 PË. Po, unë e kam thanë disa herë, edhe po e them prapë, cili
18 ka qenë qëllimi im --

19 PY. Kaq mjafton, "po" apo "jo". Mjafton kaq, faleminderit. Po
20 ashtu dëshiroj të sqaroj ose dua që t'i kthehem dhe një herë
21 sqarimit për saktësi që keni dhënë në intervistën e ZPS-së dhe
22 më pas gjatë seancës përgatitore.

23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në intervistën e ZPS-së, bëhet
24 fjalë për Pjesën 2 që është prova P1545.2, faqja 5 në
25 anglisht, dhe më konkretisht rreshtat nga 9 deri në -- nga 5

1 deri në 9. Juve ju është bërë pyetja, a jeni munduar të jeni
2 sa më i saktë të jetë e mundur kur keni shkruar librin, dhe ju
3 thoni, po me aq sa keni ditur. Dhe pyetja ime pasuese është, a
4 i qëndroni akoma këtyre fjalëve, Dëshmitar? Kjo është pyetja
5 që kam tani për ju.

6 PË. Po, i qëndroj, por ju me pyetje të shkurtra, "po", "jo",
7 po ma shkurtoni mundësinë me e thanë mendimin e plotë. Unë ju
8 qëndroj mbrapa, por e kam thanë edhe në parathënie, e kam
9 thanë në hymje dhe në përfundim që ka qenë e pamundur dhe unë
10 jam i vetëdijshëm që s'e kam dhanë ma të mirën të mundshme
11 edhe nuk mujt me e përfshi në mënyrën ma të mirë të mundshme
12 qysh është. Por ndihena shumë krenar që ma kanë dhanë mundësi
13 bashkëluftëtarët e mi, miqtë e mi dhe më kanë besue që unë me
14 e shkrua një pjesë të historisë së luftës së Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës, zonën operative të Llapit.

16 Dhe unë jam i vetëdijshëm për kritikën shkencore, jam i
17 vetëdijshëm për lëshimet që kam mujt me i bo, por e di që
18 asnjë autor dhe asnjë shkencëtar nuk mundet me e
19 rrumbullakësue në mënyrën ma të mirë të mundshme studimin dhe
20 punimin e vet. Unë nuk kam të drejtë, unë nuk kam të drejtë si
21 studiues me analizu asnjë --

22 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk është se ju akuzova në
23 pyetjet e mia, thjesht ju pyeta në qoftë se po konfirmonit
24 sërish ato fjalët që keni thënë më përpara.

25 Për t'ju dhënë një mundësi të mëtejshme për të bërë

1 sqarime, ose për të qenë më konkretë siç e thatë juve, gjatë
2 seancës përgatitore, juve ju kërkua që të shpjegoni se në
3 çfarë mënyre jeni munduar që të jeni sa më të saktë të jetë e
4 mundur. Dhe, në përgjigje të kësaj pyetjeje, ju keni thënë si
5 më poshtë, dhe po lexoj këtu nga shënimi përgatitor që ju
6 lexuam mbrapsht juve, që është tani prova e pranuar P1551,
7 paragrafi 23. Ju keni thënë si më poshtë, dhe ju lutem më
8 ndiqni. Nuk kemi përkthim në shqip të këtij dokumenti, kështu
9 që, ju lutem, dëgjoni fjalët e mia dhe merrini ato përmes
10 përkthimit. Ju thoni -- ju bë pyetja që në çfarë mënyrash jeni
11 munduar që të jeni sa më të saktë të jetë e mundur në shkrimin
12 e librit tuaj dhe ju shpjegoni se së pari keni qenë shumë i
13 duruar pasi keni krahasuar dhe keni verifikuar fakte dhe
14 ngjarje nga burime të ndryshme. Ju nuk e keni interpretuar
15 informacionin e marrë, por thjesht keni dhënë ose keni
16 deklaruar faktet ose ngjarjet ashtu siç ato ju janë treguar
17 ju, për shembull, përmes intervistave që mund të keni pasur,
18 nga komandantët e UÇK-së. Gjithashtu, keni bërë edhe
19 krahasimin e atij informacioni me dokumentet dhe burimet e
20 tjera me shkrim. Ky është informacion që ju keni dhënë kur ju
21 bë pyetja për të sqaruar se çfarë kuptonit me qartësinë lidhur
22 me shkrimin e librit tuaj.

23 Pyetja im për ju është kjo, a i qëndroni këtyre fjalëve
24 dhe këtij shpjegimi që keni dhënë më përpara?

25 PË. Po unë nuk kam guximin personal as profesional që të

1 kontestoj edhe të mohoj një diçka që gjithë ata
2 bashkëluftëtarë e kanë konfirmue, dhe lufta që e kemi ba. Na e
3 kena bo luftën në Kosovë, kundër një regjimi fashist, kundër
4 një regjimi i cili e kish vendos një pushtim kolonialist në
5 Kosovë. Dhe unë sikur të kisha dhanë një mendim gazetaresk,
6 ish kanë çështje tjetër --

7 PY. Dëshmitar, të kërkoj ndjesë. Nuk ju pyeta që të vinit në
8 diskutim pyetjet e personave të tjerë. Kam përshtypjen se
9 kështu u formulua. Por të pyeta që të konfirmonit në qoftë se
10 shpjegimi që keni dhënë se si jeni munduar ju që të jeni sa më
11 i saktë të jetë e mundur në librin tuaj. Dhe përgjigjen jua
12 lexova, besoj se ju kujtohet, thjesht po ju pyes në qoftë se i
13 qëndroni akoma shpjegimit që keni dhënë.

14 PË. Po unë mundohem me thanë që unë i qëndroj sepse ato të
15 dhana janë të dhana që unë i kam marrë prej bashkëluftëtarëve
16 të mi, dhe unë nuk kam të drejtë morale, personale dhe
17 profesionale që unë të dhanë komente, mendime se çfarë ata më
18 kanë thanë mue, kur i ka dhanë edhe nëpër intervista të
19 ndryshme ose --

20 PY. Qartë, faleminderit. Faleminderit shumë. Nuk kam pyetje
21 të tjera. Faleminderit dhe një herë që iu përgjigjët pyetje të
22 mia plotësuese, Dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
24 kjo përfundon, këtu përfundon dëshmia juaj përpara Trupit
25 Gjykues. Faleminderit që ishit me ne, faleminderit që ndatë me

1 në informacionin që kishit. Tani do të mund të largoheshit --
2 do të mund të largoheni së bashku me Asistenten e cila do ju
3 shoqërojë nga salla. Ju urojmë gjithë të mirat, dhe
4 faleminderit dhe një herë.

5 Mund të largoheni tani.

6 DËSHMITARI: Ditën e mirë.

7 [Dëshmitari largohet]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Përkthim] Do të fillojmë me dëshmitarin tjetër nesër në
10 mëngjes.

11 Atëherë, faleminderit të gjithëve për komentet për
12 kontributet. E mbyllim sot këtu dhe do shihemi përsëri nesër
13 në orën 9.00.

14 --- Seanca mbyllet në orën 15.42

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25